


Parlament
Edhe një hap
deri në heqjen
e imuniteteve

Fq.3



**PËRDPJEKJA
E MASH-it**
Së shpejti
Gjimnaz Special
Matematikor

Fq.4



KM Liria
Klubi
që nderon
kombin

Fq.19



Koha

www.koha.mk



**Njeriu është
njeri aq
sa e lodh
mendjen**

Fq.12-13

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3234 · e premte 1 dhjetor 2017

6°C | +11°C

15 DEN

EDITORIAL

**A kanë filluar
reformat në
gjqësor!**



Ndonëse zhvillimet e fundit në sferën e gjyqësorit lënë përshytyje se reformimi i sistemit juridik në Maqedoni është duke ndodhur, megjithatë vendimet e miratuara nga Qeveria aktuale, aspak nuk dallojnë nga mënyrë e funksionimit të pushteteve të mëhershme. Si zakonisht, pas çdo ndërrimi të pushtetit, përgjatë 26 viteve të pavarësisë së Maqedonisë, iniciativa e parë... Fq.2

DOSSIER

**Kërkesë e
banorëve të
fshatit Livadhi
të Strugës**

Fq.17

RAJON

**Investimet
milionëshe
turke në
Kosovë**

Fq.14



PENALJA DHE SUPREMJA KOKETOJNË MES VETE

"MONSTRA" NËPËR KORRIDORET E GJYKATAVE



Zëdhënësja e Gjykatës Supreme, Maja Dimitrovska, në një prononcim për gazetën KOHA, tha se nuk është e njoftuar me arsyet se pse kjo lëndë i është kthyer atyre, por se pas grumbullimit të informacioneve të sakta, opinioni do të njoftohet me kohë

Fq.5

**libri i
artë**
2017/18

**KOPJE
FALAS**

me gazetën Koha
më 2 Dhjetor
(e shtunë)



EDITORIAL

A KANË FILLUAR REFORMAT NË GJYQËSOR!



Omer XHAFFERI

Ndonëse zhvillimet e fundit në sferën e gjyqësorit lënë përshtypje se reformimi i sistemit juridik në Maqedoni është duke ndodhur, megjithatë vendimet e miratuara nga Qeveria aktuale, aspak nuk dallojnë nga mënyrë e funksionimit të pushteteve të mëhershme. Si zakonisht, pas çdo ndërrimi të pushtetit, përgjatë 26 viteve të pavarësisë së Maqedonisë, iniciativa e parë, në emër të reformave në gjyqësor, ka qenë shkarkimi i kryeprokurorit. Kësaj radhe fillimi i procedurës për zëvendësimin e Marko Zverlevski, gjithsesi ishte një hap i pashmangshëm i shumicës parlamentare.

Por, premtimet e kryeministrit Zoran Zaev, se sistemi gjyqësor do t'i nënshtrohet një reformimi të plotë, deri më sot fare pak janë realizuar. Në realitet, reformat e paralajmëruara nga Zaevi, me fjalë të tjera, synojnë prishjen piramidës së ndërtuar nga ish ministri i Drejtësisë, Mihajlo Manevski. Themelet e anarkisë momentale, e cila mbizotëron në gjyqësor, me theks të posaçëm në Gjykatën Penale të Shkupit, janë vendosur në vitin 2006 dhe të njëjtat janë përforcuar përgjatë pesë viteve tjera, deri në vitin 2011, atëherë kur edhe përfundoi mandati i dytë i Manevskit. Faktin se sistemi gjyqësor nuk shkon drejtë reformimit transparent, e vërteton pranimi i kandidaturës së prokurorit Lubomir Jovevski, për kryeprokuror të ardhshëm të shteti. Qeveria reformatore, e cilësuar si e tillë nga vetë pjesëtarët e saj, pra u përcaktua për këtë prokuror, i cili vite me radhë ka qenë zëvendës i Marko Zverlevskit. Kryeprokurori i ardhshëm (nëse deputetët shqiptar vendosin "për") përkaj Zverlevskit, ka qenë protagonist edhe gjatë periudhës kur janë proceduar një sërë rastesh, të kategorizuara nga opinioni si procese politike.

Këshilli i Prokurorëve Publike, pjesë e të cilit është edhe vetë prokurori Jovevski, pas shqyrtimit të 23 kandidaturave për kryeprokuror, vendosi që në garën finale për kryeprokuror të futen, anëtarë të tyre dhe profesoresha universitare, Elena Andreeska. Kjo përzgjedhje ndodhi, edhe pse në garë ishin profile të ndryshme të juristëve, në mesin e të cilëve kishte edhe tre shqiptarë.

Rastet "Monstra", "Gjorçe Petrov", "Lagja e Trimave" dhe lënda gjyqësore e zhvilluar në fillimin e 90-ta, ndryshe e njohur si "Afera e armëve", nëse jo në mënyrë direkte, atëherë në mënyrë indirekte kanë kaluar edhe nëpër duart Jovevskit.

Hiç më i mirë nuk ishte edhe zgjedhja e kryetarit të ri të Gjykatës Penale të Shkupit, Ivan Xholev, i cili betimin para Këshilli Gjyqësor e dha pothuajse para një salle të zbrazur, respektivisht njohësit e mirë të zhvillimeve në gjyqësor thonë se ai është vendosur në atë pozitë, vetëm për guximin e tij, por jo edhe për nivelin e tij profesional.

Për në fund, nëse dëshirojmë të shohim se sa punohet në reformimin e sistemit gjyqësor, në respektimin e pushtetit gjyqësor, mjafton të analizohet deklarata e fundit e kryeministrit Zoran Zaev, në rastin e Edmond Temellkos. Vërejtjet e parashtruara nga opozita se kryetari i Pustecit, në paraburgim është duke qëndruar pavarësisht gjendjes së rëndë shëndetësore, u pranuan nga kryeministri, i cili tha se nuk e ka ndërgjegjen e pastër për gjendjen shëndetësore. Kësisoj, ai i apeloj gjykatës që t'i merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe ajo me automatizëm brenda dy ditëve vendosi që Temellko, i akuzuar për prishje të rendit zgjedhor, nga paraburgimi të dërgohet në arrest shtëpiak.

NACIONALIZMI SIPAS ZAIMIT

"Nacionalizëm progresiv: ta duash kombin tënd dhe të punosh që të jetë i barabartë me kombet e tjera e në marrëdhënie të drejtë me to.

Nacionalizëm shoven: të urresh kombet e tjera dhe të punosh që kombi yt të jetë mbi to e në marrëdhënie shfrytëzuese me to. Nacionalizëm debil: të mos duash as kombin tënd as kombet e tjera, të mos punosh, dhe të jesh krenar, shumë krenar", shkruan Arbër Zaimi i Vetëvendosjes në FB.



PSE NUK KA MË BESË E AMANET?

"Shumë njerëz pyesin me të drejtë: 'Ç'po ndodh me moralet, të cilat po rrënohen e po shkatërrohen përditë? Pse korrupsioni po përhapet me kaq shpejtësi? Pse po vjedhin njerëzit, madje ata që janë me kostum e kollare, që janë më të shkolluar se të tjerët, më të edukuarit? Pse nuk ka më besë e amanet, pse nuk ka më burrëri, pse nuk qetësohesh tek fjala e tjetrit, por gjithmonë rri me frikë se mund të ta hedhë tjetri?' Ajo që po ndodh është, se po shkatërrohet njeriu. Dikush thotë: 'Njeriu po ha aq sa s'po i nxë më barku, pra si u prishka njeriu?!' Njeriut nuk i prishet vetëm fiziku, por ajo që po ndodh sot është, se njeriut po i prishet e brendshmja e tij, po i prishet ndërgjegjja. Nëse prishet ndërgjegjja e njeriut, dije se është prishur vetë njeriu dhe jo vetëm një person, por gjithë shoqëria. Në momentin kur ndërgjegjja fillon e ndotet, hapi derën së keqes", shkruan teologu Hasan Baftijari në FB.



LARG NGA FACEBOOK-U KUR PINI ALKOOL!

"Shumë është joshës Facebook-u pas katër-pesë birrave. T'çelet truri pak, të duket vetja kreativ, trim, plot sens humor. Je i bindur që me një status ke me përmbysë shumëçka, të paktën në 6 muajt e ardhshëm... edhe drejt e tek "What's on your mind". Por, sikurse pasojat e birrave që i ndjen të nesërmen, edhe pasojat prej stutuseve që ke shkruar në Facebook i ndjeni të nesërmen. Duart larg nga Facebook-u kur pini alkool...", shkruan gazetari Ilir Mirena në profilin e tij në FB.



NACIONALIZMI KUNDËR FASHIZMIT

"Nacionalizmi është një aspekt i fashizmit. Megjithatë, nacionalizmi është përdorur shpesh për të theksuar zot e kulturës kombëtare si kundër kulturave të tjera të pakicave. Fashizmit pranon grupe të tjera, me kusht që grupet e pakicave të kundërshtojnë kulturën e tyre, gjuhën dhe fenë për nacionalizmin superior", shkruan publicistja Ademina Marku në profilin e saj në Facebook.



MEDIACitate

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka konfirmuar realizimin e testeve sekrete që kanë treguar për mungesë sigurie në aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" (ANP) dhe në Agjencinë e Shërbimit të Navigimit Ajror të Kosovës (ASHNA). Ka paralajmëruar edhe të tjera teste. E ka thënë këtë nëpërmjet një sqarimi që e ka bërë për media ditën kur "Koha Ditore" ka raportuar për rezultatet e këtij testi që nuk i ishin treguar publikut. Mbështetur në burimet e saj në Qeveri, gazeta ka shkruar se si një valixhe me eksploziv është futur deri në aeroplan këtë muaj, pa u detektuar fare nga mekanizmat e sigurisë në Aeroport.

(Koha DITORE, 30 nëntor)

Energjia që KESH mendon të prodhojë, pritet të vijë si pasojë e reshjeve të dendura të shiut. Por këto reshje pritet të shkaktojnë përmbytje. Emergjencat Civile dhanë alarmin, duke u bazuar në parashikimin e institucioneve europiane. Reshjet kanë vijuar gjatë gjithë natës dhe problemet e para raportohen nga qarku i Gjirokastrës. Rruga Gjirokastrë-Lugina e Çajupit ka shembje në të gjithë gjatësinë dhe konsiderohet e rrezikshme edhe për shkak të stuhisë. Po ashtu në këtë qark, reshjet filluan të bllokojnë akset rurale drejt Lunxherisë, Picarit, Zhulatit dhe Fushbardhës në Gjirokastrë.

(Top Channel, 30 nëntor)

Ramush Haradinaj kishte premtuar se tre muaj pasi të zgjidhet kryeministër Kosovës do t'i hiqen vizat me Bashkimin Evropian. Javën tjetër bëhen tre muajt të qeverisë "Haradinaj", ndërsa vizat për Kosovën ende nuk janë hequr. "Unë nuk shoh periudhë më të gjatë se tre muaj nga momenti i nisjes së punës në Qeveri për liberalizim të vizave me BE-në". Ky ishte premtimi më i fortë i Ramush Haradinajt në fushatën e fundit për zgjedhje parlamentare si kandidat i koalicionit PAN (PDK-AAK-Nisma) për kryeministër. Pikërisht javën tjetër bëhen 90 ditë prejse Haradinaj drejton Qeverinë e Kosovës, përdërisa vizat me BE-në ende nuk janë hequr e as që pritet të hiqen në një të ardhme të afërt, kryesisht për shkak të mosmiratimit të Marrëveshjes së Demarkacionit.

(Zëri, 30 nëntor)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

Kuvendi i Dibrës?

Kuvendi i Dibrës u mbledh më 1 nëntor 1878 nën kryesinë e Iljaz Pashë Dibrës, në të cilin mori pjesë edhe Abdyl Frashëri me cilësinë e përfaqësuesit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për Toskërinë. Kuvendi i Dibrës miratoi rezolutën në trajtë memorandumit, e cila përmbante 5 pikat që shtroheshin në programin e Komitetit të Stambollit:

formimi i vilajetit të Shqipërisë, krijimi i administratës me nëpunës shqiptarë, zhvillimi i arsimit në gjuhën shqipe, zbatim i reformave nga Kuvendi i Madh, përdorimi i një pjese të konsiderueshme të buxhetit për përparimin e arsimit dhe për ndërtim botore. Rezoluta iu paraqit Portës së Lartë në fillim të shkurtit 1879.



KOMISIONI PËR ÇËSHTJE TË MANDATEVE DHE IMUNITETIT DHA DRITË JESHILE



“Raporti i vendimit të marrë në mbledhjen e Komisionit është procesuar dhe i njëjti është dorëzuar në arkivin e Parlamentit. Aty pritet të procesohet menjëherë dhe t’i dorëzohet kabinetit të kryetarit të Parlamentit”, ka thënë Stefan Bogoevski nga LSDM, kryetar i Komisionit për çështje të mandateve dhe imunitetit. Sipas Rregullores, Parlamenti prej 3 deri në 8 ditë duhet të vendosë për heqjen e imunitetit të deputetëve

LIGJI TË VLEJË PËR TË GJITHË

Prononcime për këtë rast pati edhe nga ambasada e Britanisë së Madhe, e cila vlerëson se ngjarjet e 27 prillit duhet të kenë epilog gjyqësor. “Ngjarjet në Parlament të 27 prillit ishin të dhunshme dhe meritojnë hetim të detajuar, nëse është e nevojshme me hapa të vazhdueshme në procesin gjyqësor. Me rëndësi është të respektohen procedurat institucionale dhe hapat juridike të jenë maksimalisht transparente që të gjithë ta kenë të qartë se Ligji vlen proporcionalisht për të gjithë”, deklaruan nga ambasada britanike për agjencinë e lajmeve “Meta”.

dhe Imunitetit kërkesat për aprovimin e paraburgimit të deputetëve Kërsto Mukoski, Ljuben Arnaudov, Johan Tarçullovski, Sasho Vasilevski, Ljupço Dimovski dhe Zhaklina Peshevska, të parashtruara nga Gjykata Themelore Shkup I, sektori për krim të organizuar dhe korrupsion. Nga deputetët e shumicës parlamentare në fillim të mbledhjes së Komisionit u prononcua vetëm Aleksandër Kiracosvki nga LSDM, duke thënë se ngjarjet e 27 prillit ishin sulm ndaj demokracisë dhe rendit kushtetues të vendit dhe tentativë për rrezikimin e jetës së deputetëve. “Institucionet e sistemit kanë për detyrë ta zbardhin këtë rast për të mos u përsëritur më asnjëherë”, tha mes tjerash deputeto Kiracosvki. Ndërkaq nga VMRO nuk pati asnjë prononcim në Parlament ndërsa jozyrtarisht u tha se kjo parti do të braktisë Parlamentin, por që ende nuk ndonjë vendim përfundimtar. Nga kjo parti paralajmëruan bllokada dhe protesta pas asaj që vendosi Komisioni pro heqjes së mandatit të deputetëve nga VMRO. Në bazë të raportit të

Komisionit, Parlamenti më së voni në afat prej tre deri në tetë ditë nga marrja e kërkesës për paraburgim të deputetit, vendos për kërkesën. Anëtarë të këtij Komisioni janë edhe dy nga deputetët e akuzuar Kërsto Mukoski dhe Johan Tarçullovski, për të cilët tashmë është kërkuar paraburgim, por që sipas Rregullores - edhe ata duhet të njoftohen për seancën. Por përveç këtyre deputetëve, për ngjarjet e dhunshme të 27 prillit të dyshuar janë edhe deputetët tjerë, por emrat e të cilëve nuk janë bërë të ditur nga Ministria e Punëve të Brendshme. Ndërkaq organet policore përveç deputetit Vesel Memedi, i kanë konfiskuar telefonin edhe ish-kryeparlamentarit nga radhët e VMRO-së, Trajko Vlejanovski. Kujtojmë se më 27 prill, Vlejanovski ishte kryesues i seancës konstituive të Parlamentit, i cili për disa kohë u bllokua me replika, kundër-replika dhe vërejtje procedurale në lidhje me zgjedhjen e kryetarit të Parlamentit dhe anëtarëve të Komisionit për zgjedhje dhe emërim. Një ditë pas ngjarjeve të 27 prillit, Trajko Vlejanovski në

intervistë deklaroi se atë ditë, pas përfundimit të seancës, ka shkuar në kabinetin e tij dhe se nuk e ka ditur që deputetët e shumicës parlamentare kanë mbetur në sallën plenare e as çfarë ka ndodhur, ndërsa zgjedhja e Talat Xhaferit, sipas tij, është bërë në mënyrë joligjore. Për këtë, së pari me deklaratë të tij reagoi deputeti Goran Misovski.

“Së pari, Trajko Vlejanovski tha se 10 minuta pas përfundimit të seancës ka qenë në kabinetin e tij dhe se aty ka ndenjtur deri në përfundimin e, sipas meje, përpjekjes për likuidim të deputetëve të shumicës parlamentare. Së dyti, nga videot shihet se një grup huliganësh, disa edhe me maska kaluan rreth forcave policore dhe u ngjiten nga shkallët që çojnë te kabinetin e kryetarit të Parlamentit dhe te kabinetin tjetër që kryetari e shfrytëzon për takime të caktuara. Së treti, të dy kabinetet janë të ndarë me derë sigurie përmes së cilës në një rrugë më të shkurtër shkohet në presqendrën ku edhe ndodhi sulmi i përgjakshtëm, ajo qendër kontrollohet nga sigurimi i Parlamentit të kabinetit të kryetarit të Parlamentit. E katërta, ajo që jam shumë vite në Parlament, me përgjegjësi konfirmoj se nuk ekziston mundësi se çdokush që e kalon derën e sigurisë, mund të shkojë deri te korridori drejt te pres qendra pa dhënë urdhër dikush. Dhe deputetët kur janë lëvizur në atë pjesë, nuk kanë mundur të kenë qasje përmes derës së sigurimit pa u telefonuar në telefonin që lidhet me Kabinetin e kryetarit të Parlamentit”, pati theksuar kështu Goran Misovski.

SHKARKOHEN EDHE DY KOMANDANTË TË POLICISË

Mitko Peshov, komandant i Njësisë për Operacione Speciale dhe Goran Georgievski, komandant i Qendrës për shërbime policore janë dy zyrtarët e lartë të policisë të shkarkuar të enjten e që lidhen direkt me ngjarjet e 27 prillit në Parlamentin e Maqedonisë. Gazeta KOHA merr vesh se Peshov dhe Georgievski një kohë të gjatë

kanë qenë nën masa disiplinore, ndërsa të dje kanë pranuar edhe zyrtarisht dokumentin e shkarkimit nga puna e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Që të dy, më 27 prill ishin pjesë e Shtabit emergjent të MPB-së, por që si pjesa më e madhe e krerëve të policisë, kishin punuar në kundërshtim me detyrat që i kanë pasur të njëjtit.

BEJLI ME THIRRJE PËR RESPEKTIMIN E PREZUMCIONIN E PAFAJËSISË



Fajtorët të përgjigjen

Shkup, 30 nëntor - Fajtorët për dhunën në Parlamentin e Maqedonisë më 27 prill duhet të përgjigjen, por duhet të respektohet edhe prezumpcioni i pafajësisë, porositit ambasadori amerikan në Maqedoni, Xhesar Bejli. Në deklaratën e dhënë para Dhomës ligjdhënëse, Bejli tha se Ambasada e SHBA-ve së bashku me përfaqësuesit e BE-së në Maqedoni e ndjekin zhvillimin e ngjarjeve pas arrestimeve lidhur me dhunën në Kuvend. “Siç thamë njëherë, ne, si miq dhe mbështetës të fuqishëm të Republikës së Maqedonisë, i ndjekim këto ngjarje të rëndësishme. Policia, prokuroria, sistemi gjyqësor, duhet të veprojnë në mënyrë transparente me respektimin e plotë të standardeve më të larta. Gjithsesi, ne, BE-ja thamë se përgjegjësit për ngjarjet e 27 prillit duhet të mbajnë përgjegjësi, por në proces, gjithashtu, duhet të respektohet prezumpcioni i pafajësisë. Edhe sot në Parlament do të ketë diskutim të rëndësishëm. Ky është roli i Parlamentit, të diskutojë. Kjo është pjesë e Qeverisjes demokratike”, tha ambasadori Bejli. I pyetur për informacionet se trashëgimtar i tij do të jetë Hojt Ji, Bejli tha se akoma nuk ka ndonjë nominim për ambasadorin e radhës të SHBA-së në Maqedoni dhe se e autorizuar e vetme për emërimin e diplomatëve është Shtëpia e Bardhë. Ambasadorin amerikan dje e shoqëroi Laura Kooper, ushtruese e detyrës zëvendës-ndihmëse e sekretarit për Mbrojtje të SHBA-së në takimin me kryetarin e Parlamentit, Talat Xhaferi. Ai sqaroi se Kooper në Maqedoni ka ardhur që të takohet me kolegët rajonal lidhur me konferencën e Grupit të Adriatikut dhe të vazhdojnë bisedimet për këtë forum të rëndësishëm. Kjo, sipas tij, ishte mundësi që të bisedohet edhe për marrëdhëniet e Mbrojtjes dhe të Sigurisë midis SHBA-së dhe Republikës së Maqedonisë.

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 30 nëntor - Komisioni për çështje të rregulloreve, mandatit dhe imunitetit me shumicë votash të enjten vendosi që Parlamentit të Maqedonisë ti propozojë heqjen e imunitetit gjashtë deputetëve të VMRO-së për tu hetuar lirshëm nga Prokuroria Publike në lidhje me përzjerjen e tyre të mundshme në ngjarjet e dhunshme të 27 prillit. Ky Komision, individualisht dhe me shumicë votash vendosi një nga një për të gjashtë deputetët, ndërsa në seancë nuk ishin të pranishëm deputetët e VMRO-së. Ndërkaq, sipas asaj që ka thënë për mediat kryetari i këtij Komisioni, Stefan Bogoevski, raporti menjëherë është procesuar deri tek kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi. “Raporti i vendimit të marrë sot në mbledhjen e Komisionit është procesuar dhe i njëjti para 20 minutave është dorëzuar në arkivin e Parlamentit. Aty pritet të procesohet menjëherë dhe t’i dorëzohet kabinetit të kryetarit të Parlamentit”, ka thënë Bogoevski. Paraprakisht, kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi në përputhje me nenin 53, paragrafi 5 i Rregullores së Parlamentit të Republikës së Maqedonisë, ia dorëzoi Komisionit për çështje të Rregulloreve, Mandatit

PËR PJEKJE E RADHËS PËR MATEMATIKËN

SË SHPEJTI GJIMNAZ SPECIAL MATEMATIKOR

Ideja për themelimin e Gjimnazit të Specializuar Kombëtar të Matematikës në Maqedoni nuk është bërë ende publike nga ana e MASH-it. Por, pavarësisht kësaj, burime të sigurt të gazetës bëjnë të ditur se "informacioni i paraqitur në mbledhjen e 28 nëntorit në Qeveri është rezultat i një sërë aktiviteteve të ndërmarra paraprakisht nga ky institucion me qëllim të përmirësimit të dijeve nga lënda e matematikës"

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 30 nëntor - Ministra e Arsimit dhe Shkencës (MASH) duket se ka vendosur të bëjë një hap të ri, tepër domethënës në përpjekjet për përmirësimin e nivelit të dijeve nga lënda e matematikës. Ditë më parë, në Qeveri është paraqitur informacioni për "themelimin e Gjimnazit të Specializuar Kombëtar të Matematikës", i cili po qe se merr bekimin e Qeverisë dhe më pas të Parlamentit, mund të bëhet realitet nga shtatori i vitit të ardhshëm. Për matematikanët, ky është një lajm i mirë, apo "një rrugë që hap shpresën për ndryshimin e situatës", sikurse shprehen ata.

Deri tani, është provuar shpeshherë të bëhen ndryshime në sistemin e shkollimit parauniversitar me qëllim të përmirësimit të dijeve nga lënda e matematikës, por rezultatet nuk kanë qenë aspak inkurajuese. Performanca e mësimit dhe mësim-nxënies në lëndën e matematikës vazhdon të jetë dëshpëruese. Në matjet e karakterit ndërkombëtar, nxënësit e Maqedo-

nisë radhiten në fund të listave siç është rasti me testet PISA, ndërsa në provimet e Maturës shtetërore është simbolik numri i nxënësve që zgjedhin këtë lëndë për verifikimin e dijeve. Në fakultetet matematikore, të teknikës apo elektros, është gjithashtu i pakët numri i studentëve të regjistruar. Gjithë kjo situatë, pasi matematika po shihet si të ishte një "gogol". "Nuk janë vetëm nxënësit, por edhe prindërit e tyre dhe shoqëria në përgjithësi të cilët kanë një raport jo të mirë me lëndën e matematikës. Është krijuar njëfarë psikoze se matematika është lëndë e vështirë dhe për këtë dorëzohen të gjithë, e humbin vullnetin për ta mësuar këtë lëndë", tregon Xhelal Ramadani, arsimtar i matematikës në shkollën fillore "Hasan Prishtina" në Shkup. E, në fakt është e kundërta, plotëson ai. "Matematika nuk është aspak një lëndë e vështirë. Është shumë e thjeshtë për tu kuptuar dhe mësuar, por kërkon vetëm pak më tepër vëmendje", shprehet Ramadani. Sipas tij, themelimi i një gjimnazi të veçantë do të ishte një hap tepër i

qëlluar. "Nëse MASH e ka vërtetë seriozisht këtë ide, do të bëhej shumë mirë. Konsideroj se ekzistimi i një gjimnazi të posaçëm për matematikën, me program të veçantë - do të jetë mënyra e duhur për të përmirësuar nivelin dijeve nga kjo lëndë". Ai pohon se rastet të këtilla janë treguar shumë të suksesshëm në vende të tjera, si Kosova për shembull. "Në Kosovë, prej shumë vite përpara ekzistonte gjimnazi matematikor dhe ishte pikërisht ai gjimnaz, i cili përgatiste pjesën dërmuese të studentëve të shkencave ekzakte në Kosovë. Gjithë ata që kishin kryer gjimnazin matematikor, nuk e kishin problem të përfundojnë studimet në fakultetet e matematikës, elektroteknikës, informatikës, teknikës dhe shkencave të ngjashme", pohon Ramadani. Maqedonia, plotëson më tej ai, duhet të ndjek shembullin e Kosovës. Në gjimnaze të këtilla, fondi i orëve nga lënda e matematikës është shumë më i zgjeruar se në gjimnazet e rëndomta dhe shkon deri në 14 orë mësimi në javë pasi mësohen të ndara algjebra, trigo-

nometria, gjeometria, analiza matematikore, e kështu me radhë. Programi mësimor plotësohet me orët të tjera të shkencave natyrore dhe humane. Ideja për themelimin e Gjimnazit të Specializuar Kombëtar të Matematikës në Maqedoni nuk është bërë ende publike nga ana e MASH-it. Por, pavarësisht kësaj, burime të sigurt të gazetës bëjnë të ditur se "informacioni i paraqitur në mbledhjen e 28 nëntorit në Qeveri është rezultat i një sërë aktiviteteve të ndërmarra paraprakisht nga ky institucion me qëllim të përmirësimit të dijeve nga lënda e matematikës". Konkretisht, Koncepti për Gjimnazin Matematikor ka nis të përgatitet në Byronë për Zhvillimin e Arsimit që para një viti. Më 18 janar 2017, grupi i punës ka mbajtur takimin me qëllim të definimit të dinamikës dhe çështjeve kryesore që do të ngërthejë Koncepti që duhet të përgatitet nga grupi i ekspertëve të propozuar nga universitetet, Ministria, Byroja, Inspektorati, Qendra për Arsimit të Mesëm Profesional dhe Lidhja e Matematikanëve.

MALI I ZI, PROMOTORI MË I MADH I MAQEDONISË PËR NATO-N

Shkup, 30 nëntor - Mali i Zi do të jetë promotori më i madh i interesave të Maqedonisë në procesin euroatlantik, porositi ministri i Mbrojtjes të Malit të Zi, Predrag Boshkoviç, pas takimit me ministrin e Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska. Boshkoviç, i cili është për vizitë zyrtare në Maqedoni, tha se dy shtetet kanë lidhje të thella miqësore dhe se trashëgimia nga shteti i përbashkët mund të jetë platformë e shkëlqyer për ndërtim të marrëdhënieve të ardhshme. "Jo vetëm për shkakun se Maqedonia e kemi vend të dashur, por edhe për shkak se kjo është në interes të madh të Malit të Zi, sepse vetëm me rajon stabil dhe të bashkuar mund të jetë bazë e mirë



për rritjen ekonomike dhe zhvillimin e gjithë rajonit, e cila është nevojë e domosdoshme për të gjithë qytetarët", theksoi Boshkoviç dhe tha se përvoja e Malit të Zi për hyrje në NATO do të jetë në dobi të madhe për Maqedoninë. Ministrja Shekerinska tha se Mali

i Zi kërkoi anëtarësim në NATO pas Maqedonisë, por edhe se pas të gjitha vështirësive ajo arriti në qëllimin e saj strategjik. "Ky është inspirim për të gjithë ne dhe është dëshmi se kur qëllimi strategjik është me të vërtetë i dëshiruar për të gjithë, ajo është e arritshme",

theksoi Shekerinska dhe potencoi se Maqedonia është e kënaqur për shkak të faktit se e di se e ka edhe një aleat për hyrje në NATO. Maqedonia, shtoi Shekerinska, periudhën e kaluar fokusin e kanë vendosur drejt anëtarësimit në NATO dhe BE dhe se qëllimi strategjik i Qeverisë është që të sigurohen të gjitha kriteret dhe kushtet që të mundet vendi ynë të jetë anëtar i 30-të i Aleancës. Në takim është biseduar për bashkëpunimin në mbrojtje dhe për, siç theksuan, shansin për qytetarët e Mali të Zi që të marrin arsimin akademik në Akademinë ushtarake në Shkup, por edhe për trajnim të pilotëve të Maqedonisë për helikopterë në Malin e Zi.

Dënim me kusht për Ristevskin

Shkup, 30 nëntor - Gjashtë muaj dënim me kusht, gjykatësja Tatjana Mihajlova, i ka shqiptuar Jordan Ristevskit, i cili gjatë seancës gjyqësore për rastin "Shuplakat", me datë 29 nëntor pranoi se i ka kryer veprimet e dhunshme në Komunën Qendër, në qershor të vitit 2013. Kjo shkallë e dënimit, sipas gjykatës Mihajlovska, do të vlejë nëse gjatë dy viteve të ardhshme i akuzuari nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale. Në arsyetimin e këtij vendimi, mes tjerash u tha se i akuzuari më 1 qershor të vitit 2013, me "urdhër" të Nikolla Gruevskit, përmes Mile Janakievskit dhe të akuzuarve tjerë, ai ka kryer veprën penale "dhunë". "Me veprimet e realizuara, i akuzuari ka shkaktuar ndjenjë frikë dhe pasigurie te qytetarët, me çka gjykata e ka marrë si veprim serioz gjatë miratimit të vendimit", tha gjykatësja, Tatjana Mihajlovska.

Ndaj këtij vendimi as i akuzuari, po as edhe Prokuroria Speciale Publike, si përfaqësuese e akuzës, nuk do të parashtrijnë ankesë para gjykatës së shkallës së dytë. Vendim të ngjashëm javën e kaluar gjykatësja në fjalë e miratoi edhe kundër të akuzuarit, ish këshilltarit të VMRO-DPMNE-së në Komunën Qendër, Tomislav L Lazarov. Ndryshe, ky është aktgjykimi i katërt me radhë, pas të cilit qëndron PSP, e cili miratohet nga Gjykata Penale e Shkupit. Paraprakisht, aktgjykimi i miratuar për rastin "Fortesaz", kundër Goran Grujoskit dhe bashkëpunëtorëve tij, respektivisht dënimi me kusht është shqiptuar edhe kundër një të akuzuarit në lëndë e bashkuar "Fortesaz-Target".

Shtyhet debati për Buxhetin

Shkup, 30 nëntor - Vazhdimi i seancës të Komisionit për Financim dhe Buxhet në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë i caktuar për dje, u anulua. Vazhdimi i ri është caktuar për sot në orën 11. Seanca e Komisionit për Financim dhe Buxhet në të cilën debatohet për Propozim-buxhetin për vitin 2018 filloi të hënën. Të martën u paralajmërua vazhdim, por pas informacioneve për arrestet për ngjarjet nga 27 prilli në Parlament, u anulua. Debati i përgjithshëm për propozimin sipas Rregullores zgjat 10 ditë pune. Për propozimin janë dorëzuar 279 amendamente.

PENALJA DHE SUPREMJA KOKETOJNË MES VETE



"MONSTRA"

NËPËR KORRIDORET E GJYKATAVE

Zëdhënësja e Gjykatës Supreme, Maja Dimitrovska, në një prononcim për gazetën KOHA, tha se nuk është e njoftuar me arsyet se pse kjo lëndë i është kthyer atyre, por se pas grumbullimit të informacioneve të sakta, opinioni do të njoftohet me kohë

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 30 nëntor - Lënda gjyqësore për rastin "Monstra", e cila javën e kaluar u shfuqizua nga Gjykata Supreme, nuk është shqyrtuar konform praktikës gjyqësore, por ajo vazhdon të qarkullojë nëpër korridoret e gjykatave. Vendimi i Këshillit Penale të Gjykatës Supreme, me automatizëm duhej të aprovohej nga Gjykata Penale e Shkupit, si instancë e cila i ka shqiptuar dënimet kapitale. Megjithatë, pothuajse një javë pas këtyre ngjarjeve, aktgjykimi i shfuqizuar ende nuk është bërë i plotfuqishëm. Zhvillimet e

pazakonta edhe për vetë palën mbrojtëse janë befasuese. Avokati i një pjesë të të akuzuarve, Naser Raufi, për gazetën KOHA thotë Gjykata në këtë rast kanë mosmarrëveshje, se cila edhe duhet të miratojë vendimin që të akuzuarit për rastin "Monstra" të lirohen nga paraburgimi. "Lënda fillimisht i ka kaluar të gjitha filtrat e zakonit, dmth nga Gjykata Supreme është dërguar në atë të Apelit dhe më në fund - në Gjykatën Penale të Shkupit. Kjo e fundit, pasi e ka pranuar lëndën, është thirrur në faktin se vendimin për lirimin nga paraburgimi duhet ta jep ajo gjykatë e cila e ka shfuqizuar aktgjykimin. Nga ana tjetër, arsyetimi i Gjykatës Supreme është se gjykata e shkallës së parë është gjykata e cila duhet të vendos që të dënuarit e këtij rasti të mbrohen në liri, për shkak se procedimin, shqyrtimin dhe publikimin e aktgjykimit, e ka bërë pikërisht ajo



NASER RAUFI

Arsyetimi i Gjykatës Supreme është se gjykata e shkallës së parë është gjykata e cila duhet të vendos që të dënuarit e këtij rasti të mbrohen në liri, për shkak se procedimin, shqyrtimin dhe publikimin e aktgjykimit, e ka bërë pikërisht ajo

stit "Monstra", brenda disa ditëve do të lirohen nga paraburgimi dhe se pafajësinë e tyre do ta dëshmojnë përmes një procesi transparent gjyqësor. Zëdhënësja e Gjykatës Supreme, Maja Dimitrovska, në një prononcim për gazetën KOHA, tha se nuk është e njoftuar me arsyet se pse kjo lëndë i është kthyer atyre, por se pas grumbullimit të informacioneve të sakta, opinioni do të njoftohet me kohë. Ndryshe, pas reagimeve të shumta vendase dhe atyre ndërkombëtare, gjegjësisht kërkesat për hetim transparent të vrasjes së pesëfishtë

në Liqenin e Smilkovës, Gjykata e Lartë e Maqedonisë më 24 nëntor vendosi që kjo lëndë të kthehet në rigjykim. Seanca e Këshillit Penal në Gjykatën Supreme, ku u vendos që të akuzuarit të rastit "Monstra" të lirohen nga paraburgimi, u realizua pas pothuajse dy viteve me kërkesën avokatëve që kjo gjykatë të vlerësojë vendimet e dy gjykatave më të vogla. Ndërsa, kontributin më të madh në këtë vendim e pati Prokuroria Publike, e cila përmes ushtruesit të detyrës kryeprokurore Liljana Spasovska, më 3 tetor kërkoi nga Gjykata Supreme që të dënuarit me burg të përjetshëm në rastin "Monstra" të mbrohen në liri. Nga viti 2012 e këndej, rasti "Monstra" pothuajse në çdo zhvillim politik në vend ka qenë temë diskutimi. Aksioni policor i realizuar më 2 maj të vitit 2012, rezultoi me arrestimin e 20 qytetarëve shqiptarë në Shkup, në mesin e të cilëve edhe gra. Megjithatë, tendenca e ish-ministres së Punëve të Brendshme, Gordana Jankullovska, që ky rast të lidhet me "terrorizëm islamik", nuk pati sukses. Pas hetimeve dhe marrjes në pyetje, pjesa dërmuese e të arrestuarve u lanë të lirë, një pjesë prej tyre u dënuan për armëmbajtje pa leje dhe pjesa e mbetur - shtatë të akuzuar, u dënuam me burg të përjetshëm.

Në kërkim edhe 12 të dyshuar për terrorizëm

Shkup, 30 nëntor - Një pjesë e të dyshuarve për kryerjen e veprës penale "terrorizëm" që ndërlidhet me ngjarjet e 27 prillit, të cilët ndodhën në Parlament, edhe më tej mbeten të pakapshëm për organet e rendit. Ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, gjatë ditës së enjte ka njoftuar se 12 nga gjithsej 36 të persona të dyshuar, të cilët kërkohen nga Prokuroria për krim të organizuar, vazhdojnë të kërkohen dhe se për mungesën e tyre - nuk nevojitet fletëarrest

ndërkombëtar. Përderisa ministri foli në një ngjarje të organizuar mes MPB-së dhe OSBE-së, ai refuzoi të publikojë identitetin e personave që kërkohen, respektivisht ai nuk përmendi fare profilin e të dyshuarve të cilët nga aksioni policor i realizuar mëngjesin e 28 nëntorit, nuk u gjetën në shtëpitë e tyre. I pari i policisë, po ashtu foli edhe për nëpunësit tjerë të MPB-së, për të cilën Gjykata Penale e Shkupit, vendosi paraburgim prej 30 ditë, për të cilët tha se të gjitha

rastet janë realizuar në pajtim me dispozitat ligjore. "Marrëdhënia e punës e atyre nëpunësve të policisë, të cilëve u është caktuar masa e paraburgimit, në këso raste vendoset në 'pushim'. Ndërsa, për ato persona që për momentin nuk zhvillohet një procedurë disiplinore, ekziston mundësia e inicimit të një procedure të tillë", tha Spasovski. Të thirrur nga praktika e deritanishme, ai të enjten u përgjigj në pyetjet e mediave, se vallë ekziston mundësia e arratisjes së një pjesë



të të dyshuarve, ashtu siç ndodhi muaj me parë me Goran Grujoskin dhe Nikolla Boshkovskin, me çka ministri shtoi se MPB është duke punuar që këto persona sa më shpejt të nxirren para gjykatës në procedurë paraprake. (O.Xh)

KRONIKË

Kujdes, në qarkullim bankënota të falsifikuara

Tetovë, 30 nëntor - Në rajonin më të gjerë të Tetovës, këto ditë janë lëshuar në qarkullim, gjegjësisht janë zbuluar dhe paraqitur disa bankënota të falsifikuara, para së gjitha kruna të Danimarkës. Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, apelon deri te qytetarët, para së gjithash deri tek shitësit nëpër shitore, pompa të benzinës, ose tregtarët në treg të hapur që të kenë shumë kujdes kur produktet apo shërbimet që ofrojnë blerësit, i paguajnë me monedha të huaja, ose nëse tanimë kanë marrë bankënote të këtilla dhe dinë që janë të falsifikuara, ato sërish të mos i lëshojnë në qarkullim. Për shkak se lëshimi në qarkullim i parave të falsifikuara paraqet vepër penale për të cilën është paraparë dënim me burg prej 1 deri në 3, gjegjësisht 10 vite. Deri te qytetarët apelohej gjithashtu që deri në fund të jenë të kujdesshëm kur persona të panjohur ju ofrojnë produkte ose shërbime të ndryshme, me qëllim që t'i mashtrorjnë për të përfutur para, duke shpikur tregime bindëse nga më të ndryshmet, si për shembull se janë të huaj dhe ju nevojiten para, ndërsa në këmbim si garanci se të paratë do t'ua kthejnë ju lënë orë dore, ose gjësede të ndryshme me vlerë. Sektori për Punë të Brendshme rikujton se edhe mashtrimi është vepër penale, për të cilën dënimimi me burg për kryerësit e kësaj veprë lëviz nga 1 deri në 3 vite burg. Përndryshe, një 27 vjeçar, me iniciale B.R. nga fshati Leshkë i Tetovës, ka denoncuar lëshim në qarkullim të një bankënote prej 1000 kruna të Danimarkës. Një ditë më parë, rreth orës 20.00, në pompën e benzinës në rrugën regjionale Tetovë-Jazhincë, ka ardhur një person i panjohur dhe ka blerë glicerinë, vaj për veturën dhe antifriz, ndërsa vlerën e gjësedeve të blera prej 1070 denarëve, e ka paguar me 1000 kruna të Danimarkës, ndërsa i janë kthyer mbrapsht 7130 denarë. Personi i panjohur, me anë të veturës së tij është larguar, përderisa B.R. ka vërtetuar se bankënota është e falsifikuar. Po punohet në zbardhjen e plotë të rastit. (u.h)

Për shkak se ky ligj në praktikë nuk ka treguar se është i dobishëm, ose më saktë kompozimet e financuara gjatë këtyre viteve kanë pasur pak ose aspak jehonë për publikun dhe si të tilla Ministria e Kulturës nuk mund të bëjë dot as vlerësimin e efekteve pozitive nga ky investim

Koha

Evis HALILI

Shkup, 30 nëntor - Kompozimet muzikore nuk do të financohen më nga Ministria e Kulturës. Kjo e fundit është duke hartuar një projektligj për shfuqizimin e Ligjit për mbështetjen e produksioneve të muzikës vendase. Për shkak se ky Ligj në praktikë nuk ka treguar se është i dobishëm, ose më saktë kompozimet e financuara gjatë këtyre viteve kanë pasur pak ose aspak jehonë për publikun dhe si të tilla - Ministria e Kulturës nuk mund të bëjë dot as vlerësimin e efekteve pozitive nga ky investim. Ligji u miratua në vitin 2013 dhe vetë projekti që u realizua nga Radio Televizioni publik parashikonte financimin e 200 kompozimeve

DREJT SHFUQIZIMIT LIGJI PËR MBËSHTETJEN E KOMPOZIMEVE

MUZIKA NUK DO TË FINANCOHET MË NGA MINISTRIA E KULTURËS



Procedura për shfuqizimin e këtij ligji ka nisur dhe është një prej masave që ka nisur të implementojë ky institucion prej disa muajsh për të anuluar ligje dhe konkurse që kanë dëmtuar dhe vazhdojnë të kenë ndikime negative në buxhetin e kulturës

në vit me një kosto prej më shumë se 510 mijë euro. Kjo formë e subvencionimit të kompozitorëve parashikohej të zgjaste deri në vitin 2023, si një mënyrë për t'iu kundërvënë fenomenit sociologjik - "Kulturës turbo folk" dhe perceptimit të deformuar për vlerat e vërteta të artit dhe kulturës, sqarohet në ligj. Nga Ministria e Kulturës pohojnë të kundërtën, se gjatë këtyre katër viteve nuk ka pasur asnjë lloj interesi kjo formë e sti-

mulimit dhe e përkrahjes së krijimtarisë së muzikës së lehtë dhe popullore. Edhe pse gjatë këtyre muajve është hartuar një raport për vlerësimin e ndikimit të këtij Ligji dhe arsyetimit për shfuqizimin e tij, i njëjti nuk është publikuar. "Implementimi i ligjit nuk i ka dhënë efektet e dëshiruara, para së gjithash ndonëse janë regjistruar kompozime audio dhe video janë emituar shumë pak nëpër radio dhe televizione. Për

këto arsye, nuk mund të bëhet as edhe vlerësimi objektiv i efekteve pozitive që vijnë nga mbështetja e krijimtarisë muzikore dhe kompozimeve. Duke pasur parasysh edhe se këto produksione në një masë të madhe as që kanë qenë në dispozicion të publikut më të gjerë, shtrohet çështja e justifikimit të një mënyre të tillë të financimit për krijimin e kompozimeve të reja nga sfera e muzikës popullore dhe asaj të lehtë me mjete nga

buxheti i shtetit", njoftojnë nga Ministria e Kulturës. Procedura për shfuqizimin e këtij ligji ka nisur dhe është një prej masave që ka nisur të implementojë ky institucion prej disa muajsh për të anuluar ligje dhe konkurse që kanë dëmtuar dhe vazhdojnë të kenë ndikime negative në buxhetin e kulturës. Pas reduktimit të pensioneve nacionale dhe tij për produksionet muzikore, ndryshimeve të paralajmëruara tek çmimet shtetërore pritet që të vijohet edhe me reduktimin e një sërë konkurseve në sektorë të ndryshëm që konsiderohen si joprofitabile. Një prej konkurseve është edhe ai për blerjen e kompozimeve muzikore, e të tjera. Po ashtu, ky institucion është në fazë përgatitore për hartimin e një Rregulloreje që përcakton kushtet, kriteret dhe procedurën për dhënie të kompensimeve mujore për artistët e lirë, e cila do të jenë e vlefshme për konkursin për mbështetjen e artistëve të pavarur që shpallet muajin e ardhshëm.

DEBAT PËR GRATË DHE VAJZAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA



DHUNË FAMILJARE NDAJ GRAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA!

Shkup, 30 nëntor - Në Maqedoni shkalla e dhunës me bazë gjinore familjare mbi gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara është më e lartë nga ato në vendet e tjera në rajon dhe BE. Ato janë më të ekspozuara në dhunën me bazë gjinore familjare. Mungojnë shërbime për mbështetje, të cilat do të jenë të kapshme dhe të arritshme, me kuadër profesional përkatës për këta persona, ndërsa është e nevojshme edhe të rritet informimi i tyre ku mund ta paraqesin dhunën dhe kush mund t'u ofrojë ndihmë dhe mbështetje. Këto janë pjesë e qëndrimeve të pjesëmarrësve në panel diskutimin "Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara-viktima potenciale të dhunës së bazuar gjinore", që sot u mbajt në Shkup. "Të dhënat me të cilat posedojmë na tregojnë se shkalla e dhunës në fa-

milje ndaj grave dhe vajzave është shumë më e lartë se në vendet e rajonit dhe BE-së. Por, ana e mirë është se ne kemi gjetur problemin dhe e dimë se çfarë duhet të bëhet. Duhet të nxitet sundimi i të drejtës, të inkurajohen gratë dhe vajzat dhe t'u ofrohen shërbime për ndihmë dhe përkrahje konkrete", tha Benxhamin Perks nga UNICEF-i. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Milla Carova, theksoi se në të kaluarën shumë pak është folur dhe bërë për çështjen e kësaj dhune me bazë gjinore dhe se punohet që kjo gjendje të ndryshohet. Këtë, thotë, e kërkon edhe Konventa e Stambollit, e cila parashikon se të gjitha këto shërbime, që i ofron shteti për parandalim, ndihmë, mbështetje dhe rehabilitim të personave që kanë përjetuar dhunë familjare, duhet të jenë të qassh-

me edhe për personat me lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar, në mënyrë specifike gratë dhe vajzat. Kryetarja e Rrjetit Kombëtar Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, Elena Dimushevska, thotë se shërbimet e specializuara, përveç që janë të pakta në numër, janë të papërshtatshme me aftësitë e kufizuara me të cilat jetojnë gratë dhe vajzat, gjegjësisht janë të paarritshme, ndërsa profesionistët që punojnë dhe japin ndihmë psikosociale dhe mbështetje nuk janë të trajnuara të ofrojë shërbime të tilla për gratë dhe vajzat të cilat janë me aftësi të kufizuara intelektuale. Zëdhënësja e UNDP-së, Luiza Viton, thotë se është e nevojshme të veprohet me kujdes dhe të merren masa, sepse në këtë rast bëhet fjalë për diskriminim të dyfishtë. (O.XH)

Mbështetje për ndërmarrjet dhe mbrojtjen e mjedisit


Shkup, 30 nëntor - Mbështetje për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe për mbrojtjen e mjedisit jetësor, kanë shprehur përfaqësuesit e Bankës Evropiane për Investim në takimin e djeshëm me kryeministrin, Zoran Zaev. Siç kumtoi pres shërbimi qeveritar, në takim Mateo Rivelini, shef i sektorit për projekte të Bankës Evropiane për Investim në Slloveni, Kroaci dhe Ballkanin Perëndimor dhe Dubravka Negre, shefe e zyrës rajonale për Ballkanin Perëndimor të BEI i kanë përshëndetur politikën zhvillimore të guximshme të kryeministrit Zaev dhe të Qeverisë që çojnë drejt stabilizimit ekonomik të shtetit dhe progresit. Në këtë drejtim është biseduar për thellimin e bashkëpunimit me Bankën Evropiane për Investim, përveç në infrastrukturën edhe në përforcimin më të drejtpërdrejt të kapaciteteve të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Maqedoni, si dhe në pjesën e mbrojtjes së mjedisit jetësor, stacionet për filtrimin e ujit dhe stacionet për trajtimin e mbeturinave. "Qeveria e Republikës së Maqedonisë fuqimisht është e fokusuar të sigurojë mjedis jetësor të shëndoshë dhe të pastër për qytetarët e Maqedonisë. Shtetit i ne-



vojiten investime kapitale të cilat mundën në mënyrë të konsiderueshme ta përmirësojnë cilësinë e jetës së qytetarëve. Gjithashtu, jemi të përcaktuar t'i zhvillojmë ndërmarrjet vendore të vogla dhe të mesme dhe drejt mbështetjes së investimeve vendore dhe të huaja. Bashkëpunimi me BEI është i rëndësishëm në realizimin e këtyre përcaktimeve programore të Qeverisë dhe prandaj në emër të qytetarëve të Maqedonisë dhe të Qeverisë u shpreh falënderim të madh për ndihmën dhe mbështetjen shumëvjeçare që e jep BEI për shtetin tonë edhe për mundësinë që ta intensifikojmë për të mirën e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë", tha kryeministri Zaev. Në takim është theksuar se përcaktimi strategjik i Republikës së Maqedonisë janë BE dhe NATO dhe se reformat që i bën Qeveria me procesin inkluziv në shoqëri dhe me hapjen e mundësive për zhvillim ekonomik, i hapin dyert në këtë rrugë.

INDEKSI I SIPËRMARRJES 2018, MAQEDONIA E 67-TË NË BOTË

FRIKA NUK HAP BIZNESE TË REJA



Slovenia është e para në rajon në vendin e 26-të, e pasuar nga Kroacia në vendin e 54-ët. Nga shtetet e tjera të rajonit, Rumania renditet në vendin e 47-të, Greqia në vendin e 49-të, Bullgaria në vendin e 70-të

Raporti global i Institutit për Sipërmarrjen dhe Zhvillimin (GEDI), ku vlerësohen 137 shtete në botë, tregon se fusha më e dobët e Maqedonisë, me vetëm 11 për qind të pikëve, ndërlihet me pranimin e riskut të sipërmarrjes

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 30 nëntor - Frika nga ndërmarrja e rrezikut paraqet shkakun kryesor që të rinjtë në Maqedoni vështirë vendosin të hapin biznesin e tyre. Sipas raportit të Institutit për Sipërmarrjen dhe Zhvillimin e saj (GEDI), dobësia kryesore e sipërmarrjes në Maqedoni, është numri më i vogël i individëve të gatshëm të marrin rrezikun e fillimit të një biznesi të ri. Krahas këtij treguesi, pika tjera të dobëta të sipërmarrjes në Maqedoni, janë shitja e shërbimeve dhe prodhi-

meve jashtë shtetit dhe përkrahja kulturore ndaj sipërmarrjes. Fusha ku Maqedonia mund të krenohet janë pranimi i teknologjive të reja, shkathhtësitë fillestare dhe kapitali njerëzor. Raporti global i Institutit për Sipërmarrjen dhe Zhvillimin (GEDI), ku vlerësohen 137 shtete në botë, tregon se fusha më e dobët e Maqedonisë, me vetëm 11 për qind të pikëve, ndërlihet me pranimin e riskut të sipërmarrjes. Raporti gjithashtu thekson se nga tiparet personale të sipërmarrësit, frika e dështimit paraqet një nga pengesat më të rëndësishme për fillimin e biznesit. Rekomandohen edhe më shumë gjëra për të tejkaluar problemin e frikës nga dështimi i një biznesi të ri.

"Ngritni një provë apo test të vogël për të konfirmuar idenë e juaj. Definoni suksesin dhe rezultatet e juaja. Merrni këshilla nga konsulentët kritikë të gatshëm për të anuluar konceptet që nuk përshtaten ndaj tregut. Kuptoni se jo të gjitha idetë mund të zbatohet sot ose sa posedoni aftësitë për sipërmarrje. Identifikoni kushtet e jashtme prej të cilat varet suksesi i idesë së juaj".

Janë disa nga sugjerimet e raportit kushtuar sipërmarrësve lidhur me rreziqet e biznesit. Për pushtetin apo politik-bërësit për këtë pikë kritikë sugjerohet që të përmirësohet stabiliteti institucional dhe ai i organeve rregullatore si dhe të sigurohet mungesa e konfliktit. Pikë tjetër e dobët e sipërmarrjes në Maqedoni, është shitja e shërbimeve dhe prodhimeve jashtë shtetit ku janë fituar 20 për qind të pikëve. Në vend të tretë si dobësi është përkrahja kulturore si promovimi i sipërmarrjes në sistemin shkollor, si dhe ulja dhe parandalimi i korrupsionit ku janë fituar 22 për qind të pikëve.

Nga ana tjetër, fusha ku Maqedonia mund të krenohet me 47 për qind të pikëve është pranimi i teknologjive të reja. Shkathhtësitë fillestare me 42 për qind të pikëve dhe kapitali njerëzor me 41 për qind të pikëve, gjithashtu janë fushat ku dallohet Maqedonia në fushën e sipërmarrjes. Sipas raportit, Maqedonia merr një pikësim prej 29 për qind në studimin total të komponentëve të marrë në shqyrtim. Në këtë mënyrë, ajo renditet në vendin e 66-të në botë dhe ndër të parat në rajon. Para Maqedonisë, ren-

ditet Mali i Zi në vendin e 60. Pas nesh renditet, Serbia në vendin e 74-ët, Shqipëria në vendin e 84-ët dhe Bosnje dhe Hercegovina e renditur e 95-ta.

Slovenia është e para në rajon në vendin e 26-të, e pasuar nga Kroacia në vendin e 54-ët. Nga shtetet e tjera të rajonit, Rumania renditet në vendin e 47-të, Greqia në vendin e 49-të, Bullgaria në vendin e 70-të. Raporti, më tej thekson se shtetet evropiane kanë në mesatare rezultate më të larta lidhur me aftësitë fillestare për biznes si rrjedhojë e trashëgimisë të arsimit terciar të disponueshëm si dhe popullsisë që në një masë të madhe posedon aftësitë e nevojshme për të filluar një biznes. Dobësia më e madhe e Evropës akoma është rretëzimi, përkundër asaj se ky tregues është më i lartë se mesatarja globale në këtë fushë. Në përgjithësi, rezultatet e Evropës janë relativisht të balancuara në të gjithë komponentët e sipërmarrjes, duke sugjeruar se një përzierje më e gjerë e politikës pritet të ketë ndikim më të madh në performancat e përgjithshme sesa fokusimi në një fushë të vetme, thekson raporti.

PREZANTOHET PROJEKTI HEKURUDHOR MESHQIPËRINË

Hekurudha deri në Lin do të kushtojë 500 milionë euro

Me ndërtimin e hekurudhës Kërçovë deri në Lin, si dhe finalizimi i hekurudhës ndaj Bullgarisë, për të cilin është vendosur afat deri në vitin 2025, theksoi Sugareski, duhet të mundësohet rrjet funksional hekurudhor përgjatë Korridorit 8

Shkup, 30 nëntor - Rajoni i Ohrit do të ketë qasje deri te rrjeti hekurudhor me projektin për ndërtimin e vijës hekurudhore Kërçovë - kufiri me Shqipërinë, në gjatësi prej 63

kilometrave. Dokumentacioni i projektit dhe i tenderit është i gatshëm, ndërsa në periudhën e ardhshme nga kreditorët ndërkombëtarë do të kërkohen 500 milionë euro shtesë aq sa është vlerësuar shuma. Në prezantimin e djeshëm të dokumentacionit projektues, të përgatitur me 7.7 milionë euro nga Bashkimi Evropian, u kumtua se ruta e hekurudhës është nga Kërçova nëpër malet deri në rajonin e Mesheishta, prej ku kalon përmes Strugës e ku do të jetë stacioni kryesor, pas çka do të vazhdojë drejt pjesës perëndimore të Liqenit të Ohrit, do të kalojë nëpër Radozhdë dhe do të lidhet me kufirin me Shqipërinë te vendi i banuar Lin. Ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Goran Sugareski apelon deri te BE-ja që të vazhdojë realizimi i këtij, siç tha, projekt kyç për

Maqedoninë dhe për tërë rajonin. Me ndërtimin e hekurudhës Kërçovë deri në Lin, si dhe finalizimi i hekurudhës ndaj Bullgarisë, për të cilin është vendosur afat deri në vitin 2025, theksoi Sugareski, duhet të mundësohet rrjet funksional hekurudhor përgjatë Korridorit 8. "Edhe përveç qëllimit tonë që të sigurojmë para dhe të fillojë ndërtimi i grupit ndaj Shqipërisë, prioritet kulmor i Qeverisë mbetet finalizimi dhe modernizimi i hekurudhës drejt Bullgarisë", tha Sugareski. Siç informoi, ndërtimi i linjës Kumanovë-Belakovc do të përfundojë deri në vitin 2019 në kuadër të afateve të parapara me memorandumin e nënshkruar me Bullgarinë. Për linjën nga Belakovce deri në Kriva Pallankë duhet të nënshkruhet marrëveshje me kontraktuesin deri në mes të vitit 2018 dhe të

fillojë ndërtimi, ndërsa për linjën e fundit nga Kriva Pallana deri në Deve Bair në fazë përfundimtare është përpunimi i dokumentacionit të projektit. Euroambasadori Samuel Zhbogar theksoi se BE-ja i jep rëndësi këtij projekti, me të cilin do të preken pjesët që mungojnë për rrjet transportues trans-evropiane dhe do të zgjidhen grykat e ngushta në infrastrukturë. "Ky projekt do ta mundësojë lidhjen prej 63 kilometrave të Korridorit 8. Autoritetet nacionale do të kenë projekt që do të mund ta zbatojnë në mënyrë që është mundësuar financiarisht", tha Zhbogar. Linja hekurudhore në Korridorin 8 është me gjatësi prej 315 kilometra. Fillon nga porti Burgas në Bullgari, kalon nëpër territorin e Maqedonisë dhe përfundon në portin Durrës të Shqipërisë. (Z.V)

Bashkëpunim i vështirë me të huajt

Shkup, 30 nëntor - Ka mundësi për bashkëpunim të investitorëve të huaj dhe vendorë, por bashkëpunimi shkon me shumë vështirësi, sepse kompanitë vendore nuk janë të gatshëm në rrezik dhe nuk ka vizione strategjike, konsiderojnë investitorët e huaj. Avram Stojčevski, kryetar i Asociacionit të industrisë automobilistike pranë Këshillit të investitorëve të huaj në Odën Ekonomike të Maqedonisë, thotë se kompanitë vendore do të kishin benefit nga bashkëpunimi me investuesit e huaj, sepse prodhimi i tyre nuk mbetet vetëm në Maqedoni, por i hapen dyert edhe në tregun jashtë shtetit. "Nuk është e saktë që kompanitë vendore nuk dëshirojnë të bashkëpunojnë me kompanitë vendore. Pohon me përgjegjësi se duam të bashkëpunojmë", theksoi Stojčevski në biznes forumin e sotëm kushtuar bashkëpunimit mes investuesve të huaj dhe kompanive vendore që e organizon Këshilli i investuesve të huaj. Investuesit e huaj rekomandojnë që të bëhet edhe diferencë mes kompanive të huaja, të cilat investojnë në zonat e TZHI dhe ata që investojnë jashtë tyre. "Subvencionet shkojnë në zonat e TZHI, ndërsa ka edhe kompani të tjera të huaja, të cilat veprojnë si firma lokale. Nga 136 anëtare, që i kemi në Këshillin e investuesve të huaj, rreth 120 janë kompani të huaja, të cilat perceptohen si kompani vendore dhe ato paguajnë tatime. Dhjetë top kompanitë realizojnë qarkullim prej 1,5 miliardë eurove dhe me këtë rast paguajnë tatime prej 15 milionë eurove në vit pa marrë subvencione, ndërsa punësojnë rreth 10 mijë punëtorë nga Maqedonia", theksoi Shtefan Peter, kryetar i Këshillit të investuesve të huaj. Analizat tregojnë se momentalisht kompanitë e huaja, të cilat përdorin ndihmë të drejtpërdrejtë shtetërore bashkëpunojnë vetëm një për qind me kompanitë vendore edhe atë në pjesën e furnizimit të ushqimit, pastrimit dhe sigurimit. Nga Qeveria paralajmërojnë se për dy javë do ta publikojnë programin për rritje ekonomike, e cila është e orientuar drejt marrjes së rezultateve dhe e cila ka kritere të qarta, e me të cilën në mënyrë të barabartë do të trajtohen edhe kompanitë vendore edhe ato të huaja. Për ta, nga Buxheti pritet të ndahen rreth 30 milionë euro.

PAS TRE VITESH, BORXHI DO TË ZVOGËLOHET PËR 925 MILIONË EURO

Borxhi shtetëror i Maqedonisë, deri më 30 shtator të vitit 2017, është 3.9 miliardë euro, gjegjësisht 37.8 për qind nga Bruto Prodhimi Vendor (BPV), ndërsa borxhi publik është 4.7 miliardë euro apo 45.8 për qind nga BPV-ja



DRAGAN TEVDovski

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 30 nëntor - Me Propozim buxhetin për vitin 2018, për të cilin po debatohet në Komisionin për financa dhe buxhet, përveç që parashihen huazime nga institucionet e jashtme financiare për mbulimin e deficitit buxhetor i paraparë të jetë 22.7 miliardë euro apo mbi 300 milionë euro, Maqedonia duhet të merr të gjitha masat për të siguruar mjete financiare për kthimin e borxheve të jashtme dhe të brendshme të huazuara nga Qeveria e mëparshme.

"Përveç që vitin e ardhshëm nevojiten para për të mbuluar deficitin buxhetor, nevojiten dhe para për të paguar borxhet e huazuara nga institucionet ndërkombëtare

financiare dhe kreditë e huazuara nga bankat vendore për vitin 2018, që kapin vlerën prej 40.9 miliardë denarë. Këto mjete do të sigurohen përmes huazimeve të reja nga institucionet financiare të huaja dhe në tregun vendor përmes letrave më vlerë", deklaroi ministri i Financave, Dragan Tevdovski, gjatë prezantimit të buxhetit për vitin e ardhshëm para anëtarëve të Komisioni për financa dhe buxhet. Sipas ministrit Tevdovski, borxhi shtetëror i Republikës së Maqedonisë, deri më 30 shtator të vitit 2017, është 3.9 miliardë euro, gjegjësisht 37.8 për qind nga Bruto Prodhimi Vendor (BPV), ndërsa borxhi publik është 4.7 miliardë euro apo 45.8 për qind nga BPV-ja. "Huazimet nga institucionet e jashtme financiare, do

të realizohen përmes emetimit të euroobligacionit apo marrjes së kredive nga bankat e jashtme me kamata të volitshme dhe linjave kreditore të dedikuara për financimin e një pjesë të projekteve. Gjithashtu, me huazimet në tregun bankar vendor përmes letrave me vlerë, do të sigurohen mjete shtesë me kushte të ulëta të kamatave", deklaroi Tevdovski. Pra gjatë vitit të ardhshëm Tevdovski u shpreh se neto huazimet planifikohen të jenë 29.9 miliardë denarë. "Me huazimet në vlerë prej 29.9 miliardë denarë gjatë vitit të ardhshëm, 18.2 miliardë denarë do të shkojnë për mbulimin e deficitit buxhetor, ndërsa pjesa tjetër e mbetur prej 11.6 miliardë denarë do të ruhen si depozite. Është me rëndësi të dihet

Është me rëndësi të dihet se në vitin 2020 dhe 2021

Maqedonia duhet të kthejë borxh të jashtëm në vlerë prej 925 milionë euro për tre borxhet më të mëdha të huazuara nga Qeveria e mëparshme, siç janë euroobligacionet e dhënë në vlerë prej 270 milionë euro në vitin 2015, euroobligacioni në vlerë prej 500 milionë euro i lëshuar në vitin 2014 dhe këstin e dytë të huas në vlerë prej 155 milionë euro nga PBC

se në vitin 2020 dhe 2021 Maqedonia duhet të kthejë borxh të jashtëm në vlerë prej 925 milionë euro për tre borxhet më të mëdha të huazuara nga Qeveria e mëparshme, siç janë euroobligacionet e dhënë në vlerë prej 270 milionë euro në vitin 2015, euroobligacioni në vlerë prej 500 milionë euro i lëshuar në vitin 2014 dhe këstin e

dytë të huas në vlerë prej 155 milionë euro nga PBC, e realizuar në vitin 2013 si dhe borxheve tjera të huazuara në tregun bankar vendor", tha Dragan Tevdovski, ministër i Financave gjatë prezantimit të Projekt buxhetit për vitin 2018 para anëtarëve të Komisionit për financa dhe buxhet pranë Parlamentit të Maqedonisë.

ASHAM PROMOVON BOTIMIN "VEPRA TË ZGJEDHURA"

PUBLIKOHEN 40 VJET HULUMTIME TË AKADEMIK ABAZIT

"Elektromagnetika, materiale elektroteknike, energjia dhe mjedisi" titullohet libri i parë i cili ka të bëjë me shumë çështje që lidhen sferën ku Abazi jep kontributin shkencor prej shumë vitesh, ndërsa libri i dytë "Arsimi i lartë dhe Universiteti Evropës Juglindore", përqendrohet te sfidat e arsimit të lartë, me theks tek UEJL, të cilin e ka drejtuar prej thujse një dekadë. Të dy librat janë një përmbledhje e të gjithë punës së Abazit, që nga viti 1975 e deri në ditët tona



përgjatë 40 viteve të punës së akademik Alajdin Abazit, të përmbledhura në dy botime "Vepra të zgjedhura", janë promovuar në Akademinë e Shkencave dhe Arteve (ASHAM). "Elektromagnetika, materiale elektroteknike, energjia dhe mjedisi", titullohet libri i parë i cili ka të bëjë me shumë çështje që lidhen sferën ku Abazi jep kontributin shkencor prej shumë vitesh, ndërsa libri i dytë "Arsimi i lartë dhe Universiteti Evropës Juglindore", përqendrohet te sfidat e arsimit të lartë, me theks tek UEJL, të cilin

e ka drejtuar prej thujse një dekadë. Kryetari i ASHAM, Taki Fiti, në hapjen e ceremonisë ka folur për karrierën akademike të Abazit që e ka nisur në moshë të re, një karrierë universale, që nga Universiteti i Prishtinës, Zagrebit, Britaninë e madhe, e SHBA, si edhe një sërë projektesh të rëndësishme shkencore. Si pikë kulminante, Fiti ka veçuar postin e rektorit të UEJS dhe meritat e kontributin e akademikut për të zbatuar me sukses një projekt të tillë.

"Me përkushtimin e tij në këtë

universitet ai mundi të krijojë të njëjtën sintezë historike, ta ngrrej në këmbë për një kohë të shkurtër dhe ta shndërron në një model për arsimin në rajonin tonë", ka thënë akademik Luan Starova, recensent i librit të dytë. Të dy librat janë një përmbledhje e të gjithë punës së Abazit, që nga viti 1975 e deri në ditët tona.

"Ajo që bie menjëherë në sy është diapazoni i gjerë i për shumë çështjeve që lidhen me elektromagnetikën, materialet elektronike, si edhe masat për mbrojtjen e mjedisit, arsimin e të tjera. Që të kuptohet kjo vepër kaq multidisiplinare e akademik Abazit, duhet të hedhim një vështrim mbi karrierën e pasur të akademikut", ka thënë sekretari shkencor i ASHAM, Leonid Gërçev, po ashtu edhe recensent i librit të parë. Projektet për cilësinë e energjisë elektrike dhe shumë kërkime shkencore, nuk janë kontributi i tij i vetëm, shprehen akademikë të ndryshëm,

pasi Abazi ka krijuar shembullin e shkencëtarit që vazhdimisht hulumton dhe mundohet t'i japë përgjigje shumë çështjeve të pazgjidhura. Po ashtu, Abazi u konsiderua si pjesë e plejadës së atyre intelektualëve që vunë themelet e arsimit dhe luftuan për ta përsosur atë. Në librin e dytë, që i kushtohet arsimit të lartë, me theks tek UEJL, akademik Ali Aliu thotë se aktiviteti dhe puna e akademik Alajdin Abazit për sendërtimin e universitetit në gjuhën shqipe, ka qenë i madh dhe ka lënë gjurmë të thella. Këto dy libra janë botime që do të pasohen edhe me përmbledhje të tjera. promovim i librave ka koiciduar edhe me përvjetorin e 75-të të lindjes së tij.

"ASHAM shënon ditëlindjet jubilare. Dhe do të na duhet që të presim edhe 5 vjet për të festuar ditëlindjen, por shpresojmë që deri atëherë të promovojmë edhe vepra të tjera", ka thënë kryetari i ASHAM, Taki Fiti.

Koha

Evis HALILI

Shkup, 30 nëntor - Kërkimet dhe hulumtimet shkencore të realizuara

RRUGA E HARRUAR PËR NË KODRËN E DIELLIT

VITIN TJETËR RIPAROHET RRUGA TETOVË-KODRA E DIELLIT



Në këtë rrugë nuk është investuar që 10 vite, ndërsa dëmtimi i saj është bërë më shumë gjatë luftës së vitit 2001, kurse më pas në shumë vende rruga është çarë nga erozioni i dheut

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 30 nëntor - Në shumë vende, rruga nga qyteti i Tetovës që çon në Qendrën turistike Kodra e Diellit, është e dëmtuar dhe paraqet vështirësi për drejtuesit e makinave. Kjo rrugë më shumë është e stërn-garkuar gjatë kësaj periudhe, pasi që edhe qarkullimi është më i madh, ndërsa dëmtimit i ndihmon edhe hedhja e rërës dhe kripës gjatë sezonit të dimrit, kur kjo rrugë duhet të mirëmbahet gjatë tërë kohës dhe të jetë e kalueshme. Edhe banorët që kalojnë në këtë rrugë, por edhe turistët një kohë të gjatë përballen me gropa, të cilët edhe dëmtojnë veturat, por edhe ngadalësojnë komunikacionin.

Vite me radhë në këtë rrugë nuk është bërë asnjë investim serioz deri në vitin e kaluar, kur filloi rikonstruimi në disa pjesë, por të njëjtat ende nuk kanë përfunduar dhe haste në shumë vështirësi, sidomos në ato pjesë ku nuk janë përfunduar rikonstruimet. Krahas qytetarëve dhe turistëve, në këtë rrugë lëvizin edhe banorët e dhjetëra fshatrave të

Malësisë së Sharrit, si ata të fshatrave Shipkovicë, Brodec, Veshallë, Bozovcë, por edhe ata të pjesëve me të afërta Lisec dhe Gajre. Përderisa edhe këtë vit kjo rrugë do të jetë në këtë gjendje, autoritete shtetërore kanë paralajmëruar se gjatë pjesës së dytë të vitit të ardhshëm, do të rikonstruohet rruga Tetovë - Kodra e Diellit në një gjatësi prej 15 kilometra.

"Aktualisht është duke u përpunuar dokumentacioni teknik, i cila duhet të përfundojë deri në muajin mars të vitit 2008. Pas përpunimit të projektit, Ndërmarrja publike për rrugë shtetërore, në bashkëpunim me Bankën Botërore, do të fillojë procedurën për zgjedhje të ndërmarrjes që do të kryejë punët në

këtë rrugë. Rikonstruimi i kësaj rrugë është pjesë e Ministrisë së Transportit për rikonstruimin e 12 rrugëve regionale në vend", njoftojnë nga Ministria e Transportit.

Në këtë rrugë nuk është investuar që 10 vite, ndërsa dëmtimi i saj është bërë më shumë gjatë luftës së vitit 2001, kurse më pas në shumë vende rruga është çarë nga erozioni i dheut. Disa riparime janë regjistruar para gjashtë - shtatë vitesh, ndërsa rikonstruim i tërësisht nuk është bërë gati se dy dekada.

Ndryshe, rruga Tetovë - Kodra e Diellit, është e gjatë rreth 20 kilometra. Në këtë pjesë të rrugës, gjithashtu shpesh ndodh edhe erozioni i dheut që dëmton këtë rrugë,

e cila është e vetmja që lidh Tetovën me fshatrat e Malësisë së Sharrit dhe Kodrën e Diellit. Autoritetet e Kodrës së Diellit, një kohë të gjatë kërkojnë që kjo rrugë të rregullohet dhe të sanohet nga gropat që mos ketë vështirësi gjatë qarkullimit për në këtë pikë turistike, e cila vetëm gjatë dimrit është e frekuentuar nga mijëra vetura dhe turistë vendor, por edhe të huaj. Krahas kësaj, po ashtu viteve të fundit kjo rrugë mjaft e pasigurt dhe janë rritur dukshëm aksidentet e trafikut, sidomos në ato pjesë ku ka erozion të dheut dhe në disa pjesë ku mungojnë, edhe mburojat prej metali që garantojnë më shumë siguri për drejtuesit e automjeteve që lëvizin në këtë aks rrugor.

Në Shkup betohen dy kadete të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Shkup, 30 nëntor - Në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Shkup, dy kadete nga Republika e Kosovës, të komunitetit serb dhe boshnjak, Semra Bezhani dhe Aldina Skenderi dhanë betimin me rastin e fillimit të studimeve në Akademinë Ushtarake të Maqedonisë. Të pranishëm ishin gjeneral Enver Cikaçi nga FSK dhe koloneli Aleksandar Glavinov, prodekan i Aka-

demisë Ushtarake të Maqedonisë. Me një fjalë rasti nga Ambasada i përshëndeti diplomati Agim Krasniqi.

Për çdo vit, që nga viti 2012, kadetë nga Kosova studiojnë në Akademinë Ushtarake të Maqedonisë. Vitin e kaluar kishin diplomuar katër kadetët e parë, kurse këtë vit diplomuan dy kadet Alen Ujkanovic dhe Nemanja Sekulic.



Sigurohen 120 mijë euro për rrugë lokale

Costivar, 30 nëntor - Në kuadër të programit për zhvillim të infrastrukturës rurale, të financuar nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancuar nga buxheti kombëtar, Komuna e Costivarit siguroi fonde në vlerë prej 120.000 euro. Programin e implementon Ministria e Financave, ndërsa i njëjti administrohet nga Banka Botërore.

Komuna e Costivarit fitoi të drejtën për të shfrytëzuar BE grant në lartësi prej 90.000 euro për ndërtimin e dy rrugëve lokale, njëra në fshatin Padalish dhe tje-

tra në fshatin Tërnovë. Vlera e përgjithshme e projekteve është 120.000 euro dhe të njëjtit bashkë-financohen nga buxheti kombëtar në vlerë prej 30.000 euro. Pritet që me ndërtimin e këtyre rrugëve të përmirësohet komunikacioni në këto vendbanime dhe të njëjtit të lidhen më mirë me qytetin e Costivarit. Përfitimet nga këto projekte drejtpërdrejt do t'i ndjejnë të gjithë banorët e Komunës së Costivarit dhe do të mundësohen kushte më të sigurta për qarkullimin e këmbësorëve dhe automjeteve.

Të formohet sa më parë Qeveria e Gjermanisë



Nga Augustin PALOKAJ

Para disa muajsh nga vendet e rëndësishme evropiane, përfshirë edhe Gjermaninë, subjekteve politike në Kosovë u dërgohej mesazhi që sa më shpejt të gjejnë një rrugëdalje nga ngërçi politik dhe të formojnë qeverinë, sepse nuk kanë shumë kohë për të humbur. Po ashtu thoshin se edhe nëse do të zhvilloheshin zgjedhjet e reja ato nuk do të ndryshonin shumë, sepse përsëri do të duhej të arrihej një kompromis mes atyre që do të fitonin vendet në Parlament dhe me këtë do të bëheshin protagonistë të pazareve për formimin e qeverisë. Kësaj radhe ndoshta do të duhej vepruar në anën tjetër. Nuk do të ishte e paduhur, e as qëllimkeq apo provokim, sikur kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, presidenti Hashim Thaçi, apo cilido lider tjetër i ndonjë vendi të Ballkanit Perëndimor të kërkojë që sa më shpejt të formohet Qeveria e Gjermanisë. Sepse nuk ka shumë kohë për të humbur as për BE-në e as për Ballkanin. E pa një qeveri stabile në Gjermani, të vendosur për reforma, BE-ja nuk do të ketë liderë të duhur për të ecur përpara e me këtë do të pësojë edhe rajoni i Ballkanit.

Kriza në të cilën ka hasur procesi i formimit të koalicionit të ri qeverisës në Gjermani pa dyshim që e ka shqetësuar Bashkimin Evropian, sepse pas zgjedhjeve u duk sikur nuk ka vend për shqetësim dhe se kancelaria Merkel do të arrijë të formojë qeverinë me partnerë të rinj dhe të vjetër, me Liberalët dhe të Gjellbrit, dhe me Socialdemokratët në opozitë do të amortizojë edhe roli i së djathtës ekstreme të AFD-së, e cila ka shënuar rritje të madhe në zgjedhjet e fundit. Pas zgjedhjeve të fundit në Gjermani Evropa nuk shqetësohej shumë, sepse ishte krijuar përshtypja se kushdo që të fitojë, kushdo që të formoj qeverinë, do të vazhdojë përkushtimin e Gjermanisë ndaj BE-së. Natyrisht se nga Evropa partitë e ndryshme u shprehën mbështetje partive simotra që vinë nga grupet e njëjta partiake. Përkushtimin ndaj BE-së nuk e vinte në dyshim asnjë nga partitë kryesore, as dy të mëdhatë, CDU-CSU, nga qendra e djathtë, dhe SPD nga qendra e majtë. Me disa ndryshime në qasje të përkushtuar pa rezervë ndaj BE-së ishin edhe Liberalët dhe të Gjellbrit. Mbetej vetëm e djathta ekstreme, rritja e së cilës u kuptua si turp nga gjermanët, por e cila në asnjë mënyrë nuk mund të marrë pjesë në qeverinë e këtij shteti. Ko-

sova po ashtu ka pasur për shumë vjet mbështetjen e Gjermanisë pa marrë parasysh se kush ka qenë në pushtet. Për të që në vitet e nëntëdhjeta, kur zhvillohej lufta në Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë, e në Kosovë aparteidi i regjimit të Milosheviqit, ishte angazhuar ministri liberal Klaus Kinkel, pastaj ndërhyrjen në NATO e bëri Koalicioni i majtë i Social Demokratëve dhe të Gjellbërve, kancelari Shroder dhe ministri i Jashtëm, Fisher, ndërsa njohjen e pavarësisë e bëri koalicioni i madh i CDU-së dhe SPD-së, kancelaria Merkel dhe ministri Steinmayer. Kjo nuk do të ndryshojë, sepse edhe sot, përfshirë edhe Parlamentin Evropian, Kosova ka mbështetje të madhe edhe nga të djathtët e qendrës CDU, të majtë të SPD-së, nga Liberalët edhe nga të Gjellbrit. Prandaj nga ky aspekt askush në Kosovë nuk duhet të shqetësohet për rezultatin e zgjedhjeve në Gjermani, por më mirë të merren me punët që vetë Kosova duhet t'i kryejë e nuk po i bën.

Por nëse Gjermania tash hyn në një proces të paqartë politik, nëse dobësohet fuqia e kancelares Merkel, atëherë shumë projekte të cilat BE-ja mendon t'i shtyjë përpara në vitin

2018 do të vijnë në pikëpyetje. Edhe mënyra se si do të veprojnë Bashkimi Evropian në procesin e dhimbshëm të daljes së Britanisë së Madhe nga BE-ja do të bëhet edhe më i vështirë. Rezultati i zgjedhjeve të fundit, edhe pse nuk ishte shqetësues, ishte kuptuar si një goditje për forcat demokratike, proevropiane, në Gjermani, e sidomos për dy partitë më të mëdha që ishin deri tash në koalicionin e madh. Edhe CDU-ja e zonjës Merkel si fituese shënoi rënie të votave. SPD-ja ra në nivelin më të ulët në historinë e pasluftës së Dytë Botërore dhe kjo bëri që të përjashtojnë mundësinë e hyrjes në qeveri, qoftë edhe përmes koalicionit të madh, sepse në të si partner i dytë shënon vetëm rënie. Goditje e rëndë u kuptua hyrja në Bundestag e partisë së ekstremist të djathtë, antiislamike dhe anti-BE, Alternativës për Gjermaninë (AFD). Kjo parti tejkaloi edhe sondazhet dhe doli e treta me afro 14 për qind të votave. Kancelaria Merkel mendohej se do të lidhte koalicionin deri më tash të paprecedencë me Liberalët dhe të Gjellbrit. Kjo për shkak se nuk do t'i dalin votat e CDU/CSU-së dhe të Liberalëve dhe duhet të tentojnë t'i marrin të Gjellbrit. Tradicionalisht në Gjermani CDU/CSU ka shkuar me

Pa ironi, kryeministrat e vendeve të BE-së sikur edhe ata të Ballkanit, do të duhej të përcillnin dëshirën e tyre që sa më shpejt të formohet Qeveria e Gjermanisë



Liberalët, ndërsa SPD-ja me të Gjellbrit, në të kundërtën kanë bërë koalicionin e madh. Ky koalicion i madh është dëshmuar të jetë i mirë për ekonominë gjermane, por edhe për Bashkimin Evropian. Prandaj tash, pas dështimit të krijimit të qeverisë me koalicionin e Xhamajkës, u kthye opsioni i krijimit të koalicionit të madh. Kjo, sado politikisht e vështirë, do të ishte më mirë sesa zgjedhjet e reja në Gjermani dhe hyrja e këtij shteti në një fazë të pasigurisë politike.

Mes qendrës së majtë dhe asaj të djathtë gjermane nuk ka dallim sa i përket të ardhmes së BE-së në parim, por ka dallim sa u përket masave shtrënguese financiare. Konservatorët duan të kursehet, ndërsa të majtë që të investohet më shumë. BE-ja ka problem me Gjermaninë, e cila nuk është edhe shtet aq i disiplinuar evropian sa mendohet. Edhe Gjermania është në shkelje të rregullave makroekonomike të BE-së, sepse ka për një periudhë të gjatë suficit buxhetor. Pra, këtij shteti i shkon aq mirë sa që i teprojnë me dhjetëra miliarda euro në vit dhe javën e shkuar Komisioni Evropian përsëriti se Gjermania për këtë shkak ka disbalancë të tepër makrofinanciare. Dhe ky është pro-

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypit dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjte 30 nëntor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Ndhimskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktorë: Shkëlzen HALIMI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

blem, sepse në të njëjtën periudhë kur gjermanët kursenin, pjesa tjetër e BE-së ishte në krizë financiare. Për tërë Evropën dhe për Ballkanin po ashtu një qeveri e fortë dhe stabile gjermane është e domosdoshme sidomos në kohën kur në Shtëpi të Bardhë në Washington është Donald Trumpi, një president i paparashikueshëm. Në anën tjetër, Mbretëria e Bashkuar po del nga BE-ja në një kohë kur po përballet me një krizë të llojit të vet politik të brendshëm. Gjermania në këto rrethana është parë madje si një oazë e stabilitetit politik perëndimor dhe si një lloj lidereje e botës së lirë. Dobësimi i rolit të Gjermanisë do të mund të vërehet edhe në rastin e zgjerimit të BE-së, proces të cilin vetëm me vullnet të fortë të Berlinit mund ta shtyjë përpara Brukseli. Kosova, e cila krahas Berlinit mbështetësin kryesor në BE e ka pasur Londrën, do të mbejti si një lloj jetimi në BE sikur Gjermania të mos angazhojë në favor të saj, qoftë përmes kushtëzimit të Serbisë apo përmes kontributit të saj në misionet në Kosovë apo edhe ndihmës që BE-ja i jep Kosovës. Prandaj do të ishte edhe në interes të Kosovës që në Berlin sa më parë të formohej qeveria dhe që gjermanët të mos humbin më shumë përmes zgjedhjeve të reja. (koha.net)

Cutting syndrome (sindroma e prerjes)

K ishte filluar të bënte prerje në parakrahun e saj deri sa duke si një pikturë abstrakte me vija të çrregullta e në ngjyrë të kuqe, vishnje, kafe... Më pas kishte shenja në këmbë dhe bark, të gjitha gërvishje të forta me mjete të mprehta të bëra më dëshirën e saj, duke menduar se dhimbja që ndjente do të zhdukej, por, jo, nuk ishte ashtu, siç i kishin thënë miqtë. Megjithatë, fillimisht duke sikur kjo gjë e bënte të ndjehej më mirë, por më pas iu kthye në një ferr të vërtetë e tani duket sikur nuk e ndal dot më e nuk do të shpëtojë kurrë prej saj... Shembulli i paraqitur përshkruan shumë shkurt gjendjen e një adoleshenteje që u paraqit për ndihmë e shoqëruar nga nëna e saj, e cila fatkësisht e kishte kuptuar vonë se ç'po ndodhte me vajzën e saj. Janë të konsiderueshme rastet e adoleshentëve që zhvillojnë këtë lloj sjelljeje. Është ilustruar nëpërmjet një vajze për faktin se shumica e adoleshentëve që paraqiten me këtë problematikë janë vajza. Fillesat zakonisht përkohet me periudhën e para adoleshencës dhe forma më e përhapur e vetë dëmtimit është prerja apo gërvishja nëpërmjet mjeteve të ndryshme që gjenden lehtë, si, për shembull, majat e kompasit, gërvishëret e të tjera mjete rrethore me tehe të mprehta, të cilat mund të shkaktojnë prerje të vogla dhe gjakosje. Ndërkohë që ka edhe forma të tjera, si djegiet në pjesë të ndryshme të lëkurës apo goditje që shkaktojnë njolla në lëkurë.

Kur prindërit, mësuesit apo persona të tjerë në kontakt me adole-

shentët që kryejnë vetëdëmtime, vërejnë shenjat, fillimisht mendojnë se janë si pasojë e tentativës për vetëvrasje, por, në fakt, nuk është ky qëllimi. Adoleshentët e përdorin si formë çlirimi vetëdëmtimin ndaj emocioneve negative dhe krijojnë bindjen dhe më pas ndjejnë se kur shkaktojnë dhimbje fizike në trup, arrijnë të mposhtin dhimbjen shpirtërore, stresin e shkaktuar në situatë të caktuara. Gjithsesi, risiku i humbjes së jetës është prezent për shkak se individit me kalimin e kohës dhe realizimin e sjelljeve të përsëritura bëhet tolerant ndaj dhimbjes, e duke kërkuar të ndjejë dhimbje më të fortë për të mposhtur emocionet negative mund të shkaktojë plagë vdekjeprurëse në trup apo të bëhet pre e infeksioneve të rënda për shkak të instrumenteve të përdorura për vetëdëmtim, plagëve të hapura në kontakt me mjedisin dhe bakteret përreth, të cilat sërish kanë pasojë fatale për jetën. Pavarësisht vështirësisë për të kuptuar zhvillimin e kësaj sjelljeje, përveç zhvendosjes së vëmendjes nga emocionet negative, janë edhe një sërë faktorësh që ndikojnë duke filluar nga imitimi i sjelljes brenda grupit të adoleshentëve, pasi kthehet në një lloj modeli i aplikuar nga grupi i adole-

Kur prindërit, mësuesit apo persona të tjerë në kontakt me adoleshentët që kryejnë vetëdëmtime, vërejnë shenjat, fillimisht mendojnë se janë si pasojë e tentativës për vetëvrasje, por, në fakt, nuk është ky qëllimi



shentët promovojnë këto lloj sjelljesh si normale, tërheqëse dhe protestuese për adoleshentët, të cilët kuptojnë shumë mirë njëri-tjetrin, por të tjerët nuk i kuptojnë dot ata. Por, le të fokusohemi, te vetëdëmtimi që disa individë e krijojnë si zakon për të përballuar dhimbjen emocionale dhe që e mbajnë sekret e nuk duan ta ndajnë me askënd tjetër. Ata ndjejnë se është një lloj lehtësime i përkohshëm shpirtëror duke e bërë vetëdëmtimin një sjellje të përforcuar në vazhdim dhe sa më shumë e praktikojnë aq më e fortë bëhet kjo sjellje. Mjafton një grindje në familje, në shkollë, me partnerin apo thjesht ndjesia e të qenit i paafte për t'u përballur me kërkesat, vë-

shentëve që ndajnë eksperiencën jetësore, përjetime e forma lehtësime me njëri-tjetrin, duke krijuar trendin të cilin e mbajnë sekret dhe e ndajnë vetëm me ata që veprojnë në të njëjtën mënyrë, duke vazhduar me nevojën për të marrë vëmendje dhe kujdes nga prindërit, të rriturit e tjerë apo bashkëmoshatarët, apo të ndjerit e diçkaje të fortë brenda vetes në momentet kur nuk kanë asnjë lloj stimuli. Gjithashtu, shkas mund të bëhen site të ndryshme në mediat sociale ku adole-

rejtjet e vazhdueshme që individit ta përsërisë sjelljen vetëdëmtuese si çlirim. Disa nga format e sjelljes që ju bëjnë të dyshoni/kuptoni së adoleshenti po kryen sjellje vetëdëmtuese janë plagë që në vend të shërohen bëhen më problematike, disa prerje në një vend të caktuar të trupit p.sh: në parakrah mund të ketë shenja në formë vijash të njëpasnjëshme, mbajtja e veshjeve, që nuk tregojnë gjymtyrët dhe të qenit i kujdesshëm për të mos zbuluar këto pjesë të trupit as në ambientet e shtëpisë e as në shkollë gjatë orës së fizikut p.sh, apo gjatë stinëve të ngrohta adoleshentët zgjedhin të përdorin veshje, të cilat i mbulojnë gjymtyrët krejtësisht, tërheqje sociale, shmangie nga aktivitete të ndryshme shoqërore, të qëndruarit vetëm shumë më tepër se përpara apo pranë e mjeteve prerëse në çantë apo dhomë ndryshe nga rutina e mëparshme. Nëse vëreni se adoleshenti ka kryer sjellje vetëdëmtuese, qoftë edhe një herë të vetme, flisni rreth problemit dhe konsultohuni me një specialist të fushës për mënyrën sesi mund të komunikoni me fëmijën tuaj dhe jini vigjilent për çka ndodh përreth e me kë shoqërohet, si i përballon emocionet e forta dhe situatat stresante dhe, nëse sjellja vetëdëmtuese ka tendencën të përsëritet duhet të merrni seriozisht në konsideratë faktin se mund të jetë duke u zhvilluar një problem serioz i shëndetit mendor dhe jo vetëm një sjellje e fituar, e cila mund të tejkalohet me vullnetin dhe dëshirën tuaj për ta ndryshuar atë.

(Autorja është psikologe klinike, trapiste)



Nga Graciela MANA

NË SHIRITIN E KOHËS

Ç'duam e ç'nuk duam

Po na kundërshtojnë, po na thonë dallkukë, po na thonë hipokritë. Nuk duan të kuptojnë lartësinë e idealit tonë, nuk duan të kuptojnë se ne po përpiqemi për lartësimin e kombit të lashtë të Shqipërisë! Dhe po na falin epitete, dhe po na hedhin njollat e tyre. Nuk kemi kohë të hapim polemika, nuk kemi kohë të qëndrojmë e të dëgjojmë se ç'thonë kundërshtarët. Në zemër kemi një flakë që po na djeg; në mendje kemi një ideal që po na shkrin; dhe kjo flakë, ky ideal, janë Shqipëria! Krejt të zhveshur nga mëria personale, krejt të bindur në shenjtërinë e çështjes, që me pasion po ndjekim, në ecim me hapa të shpejta dhe të sigurt drejt dritës. Në s'kemi kërkuar kurrë litarin për popullin shqiptar, në s'kemi qenë kurrë organe të njërit e tjetrit; në kemi qarë, kur kemi parë burgje të mbushur me shqiptarë, të gabuar ose të pafajshëm. Në jemi shqiptarë, në mburremi që jemi shqiptarë! Nuk duam pozita, por duam lartësimin e Shqipërisë; nuk duam pasurira, por duam bukë dhe shëndet për popullin

e Shqipërisë, nuk duam nderime, por duam nderin e Shqipërisë. Dhe këto që themi, i kemi provuar. I kemi provuar me izolimin tonë; i kemi provuar me përbuzjen tonë; i kemi provuar me vuajtjet tona; kur të tjerë mbaheshin lart, pse ishin njerëzit e njërit dhe të tjetrit, në ishim të rrethuar nga njëqind spiunë, në ishim pa bukë, në ishim të përndjekur nga urretja e intrigantëve. Sot po ngremë zërin, zërin që rrjedh nga shpirti, dhe po i themi shqiptarëve, shqiptarëve të fushave dhe maleve, që të bashkohemi në një ideal, që kapërcen çdo ideal tjetër; që të përpiqemi për një qëllim, për një qëllim që shënjtëron qenien tonë: të rrojmë dhe të vdesim për Shqipërinë!

Në Shqipërinë e duam të fuqishme, në Shqipërinë e duam të organi-

Çdo shqiptar të kuptoj dhe të mburret që është shqiptar; çdo shqiptar të jetë me shëndet, të mos jetë analfabet, të dijë pse rron; të dijë misionin e tij në mes të shoqërisë!



zuar si shtetet e tjerë të Europës, në Shqipërinë e duam të përparuar. Mjaft me Orientin; mjaft me abulizëm; mjaft me indiferencën; mjaft me përçarjet. Çdo shqiptar të kuptoj dhe të mburret që është shqiptar; çdo shqiptar të jetë me shëndet, të mos jetë analfabet, të dijë pse rron; të dijë misionin e tij në mes të shoqërisë! Dhe në kërkojmë Diktaturën, sepse Diktatura, vetëm Diktatura, do të ngjallë në zemrën e popullit këto pasione; sepse Diktatura, vetëm Diktatura do të ngrëjë nga errësira e padijes në dritën e dritës turmat shqiptare; sepse Diktatura do të shenjtërojë ndjenjat, do të falë shëndetin, do të europianizojë Atdhenë e Kastriotit! Nga Mbreti i Madh e deri tek bujku më i varfër, të gjithë do të punojmë, të gjithë do të

përpiqemi për Shqipërinë! Të gjithë do të shkrijmë fuqitë tona për fuqizimin e shtetit, për organizimin e kombit, për lartësimin e idealit, për prestigjin e rracës. Dhe do të fuqizohemi, do të organizohemi, do të lartësohemi përpara botës dëshmitare të veprës sonë të mrekullueshme, përpara Historisë Gjykuëse! Por, për të arritur këtyre qëllime, duhet që të njohim cili ka qenë burimi i parë i vuajtjeve tona në të shkuarën plot mjerime; duhet të pohojmë pa mëshirë se ne na ka munguar Vullneti; duhet të pohojmë se ne, në qe hiqemi si intelektualë, në qe flasim gjuhëra të huaja, në qe kemi shëtitur Europën, në, vetëm në do të jemi përgjegjës përpara Historisë për të arthmen e Kombit shumëvuajtës.

(Botuar më 1934)



Ismet TOTO

ZIBER LATA, PROFESOR UNIVERSITAR

NJERIU ËSHTË NJERI AQ SA E LODH MENDJEN



Dibra ka një pozitë qendrore në gjeografinë e popullit shqiptar, prandaj gjatë historisë aty përreth janë zhvilluar shumë ngjarje të rëndësishme. Hoxhallarët dibranë kanë qenë pjesëmarrës në çdo ngjarje të rëndësishme të popullit shqiptar. Ata çdoherë kanë qenë përkrah popullit, asnjëherë nuk kanë punuar kundër interesit fetar dhe kombëtar. Shpeshherë kanë qenë edhe protagonistë kryesorë të nismave dhe finalizimeve kombëtare.

Koha

Delvina KËRLUKU

Ziber Lata është lindur më 16 korrik të vitit 1985, në qytetin e Dibrës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse Shkollën e mesme islame te Medreseja "Isa Beu", në Shkup. Në vitin 2003 regjistrohet në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup, ku dhe diplomoi në kohë me një sukses të dalluar. Pas përfundimit të studimeve, vazhdon studimet plotësuese për specializimin e gjuhës arabe në Damask të Sirisë. Po atë vit (2008), ai regjistrohet në studimet e magjistraturës në universitetin "El-Xhinan" në Liban, në Katedrën e Gjuhës dhe të Letërsisë Arabe, mirëpo për shkak të trazirave në Lindjen e Mesme, largohet dhe ndjek studimet e magjistraturës në Universitetin e Evropës Juglindore në Maqedoni, gjegjësisht në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit, Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe. Në vitin 2012 arrin që ta mbrojë me sukses temën e magjistraturës "Orientalizmat në leksikon e gjuhës shqipe, te letërsia e bejtexhinjve".

Në vitin 2013 u regjistrua në studimet e doktoratës në Universitetin "Shën Kirili dhe Metodij", Fakulteti Filologjik. Në fund të vitit 2016 arriti ta përfundojë edhe këtë cikël studimesh, me temën "Përkthimet e Kur'anit në gjuhën shqipe – analizë gjuhësore". Ziber Lata qysh në vitin 2009 ka qenë i angazhuar në Fakultetin e Shkencave Islame në cilësinë e demonstratorit të gjuhës arabe, pastaj si bashkëpunëtor, bashkëpunëtor doktorant dhe tani si docent. Po ashtu, në cilësinë e ligjëruesit është i angazhuar edhe në Universitetin e Tetovës, Fakulteti Filologjik, dega Filologji Orientale. Krahas angazhimit akademik, Ziber Lata ka qenë aktiv edhe me aktivitete të ndryshme sociale dhe fetare në vendlindje dhe gjetkë. Ziber Lata është i martuar dhe ka tri vajza.

KOHA: Keni marrë rrugë që në moshë të re për të nxënë mësimin fetar. A është arsimiti investimi më i mirë për njeriun?

LATA: Pa mbushur ende katërbëdhjetë vjet, i nxitur nga kul-

tura e kamotshme fetare e familjes sonë, vendosa të regjistrohem në shkollën e mesme islame Medreseja "Isa Beu" në Shkup, për të trasuar rrugën e gjyshërve dhe stërgjyshërve tanë dhe për t'i shërbyer idealizmit të çiltër fetar dhe altruist që na reflekton nga çdo anë. Aftësia për të menduar është elementi i cili e dallon njeriun nga çdo gjallesë tjetër, prandaj investimi në sferën e arsimit është thelbësor për qenien njerëzore, për të mos thënë i vetëm, sepse ky është investim për të krijuar njeriun. Aq sa njeriu është i aftë të mendojë, po aq është më afër njerëzores. Krahas teorie të ndryshme ekzistencialiste, edhe mësimet fetare islame çdoherë i kanë dhënë përparësi arsimit dhe zhvillimit intelektual, bile në shumë rite fetare e ka bërë parakusht aftësinë e të menduarit. Sipas mësimave fetare, gjëja e parë e krijuar është lapsi, të cilit i është dhënë urdhri "shkruaj!", mirëpo ky laps assesi nuk duhet të mendohet si send fizik, por si simbolikë e diturisë dhe arsimit. Po ashtu, fjala e parë e zbritur nga Kur'ani është pikërisht imperativi "lexo!". Pra, njeriu është njeri aq sa e lodh mendjen. Po ashtu, nëse i kthehemi historisë sonë të ndritshme kombëtare dhe fetare, do të shohim se atëherë kur kemi investuar në arsim kemi qenë dikush, e kur kemi stagnuar në këtë drejtim, kemi qenë të shtypur dhe të nënvlerësuar.

KOHA: I arsimuar është ai që mund të mendojë për atë që ndjen, të thotë atë që ai e mendon dhe ta dijë se çfarë thotë. Sa shqiptarëve të Maqedonisë u dëgjohej fjala e tyre?

LATA: Në studimet bashkëkohore të traduktologjisë, një lloj përkthimi, konsiderohet edhe aftësia për ta shprehur atë që ndjen. Edhe pse ajo kurrë nuk mund ta gjejë përgjigjesen e vet, përsëri, aftësia për ta përfaqësuar sa më denjë, për ta përkthyer sa më pastër ndjenjën në ide dhe idenë në ligjërim varet nga shkalla e përgatitjes arsimore të individit. Kështu arsimimi bën lidhjen mes dy elementëve përbërës të njeriut, mes trupit dhe shpirtit, sepse ura lidhëse mes tyre është arsyeja e shëndoshë njerëzore. Historikisht populli shqip-

tar ka kaluar shumë sfida gjatë ekzistencës së vet. Pavarësisht faktorëve, ata kanë qenë të shtypur dhe të privuar nga shumë gjëra të domosdoshme për mbarëvajtjen e jetës. Në rrethana të këtylla nuk ka se si u dëgjohej fjala shumë shqiptarëve. Pastaj kur janë pyetje shqiptarët e Maqedonisë, numri i njerëzve të arsimuar ka munguar shumë në të kaluarën. Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë ndodhën shumë masakra me shqiptarët që ishin jashtë kufijve. Më e trishtueshme është fakti i vrasjes dhe persekutimit të kuadrit arsimor, në mënyrë që okupatorët të bëjnë çfarë t'u dojë qejfi me shqiptarët. Masakrat e 1013, të Luftës së Parë Botërore, të Luftës së Dytë dhe të luftërave ballkanike, u morën të drejtën e fjalës shqiptarëve të Maqedonisë, sepse duke ia asgjësuar elitën intelektuale, e lanë pa mendje dhe pa gjuhë. Si përfundim, pasi në të kaluarën shqiptarët në këto hapësira kishin më pak qasje në arsim, edhe fjala u dëgjohej më pak, kurse tani që arsimimi i shqiptarëve po rritet çdo ditë e më shumë, edhe zëri i tyre do të jetë më buçitës në këtë shtet të brishtë politikisht. Veçanërisht tani që shqiptarët janë ngopur dhe janë duke e kaluar fazën e shkollimit masiv kuantitativ.

KOHA: Hoxhallarët dibranë në vazhdimësi kanë dhënë një kontribut në ndërtimin e shtetit shqiptar. Sot, si i shihni hoxhallarët dhe a japin një kontribut të devotshëm në shoqërinë tonë?



LATA: Dibra ka një pozitë qendrore në gjeografinë e popullit shqiptar, prandaj gjatë historisë aty përreth janë zhvilluar shumë ngjarje të rëndësishme. Hoxhallarët dibranë kanë qenë pjesëmarrës në çdo ngjarje të rëndësishme të popullit shqiptar. Ata çdoherë kanë qenë përkrah popullit, asnjëherë nuk kanë punuar kundër interesit fetar dhe kombëtar. Shpeshherë kanë qenë edhe protagonistë kryesorë të nismave dhe finalizimeve kombëtare. Pa dashur të flas gjerësisht për kaluarën, do të shkëpus vetëm dy momente: së pari, kontributin e Haxhi Vehbi Dibrës, i cili përveç pjesëmarrjes në shpalljen dhe nënshkrimin e pavarësisë, është njeriu që e zbuti popullatën myslimane që ta njohin shtetin shqiptar, sepse kishte ende zëra për t'i qëndruar besnik Portës së Lartë, dhe legjitimoi me fetva shqiptarët dy krenare në flamurin kuq e zi; së dyti, kontributin e Faik Vildan Dibrës në Kongresin e Manastirit, i cili si përfaqësues i shqiptarëve të Stambollit e legjitimoi alfabetin latin dhe i qetësoi të gjithë me qëndrimin e tij fetar. Pra, hoxhallarët në të kaluarën morën pjesë në hartimin, realizimin dhe finalizimin e kauzës kombëtare shqiptare.

KOHA: Cili është kontributi i ulemave shqiptarë në gjuhën dhe letërsinë shqipe në përgjithësi dhe në veçanti në Maqedoni?

LATA: Hoxhallarët shqiptarë në Maqedoni: ligjëratat, hytбет, mësimet nëpër mejtebe dhe shumë shërbesa të tjera fetare i kanë zhvilluar

në gjuhën shqipe, në kohën kur nuk ekzistonin as universitete në këtë gjuhë. Veçanërisht në disa vende, si Dibra, është bërë përpjekje maksimale që çdo shërbesë fetare-islame, kuptohet ajo që mundej, të bëhet në gjuhën shqipe. Në këtë sferë, meritë të madhe ka ish-myftiu i Dibrës apo kryetari aktual, Ruzhdi Lata. Kontributi i ulemave në gjuhën dhe në letërsinë shqipe ka qenë i vazhdueshëm. Nuk ka asnjë periudhë historike që ulematë mos kenë gisht në sferën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Po ashtu, duhet theksuar se ulematë shkruanin shqip dhe me grafi latine atëherë kur të tjerët e kundërshtonin. Hafiz Ali Korça ka disa vepra gjuhësore dhe letrare në gjuhën shqipe, Said Najdeni ka përpiluar abetare shqipe me grafi latine, Faik Vildan Dibra udhëtoi nga Stambolli për t'i qetësuar gjakrat në Kongresin e Manastirit, Haxhi Vehbi Dibra, përveç të tjerave, themeloi Komunitetin Mysliman Shqiptar dhe e bëri që ai të frymojë vetëm shqip etj. Këta ishin disa nga figurat islame-kombëtare që politikisht dhe shkencërisht kontribuuan në fushën e gjuhës dhe letërsisë shqipe. Në periudhën e monizmit apo socializmit në Maqedoni, veprimtaria fetare ishte e ngulftatur vetëm brenda mureve të xhamisë dhe me disa shërbesa të kufizuara fetare. Sidoqoftë, ajo që ishte filloi të frymojë në gjuhën shqipe. Në këtë periudhë, një kontribut të dalluar kanë dhënë hoxhallarët – orientalistë, të cilët ishin të kyçur nëpër katedrat e ndryshme të orientalistikës, ku përveç kontributit në filologjinë orientale, ata pas vetes lanë edhe vepra kapitale në fushat gjuhësore dhe letrare të gjuhës shqipe. Hoxhallarët vazhdojnë të ruajnë veprat letrare islame, bile në shumë vende ato ende përdoren në jetën e përditshme. Psh. vepra "Mevludi", përkthim i Hafiz Ali Ulqinakut, një poemë e kulluar për jetën e Muhamedit a.s., vazhdon të recitohet nga mbarë myslimanët edhe në ditët e sodit pa iu ndryshuar as edhe në shkronjë e vetme, njësoj si para një shekulli e gjysmë.

KOHA: Në dialektet tona janë të huazuara shumë fjalë të huaja si

ato turke, sllave, arabe, etj. Çfarë bëhet për uljen e përdorimit të fjalëve të huaja dhe cilët janë faktorët që ndikojnë në to?

LATA: Fillimisht duhet thënë se depërtimi i huazimeve në gjuhën shqipe nuk ka ndodhur vetëm në të folmet apo dialektet, por edhe në gjuhën letrare, sepse tek e fundit, gjuhën letrare (standardin) e kemi përfutur nga vetë dialektet dhe të folmet krahinore. Pastrimi i tërësishëm i një gjuhe nga huazimet e një gjuhe tjetër është i pamundur dhe i panevojshëm, sepse nuk ka asnjë gjuhë në botë që është ndërtuar në vetë, pa u ndikuar nga një gjuhë tjetër para-prake. Meqë kontaktet kulturore kanë një rëndësi të veçantë në huazimet leksikore, atëherë për të pasur një gjuhë pa fjalë të huaja duhet të kemi një popull pa kontakt kulturor me popujt tjerë, gjë që është e pamundur. Jo çdoherë pastrimi i të gjitha leksemave të huaja është i shëndetshëm për një gjuhë. Ka huazime të cilat kanë zënë vend në gjuhën mbërritëse shumë kohë më parë, me të cilat janë shkruar shumë vepra, janë thurur poezi, janë bërë pjesë përbërëse e gjuhës së dytë etj., kështu që, largimi i tyre prek në trashëgiminë kulturore të një populli, p.sh. nëse ne e heqim nga gjuha shqipe arabizmin këmbishë, atëherë kemi prekur në thelbin e gjuhës shqipe, sepse kjo fjalë figuron në njërin nga dokumentet e para të gjuhës shqipe, në fjalorthin e Arnold von Harffit etj. Çështja që duhet shtruar është mundësia për t'i zëvendësuar disa huazime me fjalë të gurrës shqipe. Pra, në vendet ku mund të përdoret fjala e pastër shqipe, atëherë nuk duhet përdorur huazimi. Mirëpo, kjo nuk nënkupton që ajo duhet flakur fare, sepse mund të përdoret në të folmet krahinore, në veprat e ndryshme letrare apo në rrafshin stilistik. Sot bota është bërë një fshat global, prandaj leksiku u gjuhëve të popujve të mëdha derdhet dhe u imponohet gjuhëve të popujve të vegjël. Pra, gjuhët që kanë zhvillim permanent të koncepteve gjuhësore çdoherë ndikojnë te gjuhët që e kanë humbur aftësinë e zhvillimit konceptual. Një pjesë e leksikologëve janë fokusuar në pastrimin e gjuhës shqipe prej arabizmave, persizmave, truqizmave, sllavizmave etj., gjë që është punë e mirë nëse studimet janë objektive. Mirëpo, unë mendoj se vëmendja tani duhet fokusuar në një krah tjetër, në ballafaqimin me neologjizmat. Këto dy dekadat e fundit në gjuhën shqipe po infiltrohen fjalë të huaja (neologjizma), saqë ua kalojnë edhe huazimeve orientale, së cilave për të depërtuar u deshën pesë shekuj të tërë. Në fund, duhet ditur se gjuha mbrohet kur ajo studiohet e zhvillohet dhe jo kur mbrohet subjektivisht.

KOHA: Çfarë nënkupton për Ju "Zani i Naltë"?

LATA: "Zani i Naltë" është revistë e botuar nga Komuniteti Mysliman Shqiptar dhe e pasuruar me shumë materiale fetare, kulturore, filozofike, sociologjike, astronomike, publicistike etj. Karakteristikë tjetër e kësaj



reviste është se ajo u themelua dhe në të u derdh boja e penave të burrave që e themeluan Shqipërinë. Pra, bëhet fjalë për një revistë ku u gërshetuan përvojat e së kaluarës me vizionet e së ardhmes. Këtë revistë, unë personalisht, e shoh si modelin më të mirë dhe platformën më të denjë të myslimanëve shqiptarë për të krijuar identitetin shqiptar - mysliman modern, i cili herë anon kah lindja e herë kah perëndimi. Mësimet islame janë njësoj në çdo cep të botës, gjë e cila është e pakontestueshme, mirëpo kultura që fitohet nga gërshetimi i islamit dhe nuancave tradicionale të një populli nuk është i njëjtë. Kur një popull e humb këtë element, atëherë, ose do të huazojë një model tjetër tradicional të ushtrimit të fesë në rrafshin kulturor, i cili zakonisht është arab apo turk, ose do të endet herë kah lindja e herë kah perëndimi duke mbetur pa një model të mirëfilltë. Kështu që, në shqiptarëve myslimanë nga kjo amulli mund të na nxjerrë vetëm versioni bashkëkohor i mendësisë së "Zanit të Naltë".

KOHA: Njëri ndër parimet kryesore të harmonisë ndërfaqetare është edhe respektimi i ndërsjellët i simboleve fetare, me theks të veçantë i atyre simboleve që janë të dukshme për anëtarët e secilit grup, siç janë minaret dhe kryqet. A mund të jetë simboli fetar kërcënues i harmonisë fetare në Maqedoni?

LATA: Respektimi i simboleve vjen kur dy komunitete fetare respektohen edhe në segmente tjera. Pra, ose kemi bashkëjetesë, ose kemi konflikt. Qetësimi artificial apo me direktivë politike është afatshkurtër dhe shpeshherë i kobshëm kur rrenohet. Për mua personalisht bashkëjetesa nuk fillon kur njeriu të rritet, por qysh në fëmijëri. Fatkeqësisht ne nuk i edukojmë fëmijët tanë që të njohin edhe faqen tjetër të botës, apo ta pranojnë tjetrin ashtu siç është, sepse vetëm shumëllojshmëria e ngjyrave e krijon mozaikun më të bukur. Kështu që, thelbi i problemit nuk është respekti apo mos respekti i simboleve, por edukimi apo mos edukimi për të jetuar me tjetrin. Sa i përket, harmonisë fetare, aty ku myslimanët kanë qenë shumicë, asnjëherë nuk ka pasur probleme

ndërfetare. Shembull më të mirë e kemi rastin shqiptar, ku në luftën e zhvilluar në Maqedoni, komunitetin maqedonas dhe objektet kishtarë në Dibër, Tetovë dhe në vendet tjera me shumicë shqiptarë - myslimanë, nuk i cenoi askush, por nëse shohim të kundërtën, atëherë rezultati është fatkeq. Kjo tregon se diktues i harmonisë ndërfaqetare është komuniteti shumicë. Përpyekjet bashkëkohore për ta paraqitur myslimanin si radikal janë krejt të pabaza, sepse ato janë projekte të gatuara në kuzhina dashakeqëse ndaj islamit, ku fatkeqësisht protagonistë janë disa myslimanë naivë apo të shitur. E gjitha qartësohet nëse pak mendojmë rreth këtyre pyetjeve: përse myslimanit sirian i duhet të udhëtojë me mijëra kilometra deri në Francë apo Angli për të vrarë një të krishterë, kur të krishterë ka edhe brenda në Siri? Kështu që vrasja dhe terrorizmi nuk mund të burojnë nga asnjëra fe, por janë prodhim i naivitetit dhe mendjeve të sëmurë.

KOHA: Ka dekada që u lejuan bashkësitë fetare të kthehen në jetën shoqërore. Jo vetëm aq. Me një gatishmëri të dyshimtë, sundimtarët e shqiptarëve i kanë shtyrë bashkësitë fetare që të bëhen parësore në identitetin e njerëzve. Përfundimi logjik është që mbas pak viteve një shqiptar mysliman do të ndihet më shumë turk se shqiptar, një shqiptar ortodoks do të ndihet më shumë grek se shqiptar, dhe një shqiptar katolik do të ndihet më shumë italian se shqiptar, dhe një evangjelist do të ndihet më shumë i huaj se shqiptar. Si mendoni?

LATA: Identiteti fetar dhe kombëtar vijnë ndesh njëri me tjetrin vetë, kur njëri prej tyre të keqkuptohet, sepse nacionaliteti dhe feja asnjëherë nuk e përjashtojnë njëri-tjetrin. Është mbidoza fetare apo ajo nacionale që bën përzierjen e njëres te tjetra, dhe pastaj rezultojnë me fërkim. Kështu që, rrezimi i sistemit që fenë e proklamonte si opium për njerëzimin u hapi dyert feve që ato përsëri ta ripozicionojnë veten në mesin e popullit. Rikthimi i bashkësive fetare ishte forma e vetme për ta kontrolluar jetën fetare në vend, mirëpo problemi qëndron diku tjetër, ku bashkësitë fetare

formohen nga ndërhyrjet e shteteve të tjera, atëherë ata imponojnë edhe interesat e tyre. Dua të bëj një dallim mes bashkësive islame shqiptare dhe bashkësive shqiptare të feve tjera. Nëse i hedhim një vështrim formimit të Komunitetit Mysliman Shqiptar, atëherë do të shohim se ai qysh në fillim u themelua nga një njeri që e nënshkroi pavarësinë e Shqipërisë, prandaj nuk kishte si themelonte më vonë një bashkësi që do të vepronte kundër interesave të po këtij shteti. Qysh atëherë dhe deri më sot, kryetarët e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, të Bashkësisë Islame në Maqedoni dhe Kosovë, janë zgjedhur shqiptarë, nga shqiptarët dhe vazhdimisht dhe paralelisht kanë punuar për kauzën kombëtare dhe fetare. Kurse realiteti i bashkësive të tjera nuk është i njëjtë. Kështu që, shqiptarët nuk kanë se frikësohen nga elementi islam, sepse ai asnjëherë nuk i ka tentuar t'i asimilojë, por përkundrazi e ka mbrojtur nga asimilimi. Islami u pajtua me shqiptarinë e shqiptarëve, sepse ai nuk favorizon asnjë nacionalitet ndaj tjetrit, thjesht i njeh si diversitet kulturor, kurse të krishterët bashkë me krishterimin, promovonin sllavizmin apo romanizmin e shqiptarëve.

KOHA: Si e shihni brezin e ri në përfshirjen e religjioneve, veçmas atë islame, në Maqedoni?

LATA: Trendët teknologjike bashkëkohore e kanë drejtuar njerëzimin drejt një bote materiale virtuale dhe të lodhshme. Kjo çdo ditë e më shumë e ushqen elementin fizik të njeriut, por e lodh dhe e dobëson elementin shpirtëror brenda njeriut. Kështu që, shekulli i XXI, siç potencojnë shumë mendimtarë, është shekulli i kthimit kah bota shpirtërore e njeriut. Dalldisja pas materialeve apo shpirtërores është veprim i gabuar. Ajo që kërkohet është baraspesha mes tyre, gjë e cila është forma më e mirë e jetesës së njeriut në këtë botë. Këtë baraspeshë e ngërthen edhe islami brenda vetes, prandaj unë mendoj se brezi i ri do ta kapë këtë model jetese dhe do të jetë i kujdesshëm që t'i vë në vijë paralele vlerat materiale dhe shpirtërore që i ka të ngulitura në vetë karakterin e tij.

KOHA: Avancimi i fesë ka ndodh apo mund të ndodh?

LATA: Fillimisht duhet kuptuar se avancim apo ngecje kanë myslimanët, kurse feja është ajo që është, as nuk avancohet dhe as nuk ngec, sepse feja është një model hyjnor i të jetuarit e cila është ndërtuar mbi principe që çdoherë të jetë në trend dhe në kohë, apo thënë më mirë është zhveshur nga kodi i funksionimit brenda kohës, prandaj vlen për çdo kohë. Sa u përket myslimanëve, ata ndonjëherë avancohen dhe duken të përparuar, e ndonjëherë ngecin dhe bëhen demode për kohën që jetojnë, por kjo aspak nuk duhet t'i përshkruhet fesë, sepse ajo lidhet me çështje që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me vetë njeriun, kurse feja është modeli më i përkryer për të jetuar në këtë botë dhe për ta fituar edhe botën e përtejme.

KOHA: Duke u mbështetur në procesin e zgjidhjes së situatave problematike të arsimit, në Maqedoni dhe fazave të tij, nëpër të cilat kalon procesi arsimor, paraqiten vështirësi. Si e shihni, Ju?

LATA: Paraqitja e vështirësive është një tregues i mirë se diçka është në proces e sipër. Ashtu siç Maqedonia ka kaluar (apo kalon) në procesin e tranzicionit politik, po ashtu duhet të kalojë edhe tranzicionin edukativo-arsimor. Kështu që, rrethanat arsimore nuk janë të ndara nga rrjedhat politike dhe sociale të një shoqërie. Në fillim na mungonin shkollat, të cilat i fituam. Na mungo-

KOHA: I jeni përkushtuar arsimit dhe shkencës, fesë dhe familjes. Të gjitha këto, a ju plotësojnë si njeri?

LATA: Të tre këta komponentë e plotësojnë nga një segment të jetës sime. Ato asnjëherë nuk përbëjnë lodhje, sepse njeriun e lodhin vetë gjërat që i vijnë nga jashtë, kurse ato që i ka pjesë të tërësisë së tij shpirtërore dhe fizike vetëm e plotësojnë.



nin diplomat, por edhe me ato u mbushëm deri në fyt. Tani, sipas meje e ka radhën përmirësimi i kualitetit arsimor, sepse e kërkon nevoja, prandaj mendoj se në të ardhmen duhet t'i bëjmë hyzmet kësaj pike, sepse me të tjerat jemi ngopur.

KOHA: I jeni përkushtuar arsimit dhe shkencës, fesë dhe familjes. Të gjitha këto, a ju plotësojnë si njeri?

LATA: Të tre këta komponentë e plotësojnë nga një segment të jetës sime. Ato asnjëherë nuk përbëjnë lodhje, sepse njeriun e lodhin vetë gjërat që i vijnë nga jashtë, kurse ato që i ka pjesë të tërësisë së tij shpirtërore dhe fizike vetëm e plotësojnë.



INVESTIMET MILIONËSHE TURKE NË KOSOVË

Numri i emigrantëve të paligjshëm nga Kosova ende i lartë

Edmond Gashi, nga Qendra Gjermane e Informimit për Migrim, Aftësim Profesional dhe Karrierë thotë se numri i emigrantëve të paligjshëm nga Kosova është ende i lartë. Qendra Gjermane e Informimit për Migrim, Aftësim Profesional dhe Karrierë (DIMAK), qysh prej tri vjetësh ofron në Kosovë informacion dhe këshillime rreth kushteve për migrim legal në Gjermani, mundësitë për arsim dhe aftësim profesional në Gjermani dhe mundësive për praktikë në Kosovë dhe Gjermani. DIMAK, është një prej komponentëve të programit global "Programi Migrim dhe Zhvillim", (PME), i cili financohet nga Ministria Federale gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillimin. Në një intervistë për DW, Edmond Gashi, koordinator kombëtar në zyrën e DIMAK në Prishtinë, thotë se në këtë zyrë kanë kërkuar informacione dhe këshilla të paktën 46 mijë vetë, kryesisht të moshave të reja. Megjithatë, numri i personave që emigrojnë në mënyrë të paligjshme sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, vazhdon të jetë i lartë, ndonëse në shifra shumë më të vogla sesa në vitin 2015.



Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, nga janari deri në gusht të këtij viti, investimet e Turqisë në Kosovë ishin mbi 19 milionë euro, nga 201 milionë euro nga investimet në përgjithësi. Këto të dhëna, Turqinë e radhisin si shtetin e pestë, pas Gjermanisë, Zvicrës, Austrisë dhe Britanisë së Madhe

Përveç investimeve direkte, Kosova ka të nënshkruar marrëveshjen për tregti të lirë me Turqinë që nga viti 2013, por ende nuk është ratifikuar në Kuvendin e Kosovës kurse shteti turk e ka ratifikuar këtë marrëveshje që moti. Marrëveshja për tregti të lirë me Turqinë, sipas ekspertëve, vë në pah disbalancet tregtare mes dyja shteteve, marrë parasysh fuqinë e madhe ekonomike e tregtare që ka Turqia në krahasim me Kosovën

Turqia është një prej shteteve me prezencën më të madhe të investimeve direkte në Kosovë. Njëherësh është një ndër shtetet e para që ka njohur Kosovën me shpalljen e pavarësisë në shkurt të vitit 2008. Mbi 372 milionë euro, llogariten investimet e Turqisë në Kosovë, që nga viti 2008 kur në Kosovë vepron Oda Tregtare Kosovare-Turke, thotë Arben Fetahu, drejtor ekzekutiv i kësaj ode. Në një bisedë për Radion Evropa e Lirë, Fetahu thotë se investimet nga Turqia zënë vendin e parë sa i përket ndikimit në ekonomi. "Realisht vitin e kaluar Turqia e ka zënë vendin e dytë sa u përket investimeve të drejtpërdrejta në Kosovë. Vendin e parë, vazhdimisht e zënë Gjermania ose Zvicra. Por, një gjë që duhet ditur është se investimet e huaja nga Gjermania, Zvicra ose nga Britania e Madhe vende të njohura për diasporën e gjerë kosovare, rëndom janë në patundshmëri, si shtëpi apo banesa". "Kurse investimet e huaja nga Turqia janë të orientuara nga ekonomia, investime të cilat sjellin vende pune dhe gjenerim ekonomik", thotë Fetahu. Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, nga janari deri në gusht të këtij viti, investimet e Turqisë në Kosovë ishin mbi 19 milionë euro, nga 201 milionë euro nga investimet në përgjithësi. Këto të dhëna, Turqinë e radhisin si shtetin e pestë, pas Gjermanisë, Zvicrës, Austrisë dhe Britanisë së Madhe. Investimet turke janë të orientuara në sektorin bankar, edukim, shëndetësi, prodhimtari, energji, ndërtimtari, tregti, hotelieri, transport dhe fusha tjera.

Numri i përgjithshëm i bizneseve turke të regjistruara në Kosovë është rreth 800, thotë Arben Fetahu, por që si-

pas tij, 200 biznese aktualisht janë aktive. Investimet e Turqisë në Ballkan, përfshirë këtu edhe Kosovën, janë të mirëseardhura dhe të nevojshme, thotë Guner Ureva, drejtor i Departamentit për Diplomaci Ekonomike, në Ministrinë e Punëve të Jashtme. "Ballkani është një hapësirë për investime turke, natyrisht duke marrë parasysh edhe lidhjet, komunikimin e investitorëve potencialë turq me vendet e Bashkimit Evropian, shtetet e Ballkanit. Edhe Kosova mund të shërbejë si një bazë që do të prodhohen produktet nga investimet turke më orgjinë në Kosovë për t'u plasuar në tregjet e Bashkimit Evropian", thotë Ureva për Radion Evropa e Lirë. Se kompanitë turke vazhdojnë të paraqesin interesim për investime në Kosovë thonë edhe në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Stamboll. Erven Fusha, konsull i përgjithshëm në detyrë thotë për Radion Evropa e Lirë, se disa herë në javë takohen me biznesmen turq, për t'u treguar kushtet e të bërit biznes në Kosovë. "Përafërsisht kemi katër ose pesë takime në javë me biznesmen apo investitorë të ndryshëm turq që janë të interesuar të investojnë në Kosovë. Interesimet e tyre janë të llojeve të ndryshme, disa dëshirojnë të investojnë në bujqësi, infrastrukturë apo edhe investime tjera më kapital më të madh", tha Fusha.

Ndryshe, përveç investimeve direkte, në Kosovë disa nga kompanitë me kapital më të madh financiar janë dhënë më koncesion konsorciumeve turke. Bechtel-Enka, konzorcium amerikan-turk, ka bërë ndërtimin e autostradës që lidhë Kosovën me Shqipërinë, me një çmim prej një miliard euro, kurse tashmë është

duke ndërtuar edhe autostradën Prishtinë - Shkup, në vlerë mbi 600 milionë euro. Një konsorcium tjetër ai turko-francez, Limak-Aeroport de Lyon në vitin 2010 ka marrë me koncesion për njëzet vjet, Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", me obligimin që të investojë mbi 100 milionë euro në të. Kurse në vitin 2012, konzorciumi turk Limak-Çalik privatizoi rrjetin kosovar të shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, duke e blerë atë për 26.3 milionë euro. Që prej vitit 2004 në Kosovë vepron edhe Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim [TIKA].

Nga ajo periudhë kjo organizatë ka realizuar qindra projekte të ndryshme, si dhe ka restauruar një numër të madh të xhamive, por edhe ka bërë investime në ndërtimin e xhamive të reja në të gjithë Kosovën. Investime nga kjo agjenci ka pasur edhe në sektorin e shëndetësisë dhe këndeve të lojërave në parqe të kryeqytetit.

Nga investimet turke në Kosovë, ndërkaq funksionojnë edhe një numër i institucioneve arsimore. Përveç investimeve direkte, Kosova ka të nënshkruar marrëveshjen për tregti të lirë me Turqinë që nga viti 2013, por ende nuk është ratifikuar në Kuvendin e Kosovës kurse shteti turk e ka ratifikuar këtë marrëveshje që moti. Marrëveshja për tregti të lirë me Turqinë, sipas ekspertëve, vë në pah disbalancet tregtare mes dyja shteteve, marrë parasysh fuqinë e madhe ekonomike e tregtare që ka Turqia në krahasim me Kosovën. Importet e shtetit turk në Kosovë gjatë vitit të kaluar kanë qenë mbi 288 milionë euro, kurse eksportet e Kosovës në Turqi rreth 8 milionë euro.

Serbët fillojnë ndërtimin e hekurudhës së financuar nga Kina



Në Serbi dje ka filluar puna në linjën hekurudhore të financuar nga Kina, që është pjesë e rrjetit kinez të së ashtuquajturës "rrugë të re të mëndafshit" dhe pjesë e premtimeve për zgjerimin e ndikimit të Kinës në Evropë. Projekti është lansuar në periferi të Beogradit, derisa kryeministri i Kinës, Li Keqiang, në Budapest të Hungarisë, është takuar me kryeministren e Serbisë, Ana Bërnabiq, dhe me kryeministrin e Hungarisë, Viktor Orban, në samitin e 16 vendeve të Evropës qendrore dhe lindore. Serbia i ka

huazuar 297.6 milionë dollarë amerikanë nga Banka kineze, Exim, në muajin maj, për modernizimin e hekurudhës ndërmjet Beogradit dhe Budapestit. Kjo linjë hekurudhore që mundëson shpejtësi të madhe të trenave, ndërmjet Beogradit e Budapestit, pritet të kushtojë 3.8 miliardë dollarë dhe planifikohet që të shndërrohet në rrugën kryesore transportuese për mallrat kineze, të cilat aktualisht arrijnë nëpër det në një port të Greqisë dhe vazhdojnë për në pjesët e tjera të Evropës.

KOALICIONI I MADH NUK ISHTE EDHE KAQ I KEQ!

Koalicionet mes partive të mëdha nuk janë të preferuara. Ato e paralizojnë opozitën dhe margjinalizojnë partnerët e vegjël, argumentojnë kritikët. SPD e njeh këtë. Por tani sërish kemi para vetes një koalicion të tillë

SPD është ende në qeveri, por bilancet e legjislaturës që mbaroi ka kohë që janë bërë. E përgjithshmeja: kaq i keq nuk ishte koalicioni i madh i dytë nën Merkelin. Para së gjithash ishte harmonik. Por atmosfera e mirë midis socialdemokratëve dhe konservatorëve nuk mjaftoi për suksese të kalibrit të madh politik.

ÇUDITËRISHT MIRË, ÇUDITËRISHT PAK
Parulla e vitit 2013 e Merkelit "...se ne jemi një koalicion i madh, për të bërë zap detyra të mëdha për Gjermaninë", rezultoi thjesht si frazeologji e bukur. Me shumicën prej 80 përqind në Bundestag u pengua para së gjithash mini-opozita që të jepte qoftë edhe një impuls të vetëm për qeverinë. Reforma të mëdha sidoqoftë nuk u panë gjëkund. Ato pak gjëra që arritën, kanë të bëjnë me reformën e sigurimit për shërbimet sanitare, pensionet për nënat, pensionin me 63 vjeç (për kategori të caktuara), paga minimale dhe kuota e grave. Dashamirësit vlerësojnë si suk-

ses qeverisjen në pjesën më të madhe pa difekte në kohë të vështira. Shtimi i rrezikut të terrorit dhe vërshimi i refugjatëve para së gjithash, u administruan, si probleme. Dhe: konsensusi i shoqërisë u ruajt në njëfarë mënyre, i cili u godit në të njëjtën kohë nga Brexitin në Britaninë e Madhe, në SHBA nga Trumpi dhe në disa pjesë të Evropës lindore përmes një lëvizje rinacionalizimi. Në pikëpamje të politikës sociale, bilanci është i përzier. Megjithë konjunkturën e fuqishme pozitive ekonomike pjesë të mëdha të popullit ndienë pak deri asgjë prej saj. Në bazë të Agjencisë Federale të Punës, në mars 2017 më shumë se 3,2 milionë vetë patën më shumë se një punë, kurse numri i përgjithshëm i atyre që kanë pak punë, në kohët e koalicionit të madh u rrit në 7,5 milionë vetë. Në një kohë që midis viteve 2002 dhe 2012 të ardhurat e dhjetë përqindëshit të sipërm të shoqërisë janë rritur në një shumë dyshifrore, sipas Institutit Gjerman për Studimet Ekonomike (DIW), 40 përqind e atyre që



ndodhen në fund të shkallës së mirëqenies kanë pakësim të të ardhurave.

FUSHATA ELEKTORALE PËR DREJTËSI, E CILA NUK NDEZI

Zhvillime si këto e turbullojnë pamjen e parajsës Gjermani, "ku ne jetojmë mirë dhe me dëshirë", siç thekson herë pas here kancelarja Angela Merkel. Tema kryesore e fushatës elektorale të SPD në vitin 2017, drejtësia, ishte me vend, thotë njeri nga këshilltarët e SPD, Nils Heisterhagen. Vetëm se u shit keq. Në një vështrim pas, ajo që ka mbetur është vetëm përshtypja se SPD në politikën sociale në thelb nuk dëshirojë veprojë ndryshe nga partneri i shumicës i koalicionit. Heisterhageni i rekomandon partisë së tij një kthesë të qartë në politikën e taksave dhe në politikën sociale. "Më shumë guxim për Lafontaine", është kërkesa e tij. Ish-kryetari i SPD, Lafontaine mbështeti në fillim të periudhës si kancelar të Gerhard Schröderit një kurs të tillë. Meqenëse nuk e imponoi dot si kurs, ai e braktisi par-

tinë dhe u bashkua me partinë E Majta. Me marshimin e saj në mesin e shoqërisë, SPD jo vetëm që humbi shumë nga profili i saj. Partia populiste AfD ndërkohë ka më shumë mbështetës tek punëtorët (34 përqind) se partia me traditë e punëtorëve SPD. Edhe më tej: në radhët e AfD ka më shumë sindikalistë (24 përqind) se në SPD (19 përqind). Një zhvillim që ka të bëjë edhe me tetë vitet e kaluara të koalicionit të madh që prej 2005-ës, në të cilat SPD në perceptimin publik mezi dallohej nga partia unioniste e Merkelit. Përsa i përket materies, anëtarët e koalicionit vërtet miratuan shumë gjëra. Mbi 2000 ligje. Por një projekt i madh i përbashkët nuk u pa gjëkund. Tani thirret SPD, sepse negociatat për koalicionin mes unionistëve, liberalëve dhe të Gjellbërve nuk përfunduan me sukses. Jo-ja e prerë për koalicionin e madh zbutet çdo ditë e më shumë. SPD mund të paraqesë kërkesa, por për ta tepruar nuk duhet ta teprtojë. Sepse Merkel ka edhe një fishek në karrikator: qeverinë e minoritetit.

I dënuar gabimisht, lirohet pas 40 vitesh



Craig Coley, 70 vjeç nga Los Angeles, u lirua nga burgu pas thujse 40 vitesh, pasi një gjykatë vendosi se ai ishte burgosur gabimisht. Coley kaloi më shumë se gjysmën e jetës së tij pas hekurave, i akuzuar dhe dënuar për vrasjen e partneres dhe djalit të tij. Lirinë, megjithëse tej mase të vonuar, ia kushton një detektiv që besoi në pafajësinë e tij. Në vitin 1978, Coley u ndalua pasi partnerja e tij Rhonda Wicht, 24 vjeç, dhe djali i tyre Donald, 4 vjeç, u gjetën të vrarë në shtëpi. Craig Coley, në atë kohë 31 vjeç, ishte i dyshuari kryesor dhe pavarësisht një gjyqi të parë të pasuksesshëm, Prokuroria pati sukses në përpjekjen e dytë dhe ai u dënua me burgim të përjetshëm. 11 vite më vonë, në vitin 1989, detektiv

Mike Bender hapi rastësisht dosjen e Craig Coley dhe që në faqet e para kuptoi se shumë gjëra nuk shkonin. Pas një hetimi intensiv, Bender u bind se Coley ishte i pafajshëm dhe nisi betejën shumëvjeçare me autoritetet për të rihapur çështjen. Kjo u bë e mundur vetëm në vitin 2015, pasi ish-policë treguan se që prej asaj kohe besonin se Coley nuk ishte fajtor. Hetimi i ri tregoi pa as më të voglin dyshim se, ADN-ja e Coley, e cila ishte përdorur si provë dërmuese dekada më parë, as që ekzistonte mes provave. Gjykatësi urdhëroi me shpejtësi lirimin e Coley, i cili doli nga burgu në kohë për Ditën e Falenderimeve, që e kaloi në shtëpinë e mikut të tij më të mirë, detektivit Mike Bender.

Publicitet

Në bazë të nenit 93 të Ligjit për Sistem hekurudhor
NDËRMARRJA PUBLIKE PËR INFRASTRUKTURË HEKURUDHORE
 PUBLIKON ORARIN E TRENAVE PËR VITIN 2017/2018

Nisja nga Shkupi					Arritje				
Lloji i trenit	Nr. trenit	Ora-min	Në stacion	Ora-min					
Rajonal	2081 (JoD)	04.15	Veles	05.01	I shpejt	891	(Prishtinë)Vollkovë	09.30	09.52
Ekspres	335	04.45	Gjevgjeli	07.23	Inter rajonal	632	Veles	11.47	12.38
Inter rajonal	611	06.20	Gjevgjeli	09.08	Rajonal	2082 (JoD)	Veles	14.23	15.20
Inter rajonal	600	06.30	Tabanoc	07.24	Inter rajonal	642	Manastir	12.50	16.14
Inter rajonal	641	06.42	Manastir	10.16	Rajonal	2021	Tabanoc	17.50	18.44
Inter rajonal	613	09.00	Veles	09.53	Inter rajonal	634	Gjevgjeli	16.55	19.31
Rajonal	2083 (JoD)	13.20	Veles	14.11	Rajonal	2023	Tabanoc	20.15	21.09
Inter rajonal	643	14.30	Manastir	17.52	Ekspres	334	Gjevgjeli	19.48	21.54
I shpejt	892	16.10	Vollkovë (Prishtinë)	16.35	Inter rajonal	644	Manastir	18.30	22.05
Rajonal	2020	16.35	Tabanoc	17.30					
Inter rajonal	651	16.40	Koçan	19.26					
Inter rajonal	660	16.50	Kërçovë	18.54					
Inter rajonal	631	16.55	Gjevgjeli	19.38					
I.Rajonal ekspres	541	17.10	Manastir	19.56					
Rajonal	2022	19.00	Tabanoc	19.55					
Inter rajonal	645	20.10	Manastir	23.41					
Ekspres	334	22.19	Tabanoc (Beograd)	23.29					
Rajonal	2085	22.40	Veles	23.31					
Rajonal	2024	23.00	Kumanovë	23.39					

(JoD) – Nuk ka komunikacion ditën e diell

Orari i trenave futet në fuqi prej më datë 10.12.2017 deri më 8.12.2018.

**NP HM INFRASTRUKTURA
SEKSIONI PËR ORARIN E TRENAVE**

9/2-63
29.11.2017 Deri te
Lënda: Orari i ri i trenave Redaksia

Ju informojmë se më datë 10.12.2017 në ditën e diell futet në fuqi orari i ri i trenave në komunikacionin ndërkombëtar dhe të brendshëm.

Si shtojcë keni përmbajtjen e orarin e ri të trenave

TRENAT

Për orarin e trenave prej më 10.12.2017 deri më 8.12.2018

Shkup – Gjevgjeli: 04.45 (e); 06.20 (ir) ; 16.55 (ir);
 Shkup – Veles: 04.15 (JoD) (r) ;04.45 (e) ; 06.20 (ir) ; 06.42 (ir) ; 09.00 (ir) ; 13.20 (JoD) (r) ; 14.30 (ir); 16.40 (ir); 16.55 (ir); 17.10 (e); 20.10 (ir); 22.40 (r);
 Shkup – Manastir: 06.42 (ir); 14.30 (ir); 17.10 (e); 20.10 (ir);
 Shkup – Tabanoc: 06.30 (ir); 16.35 (r); 19.00 (r) ; 22.19 (e);
 Shkup – Kumanovë: 23.00 (r) ;
 Shkup – Kërçovë: 16.50 (ir) ;
 Shkup – Koçan: 16.40 (ir) ;
 Shkup – Nish – Beograd: 22.19 (e);
 Shkup – Vollkovë – Prishtinë: 16.10 (b) ;

(JoD) – Nuk ka komunikacion ditën e diell.

NP HM INFRASTRUKTURA
ORARI I TRENAVE

(JoD) – Nuk ka komunikacion ditën e diell]

Nisja					Arritje në Shkup				
Lloji i trenit	Nr. trenit	Nga Stacioni	Ora-min	Ora-min					
Ekspres	335	(Beograd)Tabanoc	03.45	04.25					
Inter rajonal	600	Veles	05.03	05.58					
Inter rajonal	611	Tabanoc	05.15	06.09					
Inter rajonal	640	Manastir	03.10	06.35					
Rajonal	2080 (JoD)	Veles	06.10	07.05					
Inter rajonal	630	Gjevgjeli	04.43	07.33					
Inter rajonal	661	Kërçovë	05.30	07.32					
Inter rajonal	650	Koçan	05.00	07.50					
I.Rajonal ekspres	540	Manastir	05.20	08.07					
Inter rajonal	613	Tabanoc	07.50	08.44					



РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
 МИНИСТЕРСТВО ЗА ФИНАНСИИ
 ЦАРИНСКА УПРАВА

Në bazë të Ligjit për shfrytëzimin dhe disponim me sendet në pronësi shtetërore dhe sendet në pronësi komunale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 78/15, 106/15 dhe 153/15), Ligjit për vlerësim ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 115/10, 158/11, 185/11, 64/12, 188/14, 104/15, 153/15, 192/15, dhe 30/16) Udhëzimit për mënyrën dhe procedurën për dhënie me qira të objekteve dhe lokacioneve për hapësirë reklamuese në vendkalimet kufitare për komunikacionin rrugor (numër 01-083294/16-0001 datë 14.12.2016 dhe Vendimeve për dhënie me qira të objekteve në vendkalimet kufitare për komunikacionin tokësor nr. 44-954/1 dhe nr. 44-1389/1 të datës 28.03.2017 ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 41/17), miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë,

Drejtoria doganore e Republikës së Maqedonisë

rr. Lllazar Liçenovski nr. 13, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë publikon

SHPALLJE numër 3/2017 PËR DHËNIEN ME QIRA TË OBJEKTEVE NË VENDKALIMET KUFITARE

ndaras sipas vendkalimeve kufitare për komunikacion rrugor

1. Objektet e përhershme të cilat jepen me qira:

A. Veptrimaria themelore përfaqësim doganor ose sigurim të personave dhe automjeteve ose veptrimari e këmbimit valutor **Publikimi i dytë**

Numri rendor	Vendkalimi kufitar	Lokali numër	Sipërfaqja (m2)	Lloji i ndërimit	Fleta poseduese (FP), Komuna Kadastrale (KK), Parcela kadastrale	Çmimi fillestar i qirasë mujore në denarë për ankaand pa TVSH (0,5% nga shumata e vlerësuar)	Garancioni bankar për seriozitetshmëri (2% e shumës së vlerësuar)	Vlera minimale e Garancionit bankar për obligimet sipas kontratës	Dita dhe ora e ankandit publik
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	Bllacë	88	25,34	Objekt i përhershëm	KK Bllacë Kala PK 3423, FP 377	10.686,00	42.743,00	110.000,00	20.11.2017 Ora 11:00
2	Bllacë	90	25,34	Objekt i përhershëm	KK Bllacë Kala PK 3423, FP 377	10.686,00	42.743,00	110.000,00	20.11.2017 Ora 11:30
3	Bllacë	91	25,34	Objekt i përhershëm	KK Bllacë Kala PK 3423, FP 377	10.686,00	42.743,00	110.000,00	20.11.2017 Ora 12:00

1. B. Veptrimari themelore tregti me pakicë me ushqim të paketuar dhe pije joalkoolike ose veptrimari hotelerike **Publikimi i dytë**

Numri rendor	Vendkalimi kufitar	Lokali numër	Sipërfaqja (m2)	Lloji i ndërimit	Fleta poseduese (FP), Komuna Kadastrale (KK), Parcela kadastrale	Çmimi fillestar i qirasë mujore në denarë për ankaand pa TVSH (0,5% nga shumata e vlerësuar)	Garancioni bankar për seriozitetshmëri (2% e shumës së vlerësuar)	Vlera minimale e Garancionit bankar për obligimet sipas kontratës	Dita dhe ora e ankandit publik
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	Bllacë	10	27,00	Objekt i përhershëm	KK Bllacë PK 2773/1, FP 386	11.185,00	44.741,00	110.000,00	20.11.2017 Ora 12:30

Dokumentet e domosdoshme për pjesëmarrje në ankandin publik për përfaqësim doganor ose veptrimari e këmbimit valutor:

Fletëparaqitja e plotësuar për pjesëmarrje në ankandin publik (Formulari numër 1),
 Garancioni bankar për seriozitetshmëri respektivisht për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik,
 Vërtetim për veptrimarinë e regjistruar të personit juridik dorëzues i fletëparaqitjes,
 Gjendja aktuale e dorëzuesit të fletëparaqitjes,
 Deklarata me të cilën obligohet se nëse zgjidhet për ofertues më i mirë, në afatin prej pesë 5 ditësh nga dita e pranimit të lajmërimit për përzgjedhjen do të lidh kontratë për qiramarrje,
 Deklarata – Formulari numër 2,
 Leja për ushtrimin e punëve për përfaqësim në procedurat doganore,
 Garancione të përgjithshme të pranuar për procedura tranzitore,
 Vërtetim ose Deklaratë për orarin e punës.
 Leje për ushtrimin e veptrimarisë së këmbimit valutor për veptrimari themelore të veptrimarisë së këmbimit valutor, ose Deklaratë se në objektin për të cilin dorëzon fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik do të filloj ushtrimin e veptrimarisë themelore veptrimari e këmbimit valutor, menjëherë pas marrjes së Lejes për ushtrimin e veptrimarisë së këmbimit valutor nga Banka popullore e RM-së.

Dokumentet e domosdoshme për pjesëmarrje në ankandin publik për veptrimari të sigurimit të personave dhe automjeteve:

Fletëparaqitja e plotësuar për pjesëmarrje në ankandin publik (Formulari numër 1),
 Garancioni bankar për seriozitetshmëri respektivisht për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik,
 Vërtetim për veptrimarinë e regjistruar të personit juridik dorëzues i fletëparaqitjes,
 Gjendja aktuale e dorëzuesit të fletëparaqitjes,
 Deklarata me të cilën obligohet se nëse zgjidhet për ofertues më i mirë, në afatin prej pesë 5 ditësh nga dita e pranimit të lajmërimit për përzgjedhjen do të lidh kontratë për qiramarrje,
 Deklarata – Formulari numër 2,
 Leja për ushtrimin e punëve për sigurim në kuadër të klasës së sigurimit nga përgjegjësia nga përdorimi i automjeteve, për SHA për sigurime.
 2. Teksti integral i Shpalljes së ankandit publik, Fletëparaqitja (Formulari numër 1) dhe Deklarata (Formulari numër 2) për pjesëmarrje në ankandin publik, mund të merren nga faqja e internetit të Drejtorisë doganore <http://www.customs.gov.mk>.
 3. Paraqitja për pjesëmarrje në ankandin publik në mënyrë elektronike bëhet nëpërmjet sistemit elektronik për ankand publik të Ministrisë së financave në këtë faqe të internetit e-aukci.finance.gov.mk.
 -Fletëparaqitja e plotësuar për pjesëmarrje në ankandin publik së bashku me dokumentacionin e domosdoshëm, duhet të jenë të skanuara në një dokument pdf dhe i njëjti bashkëngjitet në pjesën e "Deklaratës",
 -Garancioni bankar skanohet në dokumentin pdf dhe i njëjti bashkëngjitet në pjesën "Garancioni bankar".
 4. Fletëparaqitja për pjesëmarrje në ankandin publik së bashku me dokumentacionin e domosdoshëm, përveç se në mënyrë elektronike dorëzohet edhe nëpërmjet postës në adresën e Drejtorisë doganore ose në mënyrë direkte në arkivin e Drejtorisë doganore rr. "Llazar Liçenovski" nr. 13 1000 Shkup, në pliko të mbyllur në të cilin shënohet numri i shpalljes me shënim – për Komisionin për disponimin me sendet e luajtshme dhe të pa luajtshme në pronësi të Republikës së Maqedonisë.
 5. Një pliko e mbyllur vlen për një fletëparaqitje për një veptrimari dhe për një hapësirë afariste.
 Në çdo pliko të mbyllur duhet të ketë dy pliko tjera të mbyllura – një për fletëparaqitjen për pjesëmarrje në ankandin publik dhe garancionin bankar për seriozitetshmërinë e ofertës (pika 9.1 e kësaj shpallje), të cilat dorëzohen në origjinal, ndërsa një pliko tjetër e mbyllur është për dokumentacionin e obligueshëm të parashkuar në pikën 8.2. dhe 8.3 të kësaj shpallje.
 6. Afati për dorëzimin e fletëparaqitjes për pjesëmarrje në ankandin publik me dokumentacionin e obligueshëm është deri më datë 11.12.2017.
 Ankandit publik për çdo hapësirë afariste veçmas do të mbahet në mënyrë elektronike në këtë adresë të internetit <http://e-aukci.finance.gov.mk>
 Ankandit publik do të filloj në terminin e caktuar të dhënë në kolonën 10 të tabelave të mëposhtme, për çdo objekt në veçanti.
 Shkup, 28.11.2017
 Drejtoria doganore e Republikës së Maqedonisë

EKSKLUZIVE: DOKUMENTE QË SHOHIN DRITË PËR HERË TË PARË

Banorët e Livadhisë ndër të tjera kërkuan që në ato komuna ku jetojnë shqiptarët, gjuha shqipe të trajtohet në mënyrë të barabartë, sikurse edhe gjuha maqedonase, përkatësisht në këtë komuna të dy gjuhët të përdoren si shtetërore pa majorizimin e njëjës apo tjetrës

Qerim LITA

Të premten e kaluar shpалosëm dokumentin, përkatësisht kërkesën e banorëve të fshatit Negotinë të Gostivarit, dalë nga tubimi i qytetarëve të organizuar më 29 mars 1991, përmes së cilës veç tjerash u kërkua ndërprerja e menjëhershme e politikës diskriminuese të udhëheqjes së atëhershme "pluraliste" të RS të Maqedonisë kundër kombit shqiptar, i cili diskriminim shtrihej si në aspektin nacional (asaj kohe shqiptarët emërtoheshin si "pakicë nacionale" apo "minoritet"), po ashtu edhe në atë arsimor, kulturor, ekonomik etj. Tubime të tilla u mbajtën anë e mbanë vendbanimeve shqiptare, në të cilat u kërkua ndërprerja e menjëhershme e fushatës antishqiptare, e cila asaj kohe zbatohesh jo vetëm nga strukturat udhëheqëse politike e shtetërore, por edhe nga mjetet e informimit në gjuhën maqedonase, qofshin ato elektronike apo të shkruara. Këta të fundit nuk zgjidhnin mënyra e mjete për t'i ofenduar shqiptarët, duke i emërtuar si "shiptari", "nacionalistë", "separatistë" e shumë etiketa e ofendime tjera, të cilat preknin rëndë në sedrin e krenarinë e çdo shqiptari. Tërë ajo fushatë mediatike maqedonase, burimet e kishte te struktura më e lartë shtetërore. Në këtë numër po e shpалosim, kërkesën e banorëve të fshatit Livadhi, drejtuar kryetarit të RS të Maqedonisë, Kiro Gligorov, kryetarit të Kuvendit të RSM-së, Stojan Andov, nënkryetarit të RS të Maqedonisë, Xheladin Murati, kryeministrit, Nikolla Klusev dhe anëtarit të Kryesisë së RSFJ-së, Vasil Turkovski. Dokumenti prej 17 pikash, doli nga tubimi i qytetarëve, i mbajtur më 18 mars të vitit 1991, dhe se për të, siç thuhet, në mënyrë plebiscitare janë deklaruar të gjithë qytetarët e fshatit Livadhi.

"Ofendimet e rënda që po u shkaktohen shqiptarëve në kohë të fundit, në Komunën e Strugës e më gjerë përmes shtypit ditor—ra-

KËRKESË E BANORËVE TË FSHATIT LIVADHI TË STRUGËS



• Fshati Livadhi

dios e televizionit, gjithashtu edhe nga partitë e ndryshme, qarqe të caktuara si (lidhja e luftëtarëve) etj., në mënyrë energjike si dhe të ofenduar rëndë i hedhim poshtë si të pabazuara e qëllimkëqija, qofshin për shkak krizës ekonomike—politike dhe përkeqësimit të marrëdhënieve ndërnacionale në republikën tonë, fajtor më së paku është kombi shqiptar, për arsye se kuadrat e kombit shqiptar nuk kanë bartë asfarë funksioni në komunë e Republikë që do të kontribuonin rreth të mësipërmës. Të ofenduar e të tronditur nga sjellja e disa ligjeve nga mbledhja e fundit e Kuvendit të RS të Maqedonisë si dhe nga rezultatet e disa mbledhjeve të mëparshme, ne banorët, përkatësisht qytetarët e fshatit Livadhi me 1.300 banorë, kërkojmë me sa më poshtë vijon:

1. Kryetari i RS të Maqedonisë, zoti Kiro Gligorov, të mos i nënshkruaj dy ligjet e miratuara (me mbivotim e majorizim), në mbledhjen e Parlamentit, përkatësisht Ligjin për arsim fillor e të mesëm.

2. Shqiptarët nuk janë pakicë, e as minoritet, siç thuhet në secilën mbledhje të Parlamentit Republikan, kuvendet komunale si dhe në disa forma tjera të tubimeve qytetare, por jemi komb autokton, ku me shekuj jetojmë në vatrata tona dhe në RS të Maqedonisë marrim pjesë me 40% të popullsisë së përgjithshme edhe pse në Kuvend përfaqësohemi me 19% ose 23 deputet.

3. Sa më parë të hapen shkollat e arsimimit të mesëm, duke filluar nga viti i ardhshëm shkollor 1991/92, si në komunën tonë po ashtu edhe në vendet tjera ku jetojnë shqiptarët të cilat shkolla qenë mbyllura para disa viteve nga mbeturinat e njëmendësisë e burokratike të sistemin monist, të cilët edhe sot e kësaj dite janë në

pushtet. Në komunën tonë për çdo vit shkollor rreth 500 nxënës e mbarojnë shkollimin fillor në gjuhën shqipe të cilët më pas ngjelin të peregjistruar në shkollat e mesme.

4. Në RS të Maqedonisë funksionojnë dy universitete, njëri në Shkup e tjetri në Manastir, në të cilën nuk ka asnjë degë qoftë ajo të jetë e lartë apo fakultet ku do të mësonin fëmijët e kombit shqiptar, për këtë arsye kërkojmë që sa më parë që është e mundur të hapen disa fakultete në gjuhën shqipe.

5. Kërkojmë përgjegjësinë e Savo Klimovskit nga fakti se ka kryer shkelje flagrante ndaj arsimit shqiptar, si ideolog i mbylljes së shkollave shqipe të garantuara me ligjet dhe Kushtetutën në fuqi të RSFJ-së.

6. Evidenca pedagogjike dhe dokumentacioni i administratës, në shkollat ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, gjithsesi se të udhëhiqet në gjuhën përkatëse përndryshe nuk do të lejojmë që ajo të udhëhiqet në gjuhën maqedonase.

7. Të ndërpritet me masat represive të cilat në kohë të fundit po zbatohen ndaj kombit shqiptar si: mbylljen e dyqaneve private, kafeneve e restoranteve private, dënime me burg për aksione humanitare, dënime pa arsye në komunikacion, marrje dhe mosdhënie e pasaportave etj. etj...

8. Të lirohen të gjithë të burgosurit për shkak delikteve politike, të dënuar e të cilët dënimin e vuajnë si bastion e të burgosurve në Maqedoni, Serbi e Mal të Zi.

9. Kërkojmë që RS e Maqedonisë të jetë shtet sovran i të gjitha kombeve të cilët jetojnë në të e njëherit edhe i kombit shqiptar si sovran i atij shteti.

10. Kërkojmë—në ato komuna

ku jetojnë shqiptarët, gjuha shqipe të trajtohet në mënyrë të barabartë, sikurse edhe gjuha maqedonase, përkatësisht në këtë komuna të dy gjuhët të përdoren si shtetërore pa majorizimin e njëjës apo tjetrës.

11. Kërkojmë që RTV i Shkupit, përkatësisht Televizioni i Maqedonisë, një kanal të programit ta ketë në gjuhën shqipe (kuadër ka) në të kundërtën nuk do të marrim pjesë në participimin e mjeteve për programin televiziv.

12. Kërkojmë ligj të ri për zgjedhje e të mbahen zgjedhjet e reja.

13. Nuk e pranojmë si legjitime Kuvendin Komunal të komunës së Strugës, i cili u konstitua më 23 janar 1991, i cili deri në ditën e sotme nuk ka mbajtur asnjë mbledhje të Kuvendit për arsye se nga çlirimi e deri më sot nuk ka ndodh që në funksione shoqërore (kryetar, nënkryetar, sekretar të jetë nga kombet tjera përkatësisht të kombit shqiptar), faktikisht nga 50 këshilltarë, 20 janë nga Partia për Prosperitet Demokratik, do të thotë 40% dhe të njëjtat përbëjnë 50% e popullsisë në komunë ndërsa nuk janë përfshi askund e as që janë konsultuar.

14. Në të gjitha komisionet për regjistrimin e popullsisë (republikane, komunale, lokale) i cili do të mbahet nga 1 prilli 1991 deri më 15 prilli 1991, në komunat ku jeton edhe kombi shqiptar të sigurohet në mënyrë përkatëse numri i njëjtë i anëtarëve të komisioneve. Në të kundërtën do të paraqitet mosbesim në rezultatet dhe zbatimi i regjistrimit joreal atëherë do të jemi të detyruar ta bojkotojmë regjistrimin e popullsisë.

15. Në Kuvendin e RS të Maqe-


donisë për çështje me rëndësi siç janë: të drejtat e kombeve (arsimi, kultura, simbolet, flamuri, gjuha, toponimet, emërtimi i fëmijëve të porsalindur sipas dëshirës së prindërve të tyre etj.) të zgjidhet me konsensus e jo me mbivotim e majorizim në të kundërtën nuk do të pranojmë asnjë akt të cilin do ta sjell Kuvendi.

16. Vlerësojmë me keqardhje se vetëm kombi shqiptar e pranon shtetin e Maqedonisë dhe kombin maqedonas. Për këtë arsye t'i mendoni dhe vlerësoni mirë qasjet dhe ofendimet dhe tërhiqni nga përdorimi fjalët: "shiptari, shiftari" etj., në të kundërtën do të përdorim fjalë të cilat nuk i bënë nderë një kombi të civilizuar.

17. Nëse nuk përmbushen kërkesat tona, atëherë nuk do ta ngel tjetër, përveç se çështjen tonë në Strugë, Maqedoni e më gjerë ta internacionalizojmë në organizata të ndryshme etj. Gjithashtu nuk marrim përgjegjësi për pasojat të cilat do të ndodheshin më pas, do të kërkojmë të tërhiqen deputetët nga Parlamenti i Maqedonisë dhe kërkojmë që brenda 15 ditëve të na jepet përgjigje.

Fshati Livadhi, 18 mars, 1991.

Për këtë kërkesë banorët e fshatit Livadhi u deklaruan përmes nënshkrimeve të tyre.



ISMAIL KADARE, SHKRIMTAR

NUK MUND TË ANKOHEMI SE REGJIMI NA PRISHI GJUHËN

Në Shqipëri nuk u bë asgjë e jashtëzakonshme. Përkundrazi, u bë ajo që është bërë në të gjitha vendet europiane. Pra, Kongresi është një nga forumet që ka marrë pjesë në këtë gjë. Partia Komuniste donte të merrte patronazhin e saj, të merrte lavdinë, se është ajo që e krijoi Gjuhën e Njësuar Shqipe, gjë që s'është e vërtetë. Sepse gjuhën e njësuar nuk e krijon kurrë një regjim politik, një parti ose një diktaturë. Por ajo e mori në patronazh dhe u sugjestionuan të gjithë, duke e pranuar këtë mashtrim.

Zoti Kadare, çfarë vlere ka për ju sot Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe? Sipas jush, cili ka qenë roli i tij në historinë e gjuhës shqipe?

Mendoj se për këtë kongres po bëhen shumë spekulime. Nga njëra anë, sigurisht, ka qenë rritja e rëndësisë së tij ose glorifikimi i tij nga pushteti, nga regjimi komunist në Shqipëri. Nga ana tjetër, ka qenë një mohim i tij total, duke e quajtur si një manipulim të regjimit. Mendoj se e vërteta është midis të dyjave. Kongresi i Drejtshkrimit nuk është asnjë gjë për t'i ngritur monument, për ta glorifikuar, por nuk është as edhe një gjë që duhet mal-lkuar, që duhet rrëzuar.

A mendoni se Kongresi ka vendosur kufizime për ndonjërin nga dialektet?

Besoj se nuk mund të flitet me terma kaq të prera. Kongresi, siç thashë, është në vazhdim të një prirje të vjetër, gati shekullore, që gjuha shqipe, ashtu si gjuhët e tjera europiane, të shkojë drejt njësimi. Pra, është një aspiratë e vjetër, e natyrshme, në harmoni, e detyrueshme e një kulture. Në Shqipëri nuk u bë asgjë e jashtëzakonshme. Përkundrazi, u bë ajo që është bërë në të gjitha vendet europiane. Pra, Kongresi është një nga forumet që ka marrë pjesë në këtë gjë. Partia Komuniste donte të merrte patronazhin e saj, të merrte lavdinë, se është ajo që e krijoi Gjuhën e Njësuar Shqipe, gjë që s'është e vërtetë. Sepse gjuhën e njësuar nuk e krijon kurrë një regjim politik, një parti ose një diktaturë. Por ajo e mori në patronazh dhe u sugjestionuan të gjithë, duke e pranuar këtë mashtrim. Në të vërtetë, duke qenë në ndikim të regjimit, në Kongres u bënë edhe gabime, por jo të asaj natyre dramatike ose tragjike sa për të mohuar atë dhe për ta rikthyer procesin gjuhësor 30 e sa vjet prapa, sepse kjo do të ishte një humbje e jashtëzakonshme për kulturën shqiptare. Gabimet që u bënë, pra, nuk janë të asaj peshe që mund të përlligjin një kthim prapa. Kthimi prapa do të ishte vërtet një dramë e rëndë për kulturën shqiptare, do të krijonte probleme të jashtëzakonshme të

cilat do të donin edhe gjysmë shekulli tjetër për t'u zgjidhur.

Cilat janë ato gabime që u bënë në Kongres për të cilat po flisni, zoti Kadare?

Gabimet që u bënë në Kongres kanë qenë se një grup shkencëtarësh stalinistë, gjuhëtarë stalinistë, për fat të keq, ka pasur të tillë, u përpoqën aq sa mundën të ndikonin në çdo mënyrë që ta nënvleftësonin fondin, pasurinë e fjalorit, të njërit prej dy dialekteve kryesore, atë të gegërishtes. Në mënyrë gati tinëzore, duke bërë sikur harruan, duke bërë sikur iu shpëtoi, duke bërë sikur nuk iu ranë sy, lanë jashtë fjalorit që u hartua fill pas Kongresit të Drejtshkrimit, një pjesë të madhe të pasurisë gjuhësore. Kurse në sistemin sintaksor, në bazat e strukturës së gjuhës, nuk besoj se u bënë gabime dramatike. Natyrisht kanë kaluar 30 vjet dhe ka gjëra për t'u korrigjuar. Bashkë me qortimin e këtyre, do të qortohej edhe ajo ana meskine, sepse në çdo mënyrë u përpoqën ta denigronin pasurinë, sidomos të shkrimtarëve katolikë të veriut. Pra, bashkë me këtë korrigjim, për të cilin unë mendoj se është korrigjim themelor që duhet bërë, mund të rishikohen disa nga rregullat të cilat janë vendosur ndoshta jo drejt. Kjo gjë mund të bëhet dhe duhet të bëhet. Është gjë e natyrshme. Në çdo vend, në Greqi, për shembull, pas Kongresit të Drejtshkrimit, janë bërë reforma gjuhësore. Dy vjet më parë, në Gjermani u rishikuan disa rregulla ortografike pas një polemike 10-vjeçare. Një gjuhë e madhe si gjermanishtja, e kristalizuar gjatë shekujve, përsëri, herë pas here, e lyp nevoja dhe diçka ndryshohet. S'ka asgjë të panatyrshme në këtë gjë. Por në gjuhën shqipe, në bazën e saj nuk ka gjëra themelore për t'u rishikuar. Gjuha shqipe është një bazë e strukturuar që askush nuk mund t'i prishë natyrën e saj.

Ju jeni njëri nga shkrimtarët që keni ndikuar në pasurimin e leksikut të shqipes me fjalë e forma të reja dhe këtë e keni bërë edhe në kohën e regjimit komuni-

st. Në ç'formë është pasqyruar ndikimi i politikës zyrtare të asaj kohe në politikën gjuhësore dhe në atë letrare?

Unë mendoj se te gjuha e shkrimtarëve regjimi nuk duhet të loz-te asnjë rol. Nuk mund të justifikohen shkrimtarët shqiptarë e të thonë: unë pata gjuhë të varfër sepse më varfëroi regjimi. Ky është një mashtrim, një sharlatanizëm. Ne shkrimtarët kemi përgjegjësi për gjërat tona, regjimi ka përgjegjësi për gjërat e veta. Ne nuk mund të ankohe mi se regjimi na prishi gjuhën. Lidhur me atë se atij iu ndalua njëri dialekt, ai i gegërishtes në kohën e komunizmit, kjo ka qenë më tepër dinake, sepse stimulohej në çdo mënyrë që është mirë të shkruhet me këtë tjetrin dialekt nga shkrimtarët, kurse për t'u ndaluar, nuk është ndaluar asnjëherë. Unë di disa shkrimtarë të veriut që kanë vazhduar me kokëfortësi të shkruanin në dialektin e tyre deri sa vdiqën. Por, natyrisht, kur ka një gjuhë standard, asnjë vend në botë nuk lejon që në shkollë, në shtyp, në radio, televizion të ketë dy gjuhë. Është vetëm njëra që sundon. Kurse çdo shkrimtar ka të drejtën e tij të krijimit ta bëjë gjuhën si të dojë ai, ta kthejë kokëposhtë, po deshi, është e drejta e tij private. Këtu ngatërrohen shumë njerëz, sepse harrojnë përgjegjësitë që ka shkrimtari dhe përgjegjësitë që ka shteti ose qeveria. Po them, që shkrimtari mund të bëjë çfarë të dojë.

Ndërkohë, shumë intelektualë në vitet 90' dalën me hipoteza se gjuha e njësuar shqipe favorizoi një dialekt duke denigruar tjetrin dhe gjatë gjithë kësaj kohe është dëshmuar se ajo nuk u familarizua me pjesën më të madhe të atyre që shqipen e quajnë gjuhë amtare...

Nuk ka askund që dy dialekte të ecin paralelisht. Njëri do të jetë gjuhë standard, tjetri mundësisht të ndihmojë me pasurimin e tij. Nuk mund të ketë dy gjuhë shqipe. Kjo është naive nga ana shkencore ta mendosh, sepse në të gjitha vendet e botës ka pasur disa dialekte dhe njëri prej tyre, për një arsye ose tjetër, dialekti i

një zone, i një qyteti, bile edhe i një njeriu është bërë gjuhë standard. Që Shqipëria të bëjë përjashtim e të ketë dy gjuhë, këto më duken versione të sugjerimeve që i bëhen kombit shqiptar për t'u përçarë sa më shumë: ka mundësi të ndahen veç gegë e toskë, të ndahen veç katolikë, ortodoksë e myslimanë!!! Janë bërë këto marifete në Shqipëri, janë bërë këto sugjerime të mbrapshta antishqiptare. Nuk ka pse Shqipëria të bëjë dallim dhe ndryshe nga Gjermania, e cila, gjithashtu, ka pasur dhe ka ende shumë dialekte, ose nga Franca apo Italia. Nuk ka pse Shqipëria të dalë tashti me dy gjuhë. Këto janë marrëzitë tona që vijnë ose nga injoranca, ose nga burime krejt të dyshimta. Është pjesë e një programi shumë këmbëngulës për të mbjellë në Shqipëri përçarje me çdo kusht. Shkencëtarët e intelektualët tanë kanë për detyrë morale një mision para popullit shqiptar; të sqarojnë se si ndodh që një dialekt të bëhet zotëruar në një gjuhë. Që u bë njëri nga dy dialektet është një gjë krejt normale. Mund të bëhej dialekti i veriut, mund të bëhej ai i jugut. Natyrisht politika shqiptare diktatoriale donte në çdo mënyrë të bëhej dialekti i jugut për arsye që i dimë, për arsyet e armiqësisë së tyre, instiktive gati, për kulturën veriore të shqiptarëve të veriut, sidomos kulturën katolike. Por kjo nuk mund të bëhej me kokëfortësi kundër rregullave të përgjithshme të kulturës. Gjuha shqipe nuk është një gjuhë indigjenësh që mund të merrej nëpër këmbë nga një byro politike e cila përbëhej kryesisht nga injorantë. Gjuha shqipe është kaq e formuar sa që kurrsesi nuk mund të deformatohej në këtë mënyrë.

Në qoftë se kemi parasysh që kohëve të fundit po shkruhet edhe një gjuhë letrare dhe në dialektin gegë, kujt i shërben kjo, zoti Kadare?

Mua më duket krejtësisht normale që shkrimtarët të shkruajnë si të duan. Nuk ka asgjë të keqe. Në gjuhën standard, ndërkaq kjo është e palejueshme. Në Francë, për shembull, është ndaluar me

ligj përdorimi në gjuhën standard i fjalëve që nuk i ka aprovuar akademja. Në çdo vit del një numër fjalësh 20 deri në 30 që aprovohen. Ndryshe, është e ndaluar me ligj dhe dënohen ata që i përdorin. Kurse shkrimtarët mund të shkruajnë secili si të dojë; ajo është gjuha private e tyre në krijimtarinë letrare.

Rrethanat e reja politike sociale për shqiptarët kërkojnë reagime të shpejta nga gjuha dhe gjuhëtarët. Cila do të jetë strategjia e re gjuhësore në këtë situatë dhe rrugët për pasurimin e gjuhës shqipe?

Në procesin e një gjuhe lozin një rol shumë të madh njerëzit që janë të njohur në publik. Por kush janë ata? Dy janë kategori e njerëzve që lozin rol në gjuhë për t'u imituar nga të tjerët; në gjuhën e përditshme janë politikanët dhe aktorët. Tani politikanët, për fat të keq, për shkak të injorancës përdorin jashtëzakonisht fjalë të huaja për t'i dhënë vetes autoritet duke e shkatërruar kështu një pjesë të gjuhës, gazetarët injorantë që, gjithashtu, shkojnë pas tyre ose edhe një pjesë aktorësh që përdorin të njëjtën gjuhë. Kjo ka sjellë probleme të rënda në Shqipëri. Detyra urgjente është ruajtja e pasurisë së gjuhës shqipe, jo për të rënë në puritanizëm. Ruajtja e pasurisë së një gjuhe është detyrë, është një gjë e shëndetshme në një gjuhë. Ne jemi të detyruar të ruajmë identitetin e gjuhës shqipe, e cila nuk ka nevojë të mbulohet nga një mori fjalësh të huaja të panevojshme. Gjuha shqipe është një makinë e mrekullueshme e të shprehurit, një nga makinat më të përsosura të Europës, nga ana e mundësisë të shprehjes. Prandaj, ne s'kemi pse ta prishim këtë makinë për t'u dukur që dimë anglisht, italisht frëngjisht. Ruajtja e pastërtisë së gjuhës që shoqërohet me procesin e pasurimit tregon mjeshtërinë e lartë dhe moralitetin e një kulture. (javanevs)

(Intervista me Ismail Kadarenë u bë në prag të 30 vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, botuar në librin "Kadare ndryshe")





KM "LIRIA" FESTOI 40 VJETORIN E THEMELIMIT

KLUBI QË NDERON KOMBIN



Visar Ganiu

"40 vjet suksese të shumta në arenën sportive vendore dhe ndërkombëtare janë rezultat i një pune të palodhshme profesionale për të cilën Klubi i Mundjes 'Liria' meriton mirënjohje të thellë dhe përkrahje të pakursyer për vazhdimin e kësaj rruge që nderon një shtet e një komb të tërë"



Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 30 nëntor – Klubi i mundjes "Liria" të mërkurën festoi 40 vjetorin e themelimit të saj. Në një atmosferë të mirë e organizuar në restorantin "Abc", ku prezent ishin mysafir nga vendi, Kosova e Shqipëria, ish-mundës dhe mundës aktual të këtij klubi, tifoz e sponsor, gazetar, kryetari i Komitetit Olimpik Sasho Popovski, kryetari dhe nënkryetari i Federatës së mundjes të Maqedonisë, Betim Vrenezi dhe Dejan Bogdanov si dhe kryetari i Komunës së Çairit, Visar Ganiu, u shënuar ky jubile. Gjithçka filloi me dokumentarin 15 minutash për klubin, për atë se si u themelua, kush janë ata që e themeluan KM "Liria" dhe sukseset që ky klub i ka arri-

Klubi i Mundjes "Liria" nga Shkupi, ka festuar 40-vjetorin e themelimit, në një organizim solemn ku morën pjesë shumë personalitete të larta sportive dhe miq të këtij klubi

tur deri më sot. Për historinë e klubit foli njëri prej themeluesve dhe trajner i KM "Liria", Hajrush Sinani, më pas edhe ish-kryetari dhe tani kryetar i Federatës së Mundjes së Maqedonisë Betim Vrenezi, kryetari i ri Imer Kadriu dhe kryetari i Komunës së Çairit, Visar Ganiu.

"40 vjet suksese të shumta në arenën sportive vendore dhe ndërkombëtare janë rezultat i një pune të palodhshme profesionale për të cilën Klubi i Mundjes 'Liria' meriton mirënjohje të thellë dhe përkrahje të pakursyer për vazhdimin e kësaj rruge që nderon një shtet e një komb të tërë. Shpreh gatishtëri të plotë të përkrahjes për të kontribuar në stimulimin e mëtutjeshëm të kreativitetit sportiv e rinor. Afirmimi i vlerave

sportive mbetet prioritet dhe falë pasionit që KM "Liria" reflekton kjo rrugë e lavdisë do të vazhdojë", u shpreh Ganiu. "Klubi i Mundjes 'Liria', tani më është një klub profesionist. Është një klub i cili tani ka të gjitha elementet e një klubi profesionist, me strukturat e tjera udhëheqëse. Me buxhetin e tij vjetor. Do të tentojmë që mundjen ta rikthejmë në shtigjet e vjetra, siç ka qenë më herët", tha kryetari i klubit Imer Kadriu, i cili falënderoi të gjithë ata që erdhën dhe e nderuan këtë përvjetor. Ndërkohë, të gjithë mundësit dhe ata që kanë vlerë për klubin, trajnerët, sponsorët, funksionarët dhe gazetarët në mesin të cilëve edhe gazetari i të përditshmes KOHA, Bujar Kurtaj, morën plaketa.



Imer Kadriu

Klubi i Mundjes 'Liria', tani më është një klub profesionist. Është një klub i cili tani ka të gjitha elementet e një klubi profesionist, me strukturat e tjera udhëheqëse. Me buxhetin e tij vjetor. Do të tentojmë që mundjen ta rikthejmë në shtigjet e vjetra, siç ka qenë më herët

KUPA E MAQEDONISË, DERBI PA FITUES

Shkupi dhe Vardari në raund të dytë

Shkup-30 nëntor – Vardari dhe Shkupi kanë luajtur baras 1-1 në ndeshjen e parë të 1/8 së finales të Kupës së Maqedonisë në futboll. Ndërkaq, plasmanin në çerekfinale dhe në dyluftimin me KF Shkëndija këto dy skuadra do të kërkojnë në ndeshjen kthyesë e cila do të zhvillohet në stadiumin në Çair më 17 dhjetor. Ndryshe, djemtë e trajnerit Ardian Nuhiu zhvilluan një ndeshje të mirë, kaluan në epërsi me golin e bukur të Alen Jasharovskit, ishin afër sensacionit, por një gol me fat i Bersegian, në fund u desh të pajtohen me rezultatin e barabartë, rezultat i cili u jep shprese atyre për plasman në çerekfinale. (B.K.)



Hysaj i shtati më i shtrenjtë te Napoli

Skuadra e Napolit kryeson me meritë kampionatin italian, edhe pse në organikën e saj nuk janë futbollistët më të shtrenjtë në Serinë A. Në prag të përballjes me Juventusin në "San Paolo" Corriere Dello Sport ka bërë një përlogaritje të vlerës që 26 lojtarëve të Napolit, që shkon në total 497 milionë euro. Në fakt, më shumë se ¼ e kësaj shifre vlerësohen vetëm 7 elementët kryesorë, ku përfshihet edhe mbrojtësi i Kombëtares Shqiptare, El-seid Hysaj. Kartoni i 23-vjeçarit vlerësohet 25 milionë euro, aq sa i Zhorginjos. Më të shtrenjtë se shkodrani janë Dries Mertens (28 milionë euro), Faouzi Ghoulam (30 milionë euro), Arkadiusz Milik (33 milionë euro), Marek Hamshik (40 milionë euro), Kalidou Koulibali (54 milionë euro) dhe në majë qëndron Lorenzo Insigne, që kushton 100 milionë euro. Më pak i vlefshëm konsiderohet Kristian Magjo me vetëm 1 milion euro.



Në bazë të neneve 125 dhe 131 të Ligjit për Arsimin e Lartë (Gaz. Zyrtare e RM-së nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154/15, 30/16, 120/16 dhe 127/16), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës si dhe në mbështetje të nenit 144 të Statutit të Universitetit të Tetovës, shpallet

KONKURS

Për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore shkencore në Universitetin e Tetovës

Shpallet Konkurs për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës:

FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE

1. Një mësimdhënës për lëndët:
 - Kirurgji I dhe II
 - Mjekësi urgjente
2. Një mësimdhënës për lëndët:
 - Biofarmaci
 - Bazat e teknologjisë farmaceutike
 - Kimi farmaceutike II
3. Një mësimdhënës për lëndët:
 - Mjekësi interne I dhe II
4. Një mësimdhënës për lëndët:
 - Farmaci klinike dhe terapeutike
 - Biofarmaci
 - Hyrje në farmaci klinike
5. Një mësimdhënës për lëndët:
 - Bazat e farmakologjisë
 - Farmakologji (në programin studimor

Stomatologji)

- Farmaci klinike dhe terapeutike
6. Një mësimdhënës për lëndët:
 - Legjislacioni dhe analitika e barnave
 - Farmakoinformatikë
 - Kursi hyrës
 7. Një mësimdhënës për lëndët:
 - Bazat e farmakologjisë
 - Kimi farmaceutike I
 - Kimi farmaceutike III
 8. Një mësimdhënës për lëndët:
 - Farmakologji

- Hyrje në farmaci klinike
- Farmakognozi

FAKULTETI I ADMINISTRATË BIZNESIT

1. Një mësimdhënës për lëndët:
 - Bazat e kontabilitetit
 - Financat publike
 - Tregjet dhe institucionet financiare
2. Një mësimdhënës për lëndët:
 - Bazat e marketingut
 - Marketingu ndërkombëtar
 - Menaxhimi i resurseve njerëzore
3. Një mësimdhënës për lëndët:
 - E drejta afariste
 - E drejta financiare
 - E drejta doganore

FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE

1. Një mësimdhënës për lëndën mësimore
Hendboll
2. Një mësimdhënës për lëndën mësimore
Basketboll
3. Një mësimdhënës për lëndën mësimore
Psikomotorikë
4. Një mësimdhënës për lëndët mësimore:
 - Fiziologjia e sportit dhe ushtrimeve sportive
 - Kineziterapi

FAKULTETI EKONOMIK

1. Një mësimdhënës për lëndët:
 - Gjeografia e turizmit
 - Gjeografia ekonomike
 - Mjedisi jetësor dhe turizmi

2. Një mësimdhënës për lëndët:
 - Mikroekonomi
 - Makroekonomi

Kushtet për thirrjen mësimore-shkencore docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar:

- Thirrje mësimore – shkencore, me Vendim të organit kompetent, nëse e posedon;
- Diplomë për gradën shkencore doktor i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;
- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- Biografi e shkurtër;
- Ta dorëzojë punimin e doktoratës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Certifikatë e shtetësisë.

*Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, të parapara me nenin 125 të Ligjit për Arsimin e Lartë.

*Fletëparaqitjen bashkë me dokumentet e nevojshme, kandidati duhet t'i dorëzojë në afat prej 5 ditë pune, nga dita e shpalljes së Konkursit, në Rektoratin e Universitetit të Tetovës, në adresën: Rektorati i Universitetit të Tetovës, Rr. e Ilindenit, p.n. Tetovë.

Tetovë, 30.11.2017
Universiteti i Tetovës



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të Vendimit për ndarje të Çmimit vjetor për hulumtues të rinj nr. 02-15/III-16/2011 të datës 31.03.2011 dhe O. nr. 02-15/VIII -7/2014 të datës 31 korrik 2014, ndërsa në pajtim me Rregulloren për mënyrën, procedurën dhe kushtet për zgjedhje të punimit më të mirë dhe ndarje të Çmimit vjetor për hulumtues të rinj nr. 2927 të datës 13.04.2011, Rr nr. 7762 të datës 20.09.2012, Rr. nr. 28175 të datës 5 shtator 2014 dhe Rr. nr. 26412 të datës 30 korrik 2015, Banka popullore e Republikës së Maqedonisë publikon

KONKURS PËR NDARJE TË ÇMIMIT VJETOR TË BANKËS POPULLORE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR VITIN 2018

Për shkak të stimulimit të zhvillimit të mendimit shkencor dhe përpunimit të punimeve nga sfera e makroekonomisë dhe bankat dhe sistemet bankare, si dhe afirmimit të kuadrove të reja dhe profesionale, Banka popullore e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Banka popullore) ndanë Çmimin vjetor për hulumtues të rinj për punim më të mirë nga sfera e makroekonomisë dhe bankat dhe sistemet bankare.

Çmimi vjetor i Bankës popullore është 100.000,00 denarë, neto.

Të drejtë për pjesëmarrje në Konkurs kanë shtetasit e Republikës së Maqedonisë të moshës deri në 35 vjet. Punëtorët e Bankës popullore dhe anëtarët e Këshillit të Bankës popullore nuk kanë të drejtë për pjesëmarrje në Konkurs.

Punimet parashtrihen në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën angleze. Punimi duhet patjetër të përmbajë edhe qasje ndaj ekonomisë së Maqedonisë në temën përkatëse. Punimi nuk duhet të kalojë 80.000 karaktere me vendet e zbraçura (pa fusnotat, shtojcat, grafikonet, tabelat, abstraktin, bibliografinë, anekset) dhe është rekomanduese të ketë strukturë standarde të hulumtimit shkencor, i cili përmban pjesët themelore në vijim:

- abstrakt, si dhe theksim të sferës së hulumtimit sipas klasifikimit standard (Journal of Economic Literature - JEL);
- qasje ndaj literaturës së konsultuar nga sfera e cila hulumtohet;
- përshkrim të metodave të hulumtimit që shfrytëzohen në punim;
- analiza;
- pikëpamjet përfundimtare dhe
- bibliografia.

Një autor ka të drejtë të parashtrijë vetëm një punim.

Në Konkurs për zgjedhje të punimit më të mirë autorët kanë të drejtë të konkurrojnë edhe me punimet të cilat tash më janë publikuar, por jo para 1 janarit të vitit 2016. Gjatë parashtrimit të punimit, autori duhet të theksojë kur dhe ku është publikuar punimi.

Punimet parashtrihen deri në Bankën popullore me shenjë "Për Çmimin vjetor të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë", përmes formës elektronike, në format "word", në e-mail adresë: konkurs@nbrm.mk. Krahas punimit, autori duhet të parashtrijë edhe të dhëna biografike. Punimet e parashtruara do të kenë trajtim të materialeve me karakter të besueshëm.

Zgjedhjen e punimit më të mirë e bën Këshilli për vlerësim, i cili përbëhet nga tre persona, nga të cilët së paku njëri është person që nuk është i punësuar në Bankën popullore. Guvernatori i Bankës popullore emëron kryetarin dhe anëtarët e Këshillit për vlerësim, me vendim i cili do të publikohet në internet faqen e Bankës popullore. Këshilli për vlerësim do të kryejë zgjedhjen e punimit më të mirë në mënyrë anonime, përmes vlerësimit të punimeve të futura në konkurrencën më të ngushtë sipas kriteve në vijim:

1. Relevancë të fushës hulumtuese për rastin e Maqedonisë;
2. Përkatesi të qasjes së literaturës nga fusha e analizuar;
3. Qartësi në definimin e problemit dhe qëllimet e hulumtimit;
4. Përkatesi në përshkrimin e kontekstit dhe informacioneve (përkatesi të analizës së trendeve në fushën e analizuar në Maqedoni);
5. Përkatesi të qasjes së shfrytëzuar statistikore-ekonometrike;
6. Konzistencë dhe logjikë të tezave në punim;
7. Konkuzione dhe rekomandime dhe përkatesi të tyre.

Këshilli për vlerësim mund të ndajë çmim për punimin e dytë të shpërblyer në Konkurs në shumë prej 50.000,00 denarë, neto.

Afati përfundimtar për parashtrimin e punimeve është **1 shkurt 2018**.

Çmimi vjetor i Bankës popullore do të ndahet në evenimentin e organizuar me rastin e Ditës së pavarësisë monetare të Republikës së Maqedonisë.

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 50, 53 dhe 74 të Statutit të Fakultetit të Shkencave Islame- Shkup dhe në bazë të pëlqimit paraprak nga Organi themelues, Dekani i FSHI- së, shpall:

KONKURS

për zgjedhje të një bibliotekisti në FSHI - Shkup

Shpallet konkurs për zgjedhje të një bibliotekisti në FSHI – Shkup – 1 përmbaues. Kushtet: Kandidatët, përkaj kushteve të përgjithshme, duhet t'i plotësojnë edhe kushtet e veçanta, si:

- të ketë të mbaruar shkollimin e mesëm katërvjeçar në Medrese;
- të ketë përvojë pune në biblioteka Islame;
- të ketë njohuri në punë me kompjuter;
- të njohë gjuhën arabe.

Përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë të regjistruara studimet deridiplomike. Së bashku me fletë paraqitjen kandidatët duhet t'i sjellin edhe këto dokumente: kopje të notarizuar të diplomës, dëshmi për përvojë pune, vërtetim për njohje të punës me kompjuter, biografi të shkurtë (CV) dhe kandidatët patjetër duhet të sjellin një letër rekomanduese me të cilën dëshmohet përvoja e punës në bibliotekë Islame.

Dokumentacionin e nevojshëm duhet të dërgohen nëpërmjet postës në adresën e Fakultetit.

Konkursi do të jetë i hapur pesë ditë nga dita e shpalljes.

Fakulteti i Shkencave Islame – Shkup

Në bazë të nenit 135 paragrafi 1 të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 35/2008; 103/2008; 26/2009; 83/2009; 99/2009; 115/2010; 17/2011; 51/2011; 123/2012; 15/2013; 24/2013; 41/2014; 116/2014; 130/2014; 10/2015; 20/2015; 98/2015; 145/2015; 154/2015, 30/2016, 120/2016 dhe 127/2016) dhe nenit 34 paragrafi 2 i Rregullores për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional, bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 138/09, 140/09, 173/11, 194/11, 250/2013 dhe 274/2013), rektori i Universitetit "Shën. Kirili dhe Metodij" në Shkup, me propozim të Dekanit të Fakultetit elektroteknik dhe teknologjive të informacionit në Shkup, publikon

KONKURS

për zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferën mësimore-shkencore:

- *Centralet elektrike dhe pikat ndarëse*, nën numrin 20207 sipas Klasifikimit të sferave, fushave dhe degëve shkencore të hulumtimit, të harmonizuar me standardet e OECD dhe UNESCO.

Kushtet: Krahas kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë edhe: biografi të shkurtër, deklaratë për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës dhe certifikatë të shtetësisë.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Orari i punës së mësimdhënësit është caktuar në pajtim me aktet e Fakultetit.

Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit.

Dokumentet dorëzohen në Fakultetin elektroteknik dhe teknologjive të informacionit në Shkup, rr. Rugjer Boshkoviq nr. 18, 1000 Shkup.

Universiteti "Shën. Kirili dhe Metodij" në Shkup

Koha, e premte 1 dhjetor, 2017

PAS FORMËS JO TË MIRË TË KEJLOR NAVAS

ZIZU KËRKON PORTIER

Në merkaton e janarit do të ketë një tentativë për të marrë portierin e Atletik Bilbaos, Kepa Arrizabalaga, teksa dy objektivat madhorë për merkato e verës janë David de Gea i Mançester Junajtedit dhe Tibaut Kurtoa i Çellsit

Real Madridi do të marrë një portier të ri për sezonin e ardhshëm, me urdhër të trajnerit Zinedin Zidan. Gabimi i rëndë i Kejlor Navas, kundër Fuenlabrada, në "Kupën e Mbretit", i ka bindur drejtuesit "Los Blancos" se ka ardhur koha të investojnë te një portier.

Në merkaton e janarit do të ketë një tentativë për të marrë portierin e Atletik Bilbaos, Kepa Arrizabalaga, teksa dy objektivat madhorë për merkato e verës janë David de Gea i Mançester Junajtedit dhe Tibaut Kurtoa i Çellsit.

Ndryshe, Arrizabalaga ka edhe gjashtë muaj kontratë me Bilbaon dhe duket opsioni më i lirë, ndërsa De Gea dhe Kurtoa kanë edhe 18 muaj kontratë me klubet angleze.


Portieri titullar i Real, Navas, pësoi një gol "të turpshëm" nga një distancë e largët, nga Luis



De Gea ka qenë objektivi i Real prej kohësh dhe para dy vitesh transferimi i tij në "Bernabeu" dështoi vetëm për probleme burokratike



Arrizabalaga ka edhe gjashtë muaj kontratë me Atletik Bilbaon dhe duket opsioni më i lirë



Milla i Fuenlabrada, skuadër në kategorinë e tretë spanjolle, ndërsa Kiko Kasilla, që ka luajtur si titullar në muajin e fundit zhgënjeu në ndeshjen kundër Malagas. De Gea ka qenë objektivi i Real prej kohësh dhe para dy vitesh transferimi i tij në "Bernabeu" dështoi vetëm për probleme burokratike, por faktikisht duket se favoriti për të kaluar te Real është Kurtoa. Numri 1 i Çellsit nuk pranoi rinovimin e kontratës në "Stamford Bridge" dhe ndoshta pas kësaj zgjedhje fshihet pikërisht oferta që i ka ardhur nga "merengues".



Favoriti për të kaluar te Real është Kurtoa. Numri 1 i Çellsit nuk pranoi rinovimin e kontratës në "Stamford Bridge" dhe ndoshta pas kësaj zgjedhje fshihet pikërisht oferta që i ka ardhur nga "merengues".



LAJME SHKURT

Babai i Nejmarit mohon negociatat me Realin



Babai dhe menaxheri i futbollistit brazilian, Neymar, ka mohuar njëherë e mirë negociatat me klubin e Realit të Madridit. Ai u shpreh se është e pamundur të mendosh largimin pas vetëm 3 muajsh në Paris dhe jo më të negociosh detajet e transferimit. "Nuk e kuptoj se ku i gjeni këto fantazi. Është e pamundur të mendosh dhe jo më të negociosh largimin, vetëm 3 muaj pas realizimit të transferimit më të shtrenjtë në histori. Neymar është i lumtur në Francë dhe po ambientohet më shpejt nga sa e kishim parashikuar. Klubi ka një projekt serioz dhe djali im erdhi për të luajtur gjatë këtu. Besoj se për 5-6 vite nuk do të jetë nevoja të negocioj me asnjë klub tjetër, pasi Neymar do të qëndrojë te PSZH-ja", tha babai i brazilianit.

Kaliniç do të largohet nga Milani



Shkarkimi i Vincenzo Montellas nga Milani mund të nënkuptojë edhe fundin e aventurës së Nikola Kaliniçit te kuqezinjtë, dhe raportohet se Guangzhou Evergrande kërkon ta transferojë që në janar. Qendërmbrojtësi u ble nga Fiorentina si lojtari i dëshiruar nga Montella dhe kushtoi 25 mln euro, por u fërshëllje nga tifozët gjatë barazimit 0-0 ndaj Torinos. Kontributi me tre gola dy asistime këtë sezon nuk ka impresionuar mbështetësit apo drejtuesit e klubit. Tani që Montella është shkarkuar, "Radio Rossonera" raporton se Kaliniç është vënë në merkato dhe ka interes nga Kina. Fabio Cannavaro ka konfirmuar disa herë se u mundua ta transferonte kroatin kur ishte te Tianhin Quanjian. Tekniku italian ka shkuar te një tjetër klub kinez, Guangzhou Evergrande, dhe është gati të provojë përsëri për sulmuesin. Mendohet se Milani do të kërkojë 45 mln euro për të, një shifër që është brenda mundësive financiare të kinezëve.

Sherr brenda Juventusit

Portali italian "Dagospia" ka zbuluar një prapaskenë të bujshme që ka lidhje me Juventusin. Sipas faqes së internetit që drejtohet nga Roberto D'Agostino, gazetar dhe personazh televiziv italian, në dhomat e zhveshjes të skuadrës bardhezi duket se është zhvilluar një sherr që ka ndarë skuadrën në dy fraksione: nga njëra anë kanë qenë "të vjetrit", ata me më shumë eksperiencë te klubi torinez, nga tjetra, grupi i lojtarëve të huaj. Një sherr ky gjatë të cilit nuk kanë munguar fyerjet e rënda mes dy palëve dhe që mund të ndryshojë planet e Juventusit në merkaton. Sipas "Dagospia", tre futbollistë jo italianë kanë kërkuar të shiten në merkaton e janarit.



Tjetër operacion për Kazorlan



Nuk ka fund kalvari i vuajtjeve për Santi Kazorlan. Mesfushori spanjoll i Arsenalit, ka lajmëruar në "Twitter" se është i detyruar t'i nënshtrohet një tjetër ndërhyrje kirurgjikale në tendinën e Akilit, çka do ta shtyjë edhe për disa muaj të tjerë rikthimin e tij në fushë. Ishte parashikuar që në fillim të vitit të ardhshëm të vihej nën urdhrat e Venger pas më shumë se një viti mungesë, por problemi nuk është zgjidhur përfundimisht. "Odissea" e mesfushorit nisi katër vite më parë,



në një miqësore të Spanjës me Kilin. Pasi u operua, plaga në thembër iu infektua, madje duke rrezikuar edhe këmbën, por mjekët e gjetën zgjidhjen duke i hequr shumë centimetra nga tendina, për ta zëvendësuar me një pjesë të krahut nëpërmjet transplantit. Por nuk ishte e thënë që vuajtjeve të Kazorlas t'u vinte fundit. Ai njoftoi se rikthimi i tij në fushë do të shtyhet, sepse ka ende një problem që do të zgjidhet me ndërhyrjen e radhës.

BONUÇI DHE 6 DËSHTIMET E TJERA MILIONERE TË MERKATOS SË VERËS

I marrë për 42 milionë euro, mbrojtësi nga Viterbo është bërë simboli i projektit të kuqezinjve, duke marrë edhe shiritin e kapitenit. Në këtë fazë të parë të sezonit, Bonuçi ka qenë një dështim i plotë



RENATO SANÇES – Ka qenë shumë afër Milanit, por mesfushori 20-vjeçar i Bajern Muniht, ka befashuar të gjithë duke nënshkruar me Svonsi. Renato ka qenë blerja e madhe e uellsianëve, që ishin në kërkim të një lojtari të rëndësishëm për mesfushën. Portugezi është ribashkuar me trajnerin Paul Klement, i cili ka qenë ndihmësi i Ancelotit në Muniht dhe që i ka dhënë një rol protagonist në skemën e tij 4-3-3. Por Sanches nuk ka arritur të bëjë diferencën. Në shtatë ndeshje të luajtura në Premier Ligë, lojtari i ri më i mirë i Euro 2016-ës, ka dhuruar një seri paraqitjesh zhgënjyese dhe është zëvendësuar në plot katër raste. Një fillim sezoni që nuk duhet t'i ketë pëlqyer aspak Bayernit, klubi që zotëron kartonin e tij. Në Gjermani presin një ndërrim të marshit nga ana e portugezit, i cili do të duhet të bëjë për vete Svonsin, nëse do të kthehet si protagonist në Bavari.



KEBALLOS – Paraqitja e jashtëzakonshme në Euro 2016 me fanellën e Spanjës ka bërë që rreth tij të zhvillohet një ankand i vërtetë. Real Madridi ka qenë ekipi që arriti të fitojë garën me një çek prej 17 milionë eurosh. Një blerje që ka ndezur verën e madrilenëve, të cilët kanë vendosur të përfshijnë në kontratën e tij një klauzolë prej 500 milionë eurosh, me synimin për të shmangur çdo surprizë të mundshme. Në këtë fazë të parë të sezonit, Kéhallos ka koleksionuar vetëm 10 ndeshjes. Pas një fillimi të mirë, spanjollit nuk e ka bindur trajnerin Zidane, i cili ka vendosur ta aktivizojë vetëm 316 minuta. Në Spanjë ka filluar të flitet që tani për një huazim të ish-lojtarit të Betis në janar. Do të ishte një mundësi e mirë për Kéhallos për të rigjetur formën e mëparshme dhe për të bindur Real-in.



KLAASSEN – I marrë për të qenë lideri i mesfushës së Evertonit të Ronald Kuman, holandezi është kthyer shumë shpejt në simbolin e sezonit zhgënjyesh të klubit anglez. Pavarësisht shpenzimeve të mëdha të bëra në merkaton, skuadra nuk ka arritur të gjejë një identitet, me Sigurdsson, Kin, Runi dhe Sandro Ramirez që nuk po arrijnë të shprehin të gjitha cilësitë e tyre. Në Liverpool prisnin shumë nga ai, duke parë se lojtari udhëhoqi Ajaksin drejt finales së "Europa League" në sezonin e kaluar. Klaassen nuk ka arritur të ketë asnjë ndikim në ekip në këtë fazë të parë të sezonit, me ekipin që është vetëm dy pikë larg zonës së rënies nga kategoria dhe i eliminuar në "Europa League".



LINDELOF – Murinjo e ndiqte prej disa kohësh. Tentativat për ta marrë në merkaton e janarit të kaluar kanë dështuar, por në verë ka ardhur transferimi i lojtarit në "Old Trafford" për 35 milionë sterline. Portugezi ka vendosur t'ia besojë çelësat e mbrojtjes futbollistit suedez, por ka ndërruar mendim shumë shpejt. Në fazën e parë të sezonit, Lindehof është lënë në stol nga "Special One", i cili ka preferuar treshen Bailly-Smalling-Xhons në skemën 3-4-1-2. Lindehof ka luajtur përsëri 8 herë të tjera, mes kampionatit dhe "Champions League", dhe tifozët i kanë vënë pseudonimin "Lindeflop" (Flop do të thotë dështim) pas paraqitjes zhgënjyese të lojtarit kundër Huddersfield. Në javët e fundit, ai ka përfutur nga ndryshimi i skemës, me Murinjo që ka kaluar te mbrojtja me katër lojtarë dhe duket se është kthyer të jetë një nga të preferuarit e Mou.




DEMBELE – 145 milionë euro për transferimin dhe një klauzolë 400 milionë euro për lirin e tij. Barcelona ka bërë "all in" për Ousmane Dembele, i cili është marrë për të zëvendësuar Neymar. Një trashëgimi e rëndë për francezin e ri, por trajneri Valverde i ka besuar atij që në fillim, në ndeshjet e kampionatit kundër Espanjolit dhe Getafe dhe në fitoren 3-0 të marrë kundër Juventusit në Çampions Ligë. Pikërisht në momentin më të bukur, ish-ylli i Dortmund, ka pësuar një dëmtim serioz në këmbën e majtë. Një dëmtim që ka ndaluar rritjen e tij graduale. Tani, ai po përshpejton kohët dhe mund të kthehet në fushë 23 dhjetorin e ardhshëm, me rastin e super ndeshjes kundër Real Madrid. Do të ishte një rikuperim i rëndësishëm për Valverden, i cili është gati t'i besojë përsëri talentit francez.



SHIK – Dukej gjithçka e mbyllur për transferimin e tij tek Juventusit. Klubi bardhezi ka qenë një hap larg zyrtarizimit të blerjes së sulmuesit çek, autor i 13 golave në sezonin e kaluar me Sampdorian. Në fund, kampionët e Italisë janë tërhequr dhe kanë vendosur të marrin Bernardeskin nga Fiorentina. I braktisur nga "Zonja", Shik është bërë më pas blerja më e shtrenjtë në historinë e Romas dhe lojtari kryesor i projektit të ri të Eusebio di Françeskos. Por lojtari ka luajtur vetëm 18 minuta për shkak një dëmtimi në kofshë. Shumë pak për një lojtar që duhej të ndizte ambientin verdhekuq me një lum golash. Tani Shik është kthyer të stërvitet me skuadrën dhe duket se është gati të shpërthejë. Një operacion prej 42 milionë eurosh që duhet të japë përgjigje në fushën e lojës dhe të tregojë vlerën e tij pas mrekullive të bëra me fanellën e Sampdorias sezonin e kaluar.

Pritej më shumë nga ata. Të cilësuar si blerjet e mëdha të merkatos së verës, kanë ndezur fantazinë e tifozëve, por nuk kanë arritur të mbajnë premtimet e bëra. Transferimet e tyre milionere duhej të zhvendosnin ekuilibrat në favor të ekipeve ku u transferon, por nuk ka qenë kështu. Këta janë shtatë futbollistët që kanë zhgënjyer në këtë fazë të parë të sezonit.





Një diamant i madh në formë ovale i vendosur në unazë "Pink

DIAMANTI "PINK PROMISE" SHITET 32 MILIONË DOLLARË

Promise", u shit dje në ankand nga shtëpia Christie's në Hong Kong për 32.16 milionë dollarë. Guri prej 14.93 karat shkoi për një blerës të pidentifikuar, i cili mori pjesë në ankand nëpërmjet telefonit. Sipas shtëpisë së ankandëve Christie's, bëhet fjalë për çmimin e dytë më të lartë për karat për një diamant, pas atij të arritur nga "Vivid Pink" (pesë karat) i shitur në Hong Kong në vitin 2009 për 10.78 milionë dollarë. Guri nuk ka arritur vlerësimin e bërë nga

shtëpia e ankandëve, që ishte 42 milionë dollarë. "Ky ishte një çmim shumë i lartë", theksoi François Curiel, president i Christie's për Evropën dhe Azinë, pas shitjes. "Kjo tregon se Hong Kongu është një qendër shumë e rëndësishme për stollitë", shtoi ai. Lufta antikorruption në Kinën kontinentale nuk ka ndikuar në ankandet shumë dinamike në Hong Kong. Në muajin prill, një diamant i kuq i madh "Pink Star" propozuar nga "Sotheby's" (59.60 karat), theu rekordin botëror për një gur të shitur në ankand duke arritur vlerën e 71.2 milionë dollarëve.

FACEBOOK SHPËRNDAN PROGRAMIN QË PARANDALON VETËVRASJET



Pas testeve të suksesshme në SHBA të programit të njohjes, Facebook do ta përhapë dhe në vendet e tjera, për të gjurmuar tentativa të përdoruesve për tu vetëvrasur. Ka qenë vetë kompania që ka bërë një deklaratë për këtë. Facebook nisi të testojë programin në SHBA në mars, kur kompania nisi të skanojë tekstet e Facebook, postimet dhe komentet për fraza që mund të ishin sinjali për ndonjë tentativë vetëvrasje. Facebook nuk ka bërë ende të ditur detaje teknike të programit, por kompania thotë se programi i saj kërkon disa fraza të caktuara që mund të jenë gjurmë si pyetjet "Je mirë?", dhe "A mund të të ndihmoj?" Nëse programi kap një tentativë potenciale, dërgon alarmin në skuadrën e Facebook, të specializuar për raste të tilla. Sistemi i sugjeron burime përdoruesit apo miqve të personit të telefonojnë në linjën e ndihmës. Ka raste që punonjësit e Facebook lajmërojnë autoritetet lokale të ndërhyjnë.



MASAKËR NË NORVEGJI, TRENI I MALLRAVE VRET 106 DRERË TË EGËR

Një masakër e vërtetë ka ndodhur në veri të Norvegjisë, ku treni i mallrave ka vrrarë 106 drerë të egër në katër ditë sepse shoferët nuk morën paralajmërim nga bosët e hekurudhës për të ulur shpejtësinë. Kafshët u goditën në tre raste vetëm këtë javë në Kvalforsbrua, në veri të Norvegjisë, ku 65 prej tyre u vranë të shtunën. Kjo pasoi vrasjen e 26 drerëve të mërkurën dhe 15 të tjerëve të enjten, pavarësisht se operatori i

hekurudhës së Bane Nor i kërkoi pronarit të trenave të mallrave që të ngadalësonin shpejtësinë. Autoritetet e transportit ishin paralajmëruar disa herë për rrezikun nëpërmjet lajmeve në agjencinë Helgelandingen. Torstein Appfjell, që është kujdesur për drerët që kur ishte një fëmijë, ishte në skenën e masakrës të shtunën dhe etha se kjo është një katastrofë për njerëzit që kujdesen për kafshët.

TRE GOMARË PËRFUNDOJNË NË BURG PASI DËMTUAN BIMË TË VLEFSHME

Tetë gomarë, të cilët kanë dëmtuar disa bimë të vlefshme në Indi janë "burgosur" për katër ditë. Sipas New Delhi TV, gomarët kanë kullotur në një pjesë toke që i përket burgut në distriktin Jalaun të provincës Uttar Pradesh, ndërsa më pas janë mbyllur nga zyrtarët e burgut duke u mbajtur në burg për katër ditë. RK Mishra, zyrtar policor

i burgut, tha se gomarët kanë dëmtuar disa bimë të vlefshme të cilat ndodheshin në parcelën e burgut. "Ne më parë i kishim paralajmëruar pronarët që t'i mbajnë larg prej këtu gomarët e tyre, por ata nuk ia vënë veshin këtij paralajmërimi. Për këtë arsye, ne i mbyllën gomarët", ka shtuar ai. Gomarët në burgun e Jalaunit u liruan pasi një politikan lokal ka paguar dëmet e shkaktuara.



1167 - Qytetet e Italisë veriore formojnë Lidhjen e Lombarisë
1420 - Henri i V i Anglisë futet në Paris.

1640 - Portugalia rimerr pavarësinë pas 60 vjet nën sundimin e Spanjës.

1708 - Aleanca e Madhe okupon Brukselin.

1821 - Santo Domingo (Republika Domenikane) shpall pavarësinë nga Spanja.

1835 - Hans Christian Andersen publikon librin e tij të parë me përralla.



1918 - Proklamohet Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene në Beograd.

1937 - Japonia njeh Qeverinë e Frankos.

1981 - Zyrtarisht njihet SIDA.

1989 - Kryetari i BRSS Mihail Gërbaçov takohet me Papa Xhon Palin II në Vatikan

1991 - Populli i Ukrainës voton për pavarësi.

KALENDARI HISTORIK 1 DHJETOR



A E DINI SE...

Për çdo njeri që e do muzikën, natyrisht se kufjet janë pjesë e rëndësishme e jetës së tyre. Megjithatë, rrallë herë njerëzit mendojnë se kufjet mbulohe nga një sipërfaqe me të cilën ne vihemi në kontakt gjithmonë. Në këtë sipërfaqe rriten bakteriet të cilat janë unike, dhe ndarja me miqtë i shton shumë ato, shkruan BS. Pra, fillimisht duhet të sigurohemi që kufjet të jenë të pastërta ose t'i pastrojmë ato me pambuk ose me llak dezinfektues. Shëndeti juaj varet në rrezik gjithnjë në rast se nuk i pastrojmë kufjet para se t'i vendosni në vesh.



BARSOLETA

FRYMËMARRJA E VËSHITËRSUAR
Pacienti në kontroll i thotë mjekut:
- Doktor jam më mirë, kollitja më është ndalur nuk teshtij më..., vetëm frymëmarrjen e kam të vështirësuar!
- Shumë mirë... ulu do të mundohemi edhe atë ta ndalë!



Herën e parë që më fryn, është faji yt, herën e dytë është faji im!
(proverb arab)

THËNIA E DITËS